

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRIN

Nr. / Nr. 10733/26

Nr. i fq. / Nr. ut. -1-

Data: / Datum: 13.03.2026

VUSHTPRI - VUÇITRIN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrin – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 49/26 13/02/2026

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 mars 2026 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, mbajtur më datë 26 shkurt 2026;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, mbajtur më datë 5 mars 2026;
3. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2025;
4. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/2026;
5. Raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm;
6. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2025;
7. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete;
8. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, lidhur publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026;
9. Pyetje dhe përgjigje.



Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01. Nr. PB-34/26 26/03/2026

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË: 26 SHKURT 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në ora 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë si: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli – Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzy, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Pëllumb Maliqi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 30 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-pasi konstatoi kuorumin, ceku se materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës janë dorëzuar sipas afateve ligjore, kërkoi nga anëtari i kuvendit z. Ramadan Parduzy, që të prononcohet para kuvendit lidhur me pozitën e tij si anëtar i kuvendi, pasi që i njëjti ka dorëzuar një dorëheqje të kryesuesja e kuvendit, nga pozita e anëtari të kuvendit, por që më pas ai nuk ka vazhduar me plotësimin e procedurës para KKZ-së për zëvendësimin e tij. Po ashtu ajo kërkoi nga të gjithë ata anëtarë të kuvendit që pozitën e tyre bien ndesh me ligjin dhe që kanë konflikt interesi, të deklarohen se cilën nga pozitën do ta mbajnë, ashtu që të shmanget konflikti i interesit; dhe njoftoi se për të gjitha këto, përgjegjësinë e mban secili që identifikohet se ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Po ashtu, ajo përsëriti se për të gjithë këta anëtarë që mbajnë edhe një pozitë tjetër, që bien ndesh me ligjin, pasojat do t'i bartin vetë ata.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para qytetarëve dhe Kuvendit të Komunës, deklaroi se: pas konstituimit dhe konsolidimit të institucioneve lokale një gjë mund ta konstatojmë

lirisht se është mandati i ri për Kryetarin, por Kryetari dhe logjika e tij qeverisëse, po ajo e vjetra. Metodatat janë të njëjta, strategjia është e njëjtë dhe qëllimet janë të njëjta.

Duke marrë për bazë përbërjen e Kuvendit, aktualisht Kryetari i Komunës e ka shumicën e thjesht për vendimmarrje. Por, edhe përkundër kësaj, Kryetari e di se këta numra në disa situata nuk i kryejnë punë, kur ka pika dhe projekte që nuk janë në interes të përgjithshëm, prandaj ai pretendon të kontrabandoi deputetë edhe nga opozita, sikur se ndodhi edhe në seancën e kaluar kur LDK-së iu imponua përfaqësuesi në KPF nga ana e PDK-së, dhe kjo pa kurrfarë morali politik. Kjo është strategji e Kryetarit Idrizi dhe PDK-së, dhe kështu ka funksionuar edhe katër vitet e kaluara, duke imponuar agjenda për partitë opozitare pa kurrfarë morali politik e njerëzorë. Tutje vlerësoi se ai, Kryetari i Komunës, mendon se me këto forma arrijnë ndonjë përfitim duke marrë një asambleist, por po harron se për t'u bërë asambleist nevojiten 300 vota, ndërsa për tu bërë Kryetar Komune nevojiten 15,000.00 vota dhe kjo i bie se mëkatet e kryetarit janë 50 fish më të mëdha. Sa i përket ekzekutivit apo drejtorive komunale ato mund t'i ndajmë në tri kategori, e para janë ato drejtori dhe drejtorë të cilëve iu ka premtuar Kryetari i Komunës se do t'i jep diçka në këmbim të mbështetjes në zgjedhje dhe të njëjtat janë pa kurrfarë funksioni. Kategoria e dytë e drejtorive komunale është thjeshtë përmbushje e interesave partiake, duke shfrytëzuar për punësime të militantëve partiak. Dhe e treta, dhe më rëndësishmja është, rrjeta e drejtorive për interesa madhore personale, kupola ku përfshihen dhënia e tenderëve milionësh, dhënia e pronës komunale, dhe lejet e ndërtimit për rrethin e oligarkëve. Kjo ka ndodhur dhe do të ndodh edhe këtë mandat, prandaj shumica prej nesh do të votojnë për një interes të vogël personal, ndërsa interesat e mëdha do t'i realizojnë një grup i vogël i njerëzve të pushtetit aktual. Ai në fund apeloj te të gjithë, që të thirrin mendjes dhe mos të votojnë sy mbyllur.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, i uroj besimtarët e fesë islame për muajin e shenjt të ramazanit, duke ju uruar agjërime të lehtë e të pranuar. Pastaj ai ndër të tjera deklaroi se shqetësimi kryesor i yni dhe i shumë qytetarëve të komunës është vendimi i NPL. "Përparimi" për ndërprerjen e mbledhjes së mbeturinave në disa fshatra të Komunës së Vushtrrisë, si në Gllavotin, Bivolak, Strofc, Zhilivodë, Beçiq, Dubofc, Galicë duke përfshirë edhe disa pjesë të qytetit. NPL. "Përparimi" ka bërë të ditur se do të merren masa ligjore për inkasim, përfshirë edhe aplikimin e kamatave. Ai konsideron se kjo situatë ka ardhur si pasojë e menaxhimit të dobët nga menaxhmenti i kësaj ndërmarrje, të cilët për vite të tëra qytetarëve nuk iu kanë dërguar faturat për të bërë pagesat e borxheve për shërbimet për mbledhjen e mbeturinave, si pasojë e kësaj ka ardhur deri te situata e rritjes dhe grumbullimit të këtyre borxheve. Ai kërkoi nga Komuna e Vushtrrisë dhe NPL. "Përparimi", të mos aplikoi kamata ndëshkuese ndaj qytetarëve, të bëhet ri-programimi i borxheve, ashtu që qytetarëve të i'u mundësohet pagesa me këste e këtyre borxheve ndaj kompanisë. Po ashtu qytetarëve t'i u dërgohet së paku tri herë në vit fatura e borxheve dhe t'i u mundësohet pagesa online e këtyre faturave, që për momentin nuk është e mundur si pasojë e punës së dobët të menxhmenit të kësaj ndërmarrje dhe autoriteteve komunale. Kërkoj të bëhet saknimi gjendje faktike në terren i ekonomive familjare, sepse shumë familje tash më nuk jetojnë në fshatrat e përmendura, dhe edhe përkundër kësaj atyre u janë akumuluar borxhet për vitet për të cilat ata nuk kanë jetuar në ato vendbanime. Të mos ndëshkohet i tërë fshati apo lagjja, me mos grumbullim të mbeturinave, për shkak të individëve, sepse kjo do të sillte rrezik për grumbullim të deponive ilegale të mbetjeve dhe për pasojë do të kontaminim të ambientit ku jetojmë. Në fund kërkoj që në njërën nga seancat e ardhshme të silltet për plotësim-ndryshim rregullorja për menaxhimin e mbeturinave sepse është identifikuar se ka zbrazëtira dhe ajo duhet t'i përshtatet rrethanave të kohës.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-adreso i një kërkesë e cila ishte parashtruar më herët, me datën 26.12.2025, për ndërtimin e “Kullës së Hazir Gjakës”, Komandantë i Batalionit të IV dhe po ashtu luftëtar i Shaban Polluzhës. Prandaj ne si Komunë duhet ta mbështesim dhe realizojmë këtë kërkesë për disa arsye të fuqishme. Së pari, kjo është një çështje e respektit institucional të figurave që kanë kontribuar dhe sakrifikuar për lirinë e Kosovës. Andaj, nderimi i tyre është detyrim moral e kombëtar. Po ashtu, nderimi i kësaj kulle i shërben investimit në ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë sonë historike e kombëtare. Në projekt i tillë do të shërbente si pikë referimi për brezat e ri, në ruajtjen e kujtesës kolektive. Ndërtimi i kësaj kulle në Ashlanin heroik, do të provonte përkushtimin institucional në ruajtjen e trashëgimisë historike dhe jetësimin e dëshmive të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj, në këtë kontekst vlerësoi se financimi i kësaj kërkesë jo vetëm që është i arsyeshëm por edhe i domosdoshëm për të ruajtur vlerat tona historike e kombëtare dhe për ta mbajtur gjallë lidhjen mes institucioneve dhe komunitetit. Po ashtu, ai ngriti shqetësimin e tij se nga drejtoresha e DKA-së kemi një qasje diskriminuese për Shkollën SHMU 1, sepse në këtë shkollë nuk është bërë shkurtimi i orëve të mësimi për 5 minuat, sikur në gjitha shkollat, për nder të muajit të shenjët të Ramazanit.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- pasi i përshëndeti të pranishmit, vlerësoi se përpara se të kalojmë në pikat e rendit të ditës, kam një kërkesë për sqarim që ndërlidhet me transparencën dhe menaxhimin e parasë publike në komunën tonë. Së fundmi, jemi njoftuar për një "super-transfer" në stafin tuaj këshillues – një ekspert që buxhetit të Vushtrisë i ka kushtuar rreth 26 mijë euro. Edhe pse shifra të bën të mendosh për ndonjë talent ndërkombëtar, bëhet fjalë për z. Fehmi Shala, i cili, përtej ekspertizës, rezulton të jetë edhe familjar i juaji (vëllai i bashkëshortes). Duke qenë se procesi i prokurimit u mbyll pa konkurrencë, qytetarët e Vushtrisë më kanë ngarkuar t'ju drejtoj këto pyetje specifike: Përvojat në Dumnicë, duke pasur parasysh angazhimin e tij si ekspert për fshatrat, a ju ka ofruar këshilltari juaj ndonjë raport apo leksion mbi përvojat e tij specifike në fshatin Dumnicë, veçanërisht mbi veprimtarinë e tij gjatë periudhës së luftës në këtë zonë? "Suksesi" në Prelluzhë dhe Gracë, duke parë rezultatin tuaj mbresëlënës prej 96% të votave në Prelluzhë gjatë balotazhit, a mund të na thoni, sa i atribuohet ky sukses "shkencës" së këshilltarit tuaj të ri dhe sa koordinimit me Listën Serbe në atë zonë? Këshillat e pranuar, cilat janë konkretisht tri këshillat kryesore që keni pranuar nga ky ekspert deri më sot, të cilat do të arsyetonin pagën e tij prej 26 mijë eurove në sytë e taksapaguesve Vushtrias? Kryetar, qytetarët presin të dinë nëse këto 26 mijë euro janë investim për zhvillimin e fshatrave, apo thjesht një "bonus" familjar për meritokraci elektorale?!

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit i uroj besimtarët e fesë islame për muajin e shenjët të ramazanit, duke uruar agjërime të lehtë e të pranuar. Ai ngriti disa shqetësime për në lagjen te rr. "Shote Galica", nxënësit kalojnë rrugën magjistrale për të shkuar në shkollën "Mustafë Venhari" dhe në javën e kaluar ka pasur një incident. Më tej në rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, konkretisht tek autolarja "Kaltërina" është hapur një gropë e madhe nga një ndërtues, në ç'rast ajo gropë për shkak të shembjeve është duke e rrezikuar një ndërtesë që është aty afër ngjitur, por fatmirësisht deri tani nuk kemi pasur ndonjë incident apo viktimë.

Ai shprehu habinë e tij se për këtë rast nuk kemi reagim nga ana e Drejtorisë së Inspektimeve në Vushtri, as në të kaluarën edhe as tani. Aty pari shihen disa shirita të kuq që i janë vënë, por veprime nuk ka dhe aty pran kalojnë edhe fëmijët që parqet një rrezik të lartë. Gjendja e këtij rasti është se aty nuk kemi as kushte ndërtimore dhe as leje të ndërtimit dhe nuk e dimë se si është hapur

kjo gropë, sepse në këso konditash nuk është dashur as të mendohet e lëre më të fillohet të hapen gropa për ndërtim. Po ashtu, ai shprehu vërejtje për mos-transparencë dhe llogaridhënien kur drejtorët komunal nuk marrin pjesë në mbledhjet e kuvendit. Po ashtu jemi në dijeni se javën e kaluar Drejtorit për pronë z. Bedri Dobra i është shpallur një aktakuzë dhe nuk kemi kurrfarë veprimi nga ana e Kryetarit të Komunës, lidhur me këtë rast.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, ceku se sikurse parafolësi i saj, ka dy çështje pothuajse të natyrës së njëjtë me i ngritur këtu para kuvendit. Çështja e parë të cilën po dua me ngritë është sa i përket kontratave me shërbime të veçanta që janë kontraktuar nga Drejtoria e Prokurimit. Konkretisht kërkoj nga personi që keni kontraktuar për shërbime në kulturë, po kërkoj nga personi që tashmë është punësuar në këtë pozitë, kontratën me të cilën çka parashihet me punuar ai person, a ka zyre konkretisht edhe a vjen ndonjëherë në punë, dhe planin e punës së saj duhet me sjellë këtu para nesh, se me çka ka të bëjë për tre vite meqenëse dhe ajo do të paguhet me një shumë të majme, për tre vite e ardhshme, diku 25.000 € me kontratë me shërbime të veçanta.

Çështja tjetër është e njëjta me atë të z. Berati. Unë jam takuar me banorët përreth, ndërtesa ku është hapur ajo gropë dhe kërkesat e banorëve është e njëjta situatë kur ka rrëshqitje të dheut dhe fatmirësisht falë Zotit s'ka pasur pasoja në njerëz. Kërkoj të bëhet e ditur a ka leje, a ka pasur leje kur e ka bërë gropën, kur e ka hapur domethënë gropën për ndërtim, a ka pasur ndonjë pëlqim për leje ndërtimore si dhe a ka pas leje për rrënimin e atyre objekteve përreth, dhe konkretisht aty ku është tashmë gropa që po e cekin edhe banorët, kanë kërkuar me sa ajo ka informata, një takim për të diskutuar për mbylljen e asaj grope sa më shpejt që është e mundur, por jo me mbeturina dhe mbetje betoni siç ka filluar por duhet të mbulohet me dhe. Në të kundërtën të gjitha shtëpitë që janë për rreth kanë puseta dhe kanë frikën që do të kontaminohet edhe ujë i pijshëm i atyre shtëpive aty në atë lokalitet. Ajo shprehu se është shumë me rëndësi që ajo gropë me u mbyll me dhe jo me mbetje të betonit dhe me mbeturina por me u mbuluar dhe mbyllur me dhe.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës- të nderuar anëtarë të Kuvendit, drejtorë komunal, përfaqësues të mediave e shoqërisë civile, përfaqësues të KFORIT, të dashur qytetarë të Vushtrrisë, në këtë rast dëshiroj të i bashkohen urimit për muajin e shenjtë të ramazanit, duke ju dëshiruar agjërime të lehtë dhe të pranueshëm të gjithë atyre që agjërojnë. Tutje ai u përgjigj në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Sa i përket pyetjes së parë për menaxhimin e mbeturinave, sigurisht që informatën nuk e keni të plotë, sepse nuk janë ndëshkuar të gjithë qytetarët duke mos ofruar shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, por ata të cilët nuk e kanë bërë pagesën e mbeturinave dhe deklaroj se asnjëherë nuk janë menaxhuar mbeturinat më mirë dhe ambienti ska qenë më i pastër sesa prej që e kemi marrë menaxhimin komunal përmes Kompanisë “Përparimi”. Të gjitha shërbimet janë duke u kryer, andaj, ato shërbime duhet të paguhen. Është një taksë, mendoj e përballueshme. E përballueshme po them sepse është 6 € në muaj, derisa vetëm për mirëmbajtjet e banesave kushton më shumë. Dhe në bazë të asaj që kemi hulumtuar tregun, këtu, në komunën e Vushtrrisë, qytetarët paguajnë 13 € në muaj për mirëmbajtjen e pastërtisë së banesave të tyre. Këta punëtorët e Përparimit, duhet me i paguar edhe me ju rrit pagat. Veç e kemi bërë një rritje në start dhe do të vazhdojmë ashtu qysh ju kam premtuar, sepse rreziku është që nesër kemi me mbet edhe pa këta punëtorë, që janë kategoria që më së shumti punojnë, janë kategoria më e ndjeshme dhe nëse ne si kuvendarë për një hatër të dikujt që s'i ka paguar mbeturinat, ndalemi edhe flasim këtu se na kanë mbetur qytetarët aq keq, mendoj që ju hymë në hak tash kësaj kategorisë tjetër që për çdo ditë e shohim qytetin e pastër, i shohim tu i pastruar mbeturinat.

Sa i përket çështjes së faturave të mbeturinave, informata ju ka shkuar me kohë secilit qytetarë edhe mbeturinat duhet të paguhen, përndryshe ndërmarrja nuk mund të funksionoi. Të gjithë këtu duhet me qenë në një mendim se edhe mediat më kanë pyetur për kushërinjtë e mi, ata si i kanë paguar?! – por kjo nuk ka të bëjë me lidhje farefisnore të njerëzve, kjo është domethënë: i paguan mbeturinat, kryhet shërbimi.

Ju e dini të gjithë, që krejt çka jetojnë me asistencë sociale i kemi liruar prej obligimeve të pagesës së mbeturinave, pra i ka paguar komuna. Andaj, nuk kemi mundësi që edhe kategori të tjera t'i lirojmë.

Sa i përket çështjes së kullës së “Hazir Gjakës”, kjo duhet të futet në planifikim të buxhetit. Po sa të vijmë dy qarkoret buxhetore. Nëse ti do jesh anëtar i kuvendit, tash ke me zgjedh njërin prej tyre, ose me qenë anëtar ose ke me qenë mësimdhënës. Nëse je anëtar i kuvendit, na vijmë dy qarkoret buxhetore të cilat do i diskutojmë bashkërisht edhe planifikimin e buxhetit e bëjmë, dhe ky projekt futet në planifikim buxhetor. Edhe unë jam që ato monumentet e trashëgimisë kulturore gjithsesi të kultivohen sepse pasurohet historia jonë. Ndërkaq sa i përket shkurtimit të orarit, unë nuk po e lë drejtoreshën hiç me dalë me marrë kohën, veç po tregoj se, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, është i vetmi autoritet që ka të drejtë me bë ndërhyrje në kurrikula, por edhe në orarin mësimor. Asnjë shkollë nuk e kemi lejuar në mënyrë zyrtare as me shkrim dhe as me vendim të drejtoreshës, që të ndërhyj në shkurtimin e orarit të mësimi për shkak të muajit të shenjt të ramazanit; dhe shkollat në saje të autonomisë së tyre që e kanë, kanë vepruar.

Pastaj, duke ju referuar diskutimit të anëtares së kuvendit Drita Dibrani, vlerësoj: fillo ndërtoje një karrierë të mirë politike dhe largoje gjuhën helmuese sepse ti nuk e di së pari sa anëtarë të familjes unë i kam dhënë për këtë liri që e gëzojmë sot. Besoj që nuk e dinë edhe cilët janë ata edhe ku kam qenë unë në atë periudhë edhe çfarë kontributi kam dhënë unë. Nuk po dua tash me i promovuar vlerat e mija se kurrë në jetë nuk e kam bërë një veprim të tillë. Po të drejtohem kështu në mënyrë humane. Sa i përket këtij rastit të konsulentëve, ne si Komuna jemi të hendikepuar, sepse një ministër i ka 8-të këshilltarë. Një Kryetar Komune e ka një shef kabinetit, një vozitës dhe një asistent personal. Normalisht që ato pika ku kemi pasur ngecje kemi shpallë vende për konsulent dhe kjo është e ligjshme. Kanë qenë procedurat e tenderimit, kemi pasur të drejtë, kanë qenë kriteret e përzgjedhjes, edhe ka pasur të drejtë secili të aplikoi. Tutje shtoj se nuk është e ndershme, të thuash një njeriu që prej fillimeve të para i ka shërbyer këtij vendi. Edhe në kohën kur mësimi mbahej nëpër podrum, unë i kam mësuar dhe kam organizuar arsimin shqip edhe jam kanë pjesë e solidaritetit në vitet 90, kurrë nuk jam ndalë. E kur ka ardhur momenti me dalë me mbrojt atdheun jam vetë i katërt vëlla si pjesëmarrës në luftë dhe po ashtu kam gjashtë anëtarë të familjes të vrarë në luftën fundit. Prandaj atë fjalinë që e përmende mos e përmend më se je e re, e ndërton një karrierë, nuk i dihet jetës hiç, nuk i dihet ku ka me të përfunduar karriera jote. Më mirë ndërtoje një karrierë të mirë, se unë katër vjet jam Kryetar Komune. Një anëtar i kuvendit nuk del me thënë më ka ofenduar Kryetari. Prandaj, nuk është e ndershme.

Lidhur me problemin që e ngriti anëtari i kuvendit z. Berat Sadiku, ceku se e ndan shqetësimin plotësisht me të, për atë gropë që është hapur. Dhe për Zotin, kam qenë i shokuar kur e kam parë në atë gjendje. Ai nuk dëshiron t'i ikë përgjegjësisë, por kjo lëndë është dërguar në prokurori. Personi që e ka hapur atë gropë ka qenë drejtor i ish-Kryetarit të Komunës z. Xhafer Tahirit, koleg i z. Berat Sadiku. Ne ju kemi thënë nga frika, nga rreziku i shembjes, të gjuhet material, ashtu që ajo gropë të mbyllet. Pastaj, njoftoi se iu ka premtuar banorëve që ajo gropë do të mbyllet, dhe sqaroi se këtë çështje e ka denoncuar në polici dhe në prokurori dhe ata duhet të veprojnë. Unë nuk qëndroj mbrapa saj.

Lidhur me komentet e z. Refik Maloku, anëtar i kuvendit, vlerësoj se kanë rrugëtuar bashkë veç se deklaroi se është njeri që i pranon kritikën, por ky i fundit shihet se është i mllëfësuar, dhe ceku se nuk ka faj që të ka mundur në zgjedhje në fshatin e tij Samadrexhë. Sepse i'u ka shërbyer atyre qytetarëve edhe ata e respektojnë shumë, sepse katër vjet i ke lënë pa ujë të pijes banorët e fshatrave në Samadrexhë, Vilanc, Ropicë, nuk e ke lënë asnjë gjurmë të punës suaj. Më tej parkingut nëntokësor dikur e vlerësoje si gropë e "Hajdin Sejdiut" por po del që nuk është ashtu e mos t'i përmendi shumë e shumë projekte, prandaj nuk kam faj unë sa më drejt i kam marrë votat dhe se qytetarët e respektojnë. Edhe unë jam i gatshëm secilit qytetar me i kryer shërbim ashtu qysh duhet. Pra, pse unë jam këtu ka qenë vullneti i qytetarëve qysh është kryeministri sot. Unë nuk kam të drejtë tash qytetarëve me ju thanë ju keni gabuar që i keni votuar 51% që i keni marrë. Se kur po është në pyetje aty po ke qejf. E në anën tjetër me thënë me mua paske gabuar. Domethënë qytetarët kanë vendosur për këtë punë, e kanë mandatin e tyre, juve kam me ju respektuar shumë, kam me u mundu me kontribuar shumë në këtë kuvend, po edhe me zbutur këtë gjuhë. Apeloj të ndalet gjuha denigruese në kuvend.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-deklaroi se, Kryetari i Komunës, si zakonisht e luan rolin e një engjëlli kur del këtu edhe fillon e thirret në kohën e kaluar se çka ka kontribuar. E kur u kanë çoban, kur u kanë mësues, kur u kanë ushtar. Ferit Idrizit kurrë emrin s' i kam përmend derisa nuk ka qenë Kryetar Komune. Andaj, unë nuk jam duke fol për Ferit Idrizin, as si mësues, as si ushtar. Jam duke folur për Ferit Idrizin si Kryetar të Komunës, kështu që mos i përziej konceptet. Në kritikën që jemi duke e bërë, jemi duke e bërë në cilësinë e të qenit Kryetar Komune, e jo në cilësi tjetër. Këtu po tentohet të bëhen lojëra duke u shfrytëzuar e kaluara. Kritikën për ty janë si Kryetar, prandaj pyetjet që anëtarja e kuvendi t'i bëri janë plotësisht të drejta dhe për ato pyetje kryetari nuk e dha asnjë përgjigje. Prandaj, Kryetari i themi që ne jemi duke bërë luftë politike kundër tij d.m.th. me Feritin Kryetar, jo me Feritin ushtar, as mësues, as djali i filanit, kështu që mos e qitni në rrafshin njerëzor këtu, por në rrafshin politik.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-tha se, ekziston një shqetësim i banorëve edhe i joni si banorë i asaj zone. Për neve, pak rëndësi ka kush është investitori Kryetar, a ka qenë drejtor i LDK-së apo jo. Fakti është që ajo gropë është që tre - katër vjet aty, dhe nuk është ndërmarr asgjë, dhe kjo nuk është në rregull. Shfrytëzimi i asaj zone, rrënimi i atyre shtëpive individuale, është filluar gërmimi pa pasur kushte dhe leje ndërtimore. Ky është shqetësimi jonë.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës- u zotua se, planin, raportet dhe çdo gjë i ka konsulentin në fjalë, mundesh të kesh qasje, dhe po të njëjtat mund t'i sjellim në seancën e ardhshme.

Pas votimit të kuvendi me 29 vota "për" aprovoj për t'a inkorporuar në rendin ditës Raportin për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2025.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- si anëtare e Kuvendit Komunal nga Lëvizja VETËVENDOSJE, në mbështetje të Nenit 18 të Rregullores së Punës, propozoj themelimin e komiteteve të tjera funksionale të Kuvendit, si mekanizma të domosdoshëm për forcimin e llogaridhënies dhe kontrollit demokratik mbi ekzekutivin komunal.

Propozoj themelimin e këtyre komiteteve:

- Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik
- Komiteti për Pronë
- Komiteti për Bujqësi

- Komiteti për Shërbime Publike

Këto komitete nuk janë formalitet. Ato janë instrumente konkrete për të garantuar që secila drejtori të raportojë rregullisht, që secili projekt të monitorohet me seriozitet dhe që çdo euro e buxhetit të shpenzohet me përgjegjësi, në shërbim të qytetarëve. Këto mekanizma tashmë funksionojnë në shumë kuvende komunale në Kosovë dhe kanë dëshmuar se rrisin transparencën, përmirësojnë koordinimin institucional dhe e forcojnë rolin mbikëqyrës të kuvendit. Vushtrria nuk duhet të mbetet prapa në ndërtimin e standardeve të qeverisjes së mirë. Qytetarët tanë presin përgjegjësi, transparencë dhe rezultate konkrete. Kuvendi nuk duhet të jetë vetëm organ votimi, por organ aktiv mbikëqyrës dhe përfaqësues i interesit publik. Prandaj kërkoj që ky propozim të futet në rend dite dhe të procedohet për miratim, në mënyrë që Kuvendi Komunal të ushtrojë plotësisht rolin e tij kushtetues dhe ligjor në shërbim të qytetarëve të Vushtrrisë.

Pas shqyrtimit të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 29 vota “për” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 janar 2026.
2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për vitin 2025.
3. Propozim – vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës nr. 01.189/23, datë 28.07.2023.
4. Propozim–vendim për emërimin e delegatëve të Komunës së Vushtrrisë në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës.
5. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025, në Komunën e Vushtrrisë.
6. Informatë lidhur me lejet ndërtimore, kushte ndërtimore dhe leje-rrënimi për vitin 2025.
7. Raporti i sistemit të menaxhimit të performancës për vitin 2024.
8. Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2025.
9. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 janar 2026;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 janar 2026.

2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025;

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- e përgëzoj Stacionin Policorë në Vushtrri dhe gjithashtu Komunën e Vushtrrisë, konkretisht Drejtorinë e Arsimit për bashkëpunimin që e ka me stacionin policor dhe komplet komuna e Vushtrrisë. Tutje ajo u ndalë te këto raportimet duke i analizuar dhe uroj që këtë vit të mos kemi vrasje, sepse vitin e kaluar kemi pasur dy vrasje në komunën tonë. Pastaj u ndal te rekomandimet, ku ceku se i ka bërë përshtypje që Stacioni Policor ju ka rekomanduar që me vendosë kamera në hapësirat ku nuk ka kamera, gjë që atyre ja mundëson dhe ja lehtëson punën shumë për me identifikuar vjedhjet, përdoruesit e narkotikëve dhe shtoj se ka po të njëjtin shqetësim, andaj kërkoj që të zbatohen këto rekomandime dhe të

vendosen kamerat në vendet ku ato mungojnë. Tutje shtoj se kohëve të fundi pasi ka munguar ndriçimi publik, si rezultat i mungesës së energjisë eklektike, lagje të caktuara në qytet janë shndërruar në strehë të narkotikëve, kështu që është mirë me vendos sa më shpejt kamerat e sigurisë. Diçka tjetër çka i përket Komunës së Vushtrrisë, që e lehtëson edhe punën e policisë në komunën tonë është Drejtoria e Inspektimeve, është mirë që të gjitha kiosqet që janë përreth shkollës me i kontrolluar më shpesh, sepse fëmijët në afërsi të shkollave po përdorin dhe po blejnë gjëra që nuk janë për moshën e tyre dhe është mirë që me dalë inspektorët me kontrolluar sa më shpesh për të mirët e fëmijëve tanë, për siguri të përbashkët. Në fund, po ashtu përgëzoj edhe njëherë Drejtorinë e Arsimit për bashkëpunim me policinë, ashtu që janë dalë dhe i kanë vendosur policinë te shkolla, gjë që e ka lehtësuar edhe komunikacionin te shkollat.

3. Propozim–vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës nr. 01.189/23, datë 28.07.2023;

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- pyeti sa i përket vendimit lidhur me afatin e tij, dhe shtoi se si grupi kuvendar i Lidhjes Demokratike janë në përkrahje të këtij vendimit?! Ajo çka është për me u diskutuar këtu është vendimi i datës 28.07.2023, kur kjo pronë ju ka dhënë në shfrytëzim Shërbimit Spitalor, Klinik Universitar, me afat prej tre viteve. Në pikën dy, cekët se aty do të ndërtohet edhe parkingu nëntokësor. Nuk e di arsyen kryetar, cila ka qenë arsyeja për me jep në shfrytëzim për parking nëntokësor dhe afati për dhënin e pronës në shfrytëzim të jetë vetëm tri vjet. E kemi një vendim këtu tash, për 40 vite. E kam parë projektin Kryetar, është për me i përgëzuar dhe në të njëjtën kohë edhe me i falënderuar Emiratet e Bashkuara e Arabe për investimin në komunën tonë. Shfrytëzimi prej 40 vjet, ndoshta ish dashur me u diskutuar që me jep në fakt për 99 vjet, kur di që edhe herët e kaluara kemi pas raste kur parcela të tilla janë dhënë në shfrytëzim për 99 vjetw. Kështu që unë po besoj që edhe në bazë të kërkesës së Drejtorit të Spitalit të Vushtrrisë nuk është cekur afati, mirëpo ndoshta ne do të duhet ta zgjatim këtë afat si kuvend komunal pasi që ky do të jetë një ndërtim i vrazhdë dhe i përhershëm, të japim afat prej 99 viteve, kur dihet se kemi të bëjmë me një investim të një vlere të konsiderueshme, e që do të ndikon në përmirësimin e kushteve në ofrimin e shërbimeve kualitative shëndetësore.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- fillimisht shfrytëzoi rastin dhe fjalimin e nisi duke uruar secilin besimtar për muajin e shenjët të ramazanit. Ndërsa sa i përket kësaj pikës, ne si Grup Kuvendar e përkrahim dhënie shfrytëzim për shkak që investimi është shumë i madh dhe pajtohet me parafolësin e saj i cili tha që është më mirë me jep këtë pronë në shfrytëzim për 99 vjet, për shkak të investimit edhe ndërtimit që është normalisht i vrazhdë dhe investimit më të madh.

Me këto, propozoj që meqenëse investimi është 6.5 milion edhe kemi një Stacion të Policisë që objekti është i vjetërsuar goxha shumë edhe lokacioni është bërë vështirë i qasshëm për shkak se gjithmonë është rruga e bllokuar e ne si komunë të japim në shfrytëzim edhe parcelën ku është stacioni i policisë dhe për policinë të gjendet një parcelë tjetër ku do ndërtohej një objekt i dinjitetshëm dhe më i përshtatshëm. Ndërsa, investimi që është kaq i madh me qenë hapësira më e gjerë ndoshta jo për me ndërtuar por për një park ose diçka të ngjashme për njerëzit ato që shkojnë kështu që është propozimi për stacionin policor është propozimi i saj personal ndërsa përkrahja për dhënie në shfrytëzim është i grupit tonë kuvendar.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës- tha se, arsyeja pse e kemi dhënë për tri vjet, është se ky kuvend ka qenë mendoj që diku 80% të kësaj përbërje kanë qenë kur e kanë votuar këtë vendim, dhe arsyeja ka qenë që nuk kemi besuar që fillojnë investimet. Nuk ka qenë me ja dhënë në shfrytëzim për tri vjet, po tri vjet ka qenë afati i fillimit të investimeve. Nëse brenda tri viteve fillon

me automatizëm me ja vazhduar afatin, se e dimë që për tre vite ai investim nuk ja vlen me u bërë dhe tash jemi në këtë momentum ne e kemi negociuar edhe me donatorin.

Përprjekjet tona kanë qenë me nxjerrë sa më shumë investime, por nuk kemi mundur me e nxjerrë parkingun nëntokësor. Është hartuar projekti, na është prezantuar projekti komplet, nëse nuk gabojmë kanë nxjerrë diku 60 vend-parkingje sipërfaqësore. Edhe ato të tjerat investime që kanë me i bërë që vlera u përmend diku afër 6.5 milion euro.

Sa i përket Stacionit Policor, e kemi biseduar me drejtorin e me drejtoreshën regjionale dhe jemi në përpjekje për me gjetë një vend diku tjetër, dhe me ja lëshuar spitalit atë parcelë. Është plotësisht propozim me vend. Po e kemi pasur edhe këtë ide thash, e kemi biseduar dhe nuk kemi akoma një propozim përfundimtar për këtë çështje. Madje kishte propozuar këtë ish-objektin e TMK-së, por ajo nuk i plotësonte standardet, sepse po dashka me pas edhe njëfarë podrumi, për mbajtje 48 orë qysh është e rregulluar me ligj për këtë ata po dëshirojnë të vazhdojmë. Kësaj radhe nuk mendoj që duhet të futet në rend të votohet që t'i jepet ajo, sepse praktikisht e kemi Stacionin Policor edhe e krijojmë një komplikim të panevojshëm. Por, unë po ju premtoj që kam me punuar në këtë drejtim dhe besoj që kemi me ja dalë me gjetë një vend diku edhe është shumë mirë ato me ju dhënë spitalit, me e zgjeruar, se jemi me fat që kemi një spital të tillë në Vushtrri çfarë e kemi. Mendoj që afati 40 vjeçar, pra me mundësi vazhdimi është një afat i mjaftueshëm. 40 vjet nuk janë periudhë e shkurtër për atë investim. Në fund i falënderoj të gjithë për gatishmërinë me mbështet, por besoj që të gjithë keni me mbështet se është interes për të gjithë neve për qytetarët tonë.

Melihate Basholli-Latifi, kryesues e kuvendit- e hedh në votim propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me afate prej 40 vjet, me mundësi vazhdimi dhe në vendim me u cek që të shërben vetëm për nevojat e spitalit të Vushtrrisë kjo pronë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 30 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **Nr.01.189/23 i datës 28.07.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës**, Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që lidhet me financimin e projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevojat e spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa ndryshimet bëhen si në vijim:

- 1.1. Dhënia e pronës komunale parcela kadastrale P-70202016-02358-7 me sipërfaqe prej 7380 m² ZK – Vushtrri pronë e Komunës së Vushtrrisë e evidentuar në emër PSH. Shtëpi e Shëndetit jepet në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në afat prej 40 viteve, me mundësi vazhdimi me qëllim të realizimit të projektit ndërtimi dhe zgjerimi i hapësirave të reja spitalore për nevojat e Spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtrri.
- 1.2. Prona e cekur si në pikën 1.1 të këtij vendimi do të shfrytëzohet vetëm për nevojat e Spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtrri, nuk lejohet shfrytëzimi për qëllime tjera.

1.3. Në kuadër të pikës 1 të vendimit bazë bëhet ristrukturimi i projekti, ku nuk parashihet ndërtimi i parkingut nëntokësor, por vetëm bëhet zgjerimi i hapësirave të reja spitalore për nevoja të Spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtrri.

2. Pikat të tjera të vendimit bazë Nr.01.189/23 i datës 28.07.2023 mbeten të pandryshuara.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Propozim–vendim për emërimin e delegatëve të Komunës së Vushtrrisë në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 29 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërtohen anëtarët e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë të cilët do ta përfaqësojnë Kuvendin Komunal të Vushtrrisë në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës në përbërjen si në vijim:

1.1. Vlerë Tahiri anëtare e Kuvendit (PDK);

1.2. Refik Maloku, anëtar i Kuvendit (LVV);

1.3. Ramadan Parduzi, anëtar i Kuvendit (LDK).

2. Kryetari i Komunës përfaqëson Komunën e Vushtrrisë sipas detyrës zyrtare me përfaqësim direkt, ndërsa partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë propozojnë nga një përfaqësues.

3. Anëtarët e emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, kryesuesja e kuvendit dhe anëtarët e kuvendit të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrrisë;

Fatmire Ceceli, anëtare e kuvendit-tha se, sa i përket informatës së Drejtorisë së Shëndetësisë, e kam lexuar të gjithën. Shumica e këtyre parametrave të këtyre statistikave që kanë ardhur janë të vaksinimit të qendrave Mjekësisë Familjare Sa i përket raportit të shëndetësisë, desha me cekë disa

pika. Pastaj shtoj se edhe në Komitetin për Politikë e Financa ka kërkuar të jetë një raport i Qendrës Rezidenciale në Lumadh, por të njëjtin nuk e keni bashkangjitur, nuk na ka ardhur në email-adresë për mbledhjen e radhës. Tutje u ndal te çështja e laboratorëve, drejtorët me na tregu sa po bëhen analiza në laboratorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ku po amputohet gjaku dhe ku po bëhen analizat, me na njoftuar se çfarë parametra të analizave përbëhen edhe me na njoftuar për pajisjet laboratorike që ende nuk janë në funksion. Gjithashtu pyet drejtorin sa i përket biokimistit, në çfarë baze ligjore po i lëshoni këto analiza duke ditur që nuk kemi biokimist fare në Qendrën e Mjekësisë Familjare. Gjithashtu, te Qendra Rezidenciale vlerësoj se është shumë e nevojshme blerja e një veture. E di që është në planifikim. E di që ju ka dështuar disa herë. E di që jua ka marrë buxhetin përmbaruesi. Por, kërkoj nga ana e drejtorit që t'ja siguron një veturë Qendrës Rezidenciale, meqenëse ka raste të ndjeshme qysh e keni pas rastin e fundit që me të vërtetë ishte rast tepër i rëndë. Pra, ajo apeloj që të sigurohet një veturë në periudhë derisa të përfundon procedura për blerjen e veturës tjetër për Qendrën Rezidenciale. Po ashtu me lidhë një kontratë qysh po kontrakti shërbime të veçanta për miq, halla e teze dhe për ish bashkë partiakë me kontraktuar një psikolog për shkak se kanë nevojë edhe rezidentët të cilët janë aty, por edhe stafi që në rastin e fundit që ka ndodhur. Ata, me të vërtetë kanë nevojë me u trajtuar dhe të marrin shërbime psikologjike. Kjo vlen edhe për stafin pasi që edhe stafi është në një punë të ndjeshme. E dini shumë mirë të gjithë dhe kërkoj që me pas psikologun. Pse e ngrita më herët çështjen e bashkë-partiakut tuaj kryesuese që kërkonte çka po punon që merr 25.000 € për tre vite, kontratën a ka qenë ndonjëherë në punë konkretisht, ka lidhje me këtë se kur është kontraktuar ajo bashkë partiakja e juaj ish-Drejtoresha e Kulturës, duke i marrë 25.000 € për tre vite pa bërë asnjë punë. Në të njëjtën kontratë u kontraktua edhe një psikiatër për këtë Qendrën Rezidenciale që i kanë marrë 3.000€ edhe kanë bërë shumë punë të vlefshme. Andaj, kjo çfarë ka ngjarë është vërtet hipokrizi, mirëpo është mirë që tash me u mundu me e rregulluar pak këtë çështje në Qendrën Rezidenciale.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- tha se, sot po shqyrtojmë raportin e shëndetësisë për vitin 2025. Ky dokument është vetëm një tentim i dëshpëruar për të kamufluar realitetin përmes shifrave kumulative. Ju mund të provoni mashtrimin me tabela, por nuk e mashtroni dot qytetarin që nuk i merr shërbimet. Ky raport, vetëm sa vërteton atë që kemi thënë si subjekt politik gjatë tërë vitit. Ju e keni lënë Vushtrrinë pa shërbime bazike duke mbyllur laboratorët në QMF 1, QMF 3 dhe në Lumadh, si dhe duke shuar shërbimin stomatologjik në Pantinë. Tentimi për t'i fshehur këto mbyllje nën shifra të përgjithësuara është fyerje për inteligjencën e qytetarëve. Më tregoni i nderuar Kryetar, çfarë po ndodhë me skandalin e pajisjeve në laboratorin e QMF 1, jeni detyruar të dërgoni pajisje nga QKMF-ja, sepse pajisjet e blera mbi 30 mijë euro akoma nuk janë bërë funksionale. Janë blerë me sistem të mbyllur që nuk përputhet me reagentët – një dëm i pastër financiar. Ku mbetën pajisjet prej 5,000 eurosh që ju, bashkë me nënkryetarin Zhegrova dhe ish-drejtorin Rashica, i keni pranuar e paguar? Ky rast duhet të hetohet nga Prokuroria dhe Krimet Ekonomike! Akoma më rënd, sot analizat në Vushtri punohen në kundërshtim flagrant me Ligjin për Shëndetësi. Pacientët në QKMF, te tregu, punktohen dhe ato mostra gjaku transportohen në QMF 1 për t'u punuar. Zotërinj, transporti i gjakut dhe indeve është i ndaluar me ligj! Kush mban përgjegjësi për saktësinë e rezultateve që komprometohen rrugëve nga dridhjet dhe makinat e papërshtatshme? Dhe dështimi vazhdon te parandalimi. Në faqen 31, në raport, shohim se refuzimi i vaksinave te klasat e gjashta ka arritur në 12.59%. Ky është dështim total i fushatave tuaja. Kur prindërit hezitojnë, besimi te ju ka rënë në pikën zero. E si të kenë besim, kur në faqen 34 vetë raporti juaj kërkon 'sigurimin e ujit dhe kanalizimit nëpër shkollë? Pse nuk i keni përfshirë në raport gjokat skandaloze? Dënimin prej 10,000 eurosh për vaksinat e gripit, gjobën e drejtoreshës

së QKMF-së dhe mungesën e kushteve në AMF Ashlan. Ju keni harruar aktakuzat, arrestimet për ryshfet dhe angazhimin e kuadrit nga kriminalistika që nuk parashihet në asnjë rregullore!

Pyetjet dhe kërkesat direkte ishin:

1. z. Drejtor, a mund të na thoni sot emrat e shkollave që nuk kanë furnizim me ujë dhe kanalizim, duke i lënë fëmijët tanë në kushte mesjetare në vitin 2025?
2. Kryetar, ku gjenden pajisjet prej 5,000 erove që i keni paguar dhe pse pajisjet prej 30 mijë eurove nuk punojnë?
3. Kryetar, meqë po na e shisni si sukses këtë sistem, analizat tuaja të fundit laboratorike ku i keni bërë? A i keni bërë në laboratorët tanë ku gjaku "shëtit" rrugëve, apo keni zgjedhur spitalet private në Prishtinë ose keni shkuar në QKUK sepse as ju nuk i besoni këtij sistemi që keni krijuar?
4. Kërkoj publikisht dhe kjo është kërkesë zyrtare, të na i sjellin grupit tonë kuvendar emrat e komisioneve për hartimin e specifikave, komisionet e vlerësimit dhe ato të pranimi të pajisjeve laboratorike që nuk janë futur në funksion për më shumë se dy vite. Nëse nuk më përcillen, do të ndjek hapat ligjorë. Dikush duhet të japë llogari për buxhetin që u dha për pajisje të kota dhe jofunksionale.

Lorik Maxhuni, drejtor i DSHPS-së paraqiti sqarime të hollësishme lidhur me informatën për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrisë, duke u përgjigjur në pyetjet e parafolësës së saj. Tutje shtoi se është jashtëzakonisht krenar për shërbimet që Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare jep në qytetin e Vushtrisë, nuk mbetet asnjë qytetar pa shërbim. Të gjitha shërbimet që janë në Udhëzimin Administrativ numër 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor, ku jepen në nivelet më të kënaqshme dhe për këtë jemi shumë krenarë për shkak që shëndetësia Vushtrriase në çdo raport të performancës ka qenë në top-komuna të cilat kanë dhënë shërbimin mjekësor. Kisha dashur me u ndal tek anëtarja e kuvendit znj. Fatmire Cecelia, ku ceku se Qendra Rezidenciale nuk është përfshirë në raportin e shëndetësisë për shkak që është dhe menaxhohet dhe e cila ka kompetenca të ndara nga QKMF-ja. Unë jam i pajtimit që në rregulloren e punës të futet edhe një raport për Qendrën Rezidenciale. Besoj që është i nevojshëm që kjo të bëhet duke u të futur në Planin e Punës së Kuvendit. Po edhe mund ta diskutojmë, mund ta caktojmë dhe të diskutojmë nëse kjo vlerësohet se është e nevojshme, mundemi me sjellë një raport kurdo që e shihni të arsyeshme. Për sa i përket çështjes së laboratorit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, kjo është sfida më e madhe jo vetëm imja si drejtor por edhe e të gjithë drejtorëve që kanë qenë para meje. Pastaj vlerësoi se i pëlqej anëtarja e kuvendit znj. Drita që e mbajti një fjalim me shkrim shumë të bukur duke e lexuar por nuk e kupton atë që e thotë për shkak që nuk është njohëse e fushës. Unë e kuptoj që ke marrë direktivat edhe nga persona të cilat janë brenda laboratorit për që të njëjtit sabotojnë dhe pengojnë punën e laboratorit. Jam krenar që si Drejtor i Shëndetësisë udhëheqi një institucion i cili është më i depolitizuari në të gjitha institucionet komunale të Vushtrisë. Shefi i Urgjencës është nga Lidhja Demokratike, shefja e laboratorit është nga Lidhja Demokratike, te radiologjia është i Lëvizjes Vetëvendosje dhe në të gjithë dikasteret e tjerë pothuajse që janë anëtarë dhe aktivisht të partive opozitare. Laboratori në QMF, shefi në të cilin është emëruar në kohën e Lëvizjes Vetëvendosje është arrestuar nga policia për shkak që ka bërë përshkrimin e analizave jo të vërteta nuk e ka matur absolut asnjë biokimi asnjë aparaturë nuk ka funksionuar i ka shkruar me kimik dhe për këtë ka pas aktakuzë edhe është arrestuar edhe mua më vjen shumë keq si qytetar, i njëjti që është pikërisht aty është shok ish-drejtorit të shëndetësisë Sylejman Mehulli, për të njëjtat pajisje që ju po flisni që është furnizuar QKMF-ja.

Ne kemi pasur një problematikë për të cilën këta pretendojnë se pajisjet nuk janë në funksion edhe po ashtu thonë që në QMF1 nuk bëhen analiza. Pas përfundimit të seancës ata punojnë deri në ora

14:00 mundeni me shku dhe me pa se a punon laborator. Në Lumadh laborator punon, nuk është që s'punon. Kjo ka qenë edhe akuzë në fushatë, por që nuk është që me ka shqetësuar mua për faktin që e kemi ditur që Partia Demokratike do të jetë fituese. Qytetarët kanë ditur me bërë dallimin edhe nuk ka pasur asnjë problem. Pajisjet funksionojnë kjo është e vërteta. Ajo që ju keni parë për bartjen e dozave të cilat gjithashtu informatori ju ka informuar por siç e ka keqinformuar edhe Sylen në postimet të tij publike ju ka keqinformuar. Ka pasur prishje të pajisjeve të biokimisë edhe dozat e gjakut të cilat janë marrë në QMF-1 kanë shkuar për të parë atë testimin e aparaturës e cila gjendet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Safit Idrizit”, te tregu. Kjo është ajo e vërteta që ka ndodhur te pajisjet që kanë qenë jashtë funksionit. Pajisjet janë blerë në kohën kur ai ka marrë mandatin si Drejtor, në ditët e para kontrata është nënshkrua. Nuk e di sa ka qenë çmimi realisht, ato e kanë ftuar një mik, shok i ngushtë i Sinan Behramit dhe Sylejman Mehollit. S'kam dashur me diskutuar këtë temë, po ta them shumë hapur, se kam problem. Ne kemi pasur pajisje të cilat kanë qenë me ragjentë të mbyllur që nuk besoj që e kupton se çfarë është dallimi i agjentëve të hapur dhe të mbyllur dhe cili është roli i tyre dhe cilët kanë më shumë cilësi apo jo ajo është blerë.

Kur e kemi iniciuar procedurën e prokurimit për furnizim kam qenë shumë i bindur që nuk ka me pas asnjë aplikues për shkak që ka me ndalë Lëvizja Vetëvendosje për mos me u hap një laborator i cili prej 80 pacientëve shërbimit do ta çonte 160 totalin dhe kjo ka qenë sfidë. Edhe unë kam ditur që nuk do të ketë aplikues dhe kështu edhe ka ndodhur. Çarë ka ndodhur tjetra çudi operatori i cili ka pruar pajisjen i ka vendosur kod pajisjes edhe në momentin që ti ke dashur me adaptuar reagjentin nuk të ka lejuar për shkak që operatori i cili i ka shitur komunës së pajisjen e ka vendosur një kod edhe kodin nuk e ka sjellë. Ne jemi detyruar, me iniciuar një procedurë në Policinë e Kosovës dhe kemi bërë kallëzim penal që nuk po e sjell kodin e po e pengon punën e laboratorit. Në momentin që ka filluar përgatitja në QKMF, operatori ekonomik brenda 10 minutave është lajmëruar edhe e ka sjellë kodin. Edhe kjo është sfidë, unë e pranoj normalisht unë kam më shumë qejf se ti me e rregulluar këtë punë, por kjo është ajo që ndodh aty realisht edhe ne po punojmë çdo ditë për me përmirësuar këtë.

Kur jam ardhur në laborator i kam gjet aty janë katër pesë kompani të ndryshme të cilat kanë distribucion të specifikuar për reagjent. Nëse një aparaturë që e ke sjellë ti kontratën e ka fituar dikush tjetër, ti nuk ma shet mua dhe pajisja, automatikisht ty të mbetet pa reagjent edhe s'mundesh me shti në funksion. Ky është problemi. Aty tjetra te biokimisti kemi hap konkurs për biokimist s'ka kandiduar askush. Ne nuk kemi as biokimist as radiolog. Unë po kërkoj ndihmën e secilit prej juve që mundet me bind një biokimist me ardhur në konkurset që i hapë QKMF-ja për me aplikuar. Po nuk po na aplikon askush. Një biokimist që e ka pagën 1200 € në QKMF dhe e shet një licencë diku tjetër institucione private ka 1200 € në tre vende edhe nuk intereson me punuar te ne fare. Kjo është e vërteta.

Unë jam shumë i lumtur se dikush prej juve na siguron një biokimist dhe një radiolog për shkak që kemi nevojë. Sa i përket refuzimit të vaksinimit, ne jemi të tretët në nivel të Kosovës për shërbimet e vaksinimit që japim. E kalojmë gjithmonë 90%. Fushata shkon jashtëzakonisht mirë. Është mirë që është cekur. Problemi është tek prindërit që po hezitojnë me marrë vaksinë për shkak që po e dëgjojnë Alfred Cakon edhe të tjerët në You-Tube edhe mandej vjen të bën problem prindi dhe refuzon me marrë vaksinat. Edhe ne kemi punuar shumë për shembull kur ka filluar corona virusi kur kemi dhënë fillim kemi punuar me drejtor të shkollave kemi punuar me arsimtarë me mësimdhënës me i bind prind që duhet me marrë vaksina, por që po ka refuzime, e që nuk është dashur të ketë. Tek gjoba e inspektoratit shëndetësor gjatë fushatës komuna e Vushtrisë

është inspektuar më së shumti nga inspektorati shëndetësor. Tre deri katër vizita në javë i kemi pas.

Nuk ka pasur problem për mua për shkak që e kam ditur se ku jemi unë s'kam kurrëgjë për të fshehur ndërgjegjen kam shumë të pastër mundur me ardhur çdo ditë në komunën tonë kur është gjet tek çështja e administrimit të vaksinave dikush thoshte se i kanë vjedh vaksinat po ato s'i blenë askush ato po hezitojnë me i marrë e lëre me i'u shitë dikujt kjo s'është e vërtetë administrimi ka ndodhur për shkak që Sistemi Informativ Shëndetësor i cili udhëhiqet nga Ministria e Shëndetësisë ka pasur probleme të jashtëzakonshme dhe sot kur po flasim ka mundësi që raportohet që sistemi nuk funksionon në QKMF për shkak që është baza ditore. Administrimi i vaksinave është bërë, librat e protokollit kanë qenë evident. Inspektorati shëndetësor nuk e ka pritur librin me ardhur prej Safet Idrizit të ÇMF 1 dhe tek Ali Kelmendi, po e ka shkruar vendimin, e ka dënua padrejtësisht edhe drejtoreshën edhe shefin e vaksinimit, shefin e SISH-it. Më pas po të njëjtit e kanë hapur sistemin na ka lajmëruar që me i futur në sistem vaksinat të cilat kanë qenë të administruara në librat tonë të protokollit që i kanë dhënë, edhe të njëjtat kanë hy në sistem. Gjoka ka qenë e padrejtë, totalisht e padrejtë. Por kemi qenë në kohë fushatë. Unë e kam kuptuar sulmet që janë bërë dhe nuk ka qenë kjo punë aspak problematike. Më shqetëson fakti që nuk po foli për mungesën e barnave prej dhjetorit komuna e Vushtrrisë nuk është furnizuar me barna nga Ministria e Shëndetësisë që udhëhiqet nga partia juaj. Po flasim për barna esenciale pse nuk e ngritin këtë shqetësim. Në shëndetësi besoni që në momentin që kam marrë përgjegjësinë s'kam bërë kurrë dallime partiake as politike. Jam shumë i lumtur në mënyrën që besoj që udhëheqi që për formën e trajtimit që ju bëj punëtorëve QKMF-së dhe punëtorëve shëndetësor në përgjithësi në Vushtri. Po kisha dashur dhe apeloj që partia Lëvizja Vetëvendosje, kur e takoni ministrin Arben Vitia me i thënë që me rritë furnizimin me barna esenciale. Në fund tha se Komuna e Vushtrrisë është përfituese e një autoambulancë për QKMF nga niveli qendror, dhe ne jemi të fundi që e kemi pranuar këtë furnizim për faktin se është menduar se do të përdoret për fushatë elektorale, por ne nuk e kemi keqpërdorur këtë çështje për poena politike.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- vlerësoi se si anëtare e kuvendit për mandatin e tretë për të dhe shquhet se është goxha realiste, duke mos i hiperbolizon gjërat. Me ju treguar të drejtën kur e kam lexuar këtë raport duke e marrë parasysh me Drejtorin paraprak që u kanë edhe kur e patë sjellë një raport në nivel skandaloz, tani duket që raporti që është ofruar është goxha i detajuar për çka e falënderoj Drejtorin. Pastaj ceku se nuk është e fushës edhe nuk ka dëshirë me hy detaje për shkak se munda me ngec se nuk i di çështjet e shëndetësisë bile bile me tregu të drejtën për një gjë kishte interesim të marrë informatë se qysh i thonë realisht EKG në terminologjinë mjekësore. Përveç informatave që i përmendën edhe parafolësit, mungojnë informatat për laborator dhe për pjesën e shtëpisë rezidenciale. Me tej pyeti drejtorin për mamograf se kur e kemi marrë donacionin dhe qysh janë procedurat për me bë një mamografi në QKMF. Gjithashtu për këtë aparat e EKG-së që nuk e di qysh e ka emrin ndryshe njoftoj se në bazë të përvojës personale i ka rastisë dy herë me dërguar prindërit në vizitë, për shkak të dyshimit për infarkt edhe nuk është në rregull që në urgjencë me e anashkaluar mundësinë për infarkt kur të gjitha janë kanë të gjitha simptomat me arsyen që nuk kemi EKG edhe nuk mundem me ofruar këtë shërbim. Informata është që urgjenca e ka EKG po por që nuk e kanë futur në funksion, apo nuk kanë dashur ta oftojnë këtë shërbim për arsye që nuk i njohim. Nga vizita personale që ka pasur me prindërit e saj aty ka papërgjegjësi nga stafi për sa i tako ofrimin të shërbimeve. Ë gjithashtu prej përvojës personale për pjesën e vaksinimit, vlerësoi se si nënë e dy fëmijëve, ka përvojën që shumë prindër hezitojnë të japin vaksinat për fëmijët e tyre deri sa ata të fillojnë të flasin, kjo për faktin se ka frikë se mos po ka ndonjë ndikim negativ tek fëmija. Për ta përforcuar akoma më shumë dyshimin është fakti se

pediatri inkurajon që deri sa fëmija të filloj të flasë të mos i marrin këto vaksina. Prandaj në këtë kontekst e mbështet diskutimin e Drejtorit të Shëndetësisë se ka hezitime për procesin e vaksinimit. Kështu që këtë pjesë nuk e fajësoj drejtorinë po është problemi tek prindërit edhe kuptoj plotësisht se unë edhe si një grua edhe si një vajzë edhe si një profesioniste që kam kryer edhe master, hala jam në dyshime për këtë pjesë kështu që për këtë pjesë e amnistoj drejtorinë se nuk ka aspak faj, por faji qëndron tek prindërit duke përfshi edhe atë.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit- Përshëndetje kryesuese, përshëndetje kolegë asamblesë, përshëndetje drejtorë të drejtorive. Fillimisht edhe unë po dua me ju uruar muajin e Shenjtë të Ramazanit edhe krejt agjëruesve dhe agjërim të lehtë e të pranueshëm. Nuk e pata njëjtë sot me dalë me fol. Po tek çështja e shëndetësisë po besoj që më takon se vij prej një familje që jam rrit duke i vizituar Qendrat e Mjekësisë Familjare, duke i vizituar spitalet. A është shëndetësia në komunën Vushtrrisë në situatën më të mirë? Normalisht që nuk është. A është qysh po e bëjnë opozita? Normalisht që nuk është. Me Drejtorin e Shëndetësisë z. Lorikun njihet prej fëmijë, për që jam shok i mirë me Lorikun nuk e ka fare problem ballafaqimin me të në kuvend për interes të qytetarëve. Po Loriku mendoj që është drejtori më i mirë i shëndetësisë që ka pas ndonjëherë komuna e Vushtrrisë. E di unë që ka opozitarë në Vetëvendosje që ja mbajnë si ekspertë të shëndetësisë dhe ju adresua anëtares së kuvendit znj. Dritë se i ka informatat shumë të gabueshme se është mirë ju me e pyet Arben Vitinë në Spitalin Regjional në Mitrovicë ku Reparti i Ortopedisë është njëri prej reparteve më të suksesshme, jo pse shërben vëllai i tij po e thonë statistikatat e me ju marrë juve me vizituar ju vjen keq ku ndërrohen doktorët që i kryejnë minimumi shtatë operacioni në ditë. Asnjë investim nuk është bërë, asnjëherë nuk është vizituar. Po ju kthehem materialit që le të shkojmë pak më për toke. Po e urrej këtë gjuhën me dalë veç me fol gjenerale, jepni ide. Ju përkrahem kudo që e keni mirë ju përkrahim. Mirëpo mos dilni këtu, kjo është keq, kjo është keq, kjo është keq! Tregoni pra se si është mirë? Unë e lypa fjalën për me e ngrit si shqetësim se edhe unë e kam pas informacionin që ka mungesë të barnave. Sot për shembull ka operacione në spital të Mitrovicës që dështojnë për gjëra esenciale. Është spital regjional ku shumica e pacientëve 50% janë të Vushtrrisë. Ka repart që nuk ekziston në spital. A ke ortoped në spital të Vushtrrisë? A kemi tash është konkursi po deri sot s'ka pas. Domethënë një qytetar i Vushtrrisë për probleme ortopedike duhet të adresohet në Mitrovicë për këtë po e përmendi si spital regjional. Andaj jemi qytetarë të kësaj komune, jemi shokë, jemi miq, të ruajmë pak gjuhën se donë me es- kaluar goxha.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-përderisa Drejtori i Shëndetësisë ishte duke ju përgjigjur kolegëve, mua më shkruan një banor i fshatit Lumadh dhe më njoftoi që në QMF në Lumadh bëhen vetëm tre analiza laboratorike. Është e vërtetë apo jo kjo informatë?

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- Atëherë drejtor nuk më përgjigje në pyetjen se sa shkolla nuk kanë furnizime me ujë të pijes dhe qasej në kanalizim. Gjithashtu do ishte mirë që në mbledhjen e ardhshme të kuvendit me i sjellë emrat e komisionit që i ka bërë specifikat e pranimit dhe vlerësimit të laboratorëve të cilat janë pranuar.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit- tha se sa i përket raportit dhe qasja e drejtorit vlerësoi se kemi të bëjmë me një raport të detajuar për periudhën janar-dhjetor 2025. Dhe shtoj se ka dy kërkesa. E kam një kërkesë që e kishe cekur në raport që tek mjekimi paliativ po kujdesin edhe për pacient nëpër shtëpi. Ndërsa e kam një shqetësim që mendoj është edhe një procedurë burokratike që realisht edhe mjekët po i ngarkon tek pacientet me sëmundje kronike ku vazhdimisht kërkohet një recept përshkrimi i terapisë ku shumica e pacientëve, zakonisht raportet e tilla i marrin tek mjekësia sekondare për shembull tek diabetikët tek endokrinologu. Andaj konsideron se është e palogjikshme ajo procedurë me u thjeshtësua me u heq sepse ata janë pacientë që vijnë me listë

prej ministrisë. Pastaj furnizimi me barna shumë mirë që e ceke në këtë muaj nuk ka pas mjaftueshëm prandaj kisha pas dëshirë që ajo procedurë edhe me i liruar mjekët edhe mos me i ngarkuar mjekët e mjekësisë familjare me u marrë me pacientë me i trajtuar. Andaj është mirë me parashtruar një kërkesë të ministrisë se e di që ndoshta ministria ju ka obliguar që me bë përshkrimin se nuk është e drejtë për një terapi të endokrinologut me përshkruar një mjek i mjekësisë familjare.

Mendoj që ministria po obligon me shkel ligjin. Ai e përgëzoj për raportin Drejtorin e Shëndetësisë por kisha këtë shqetësim edhe njëkohësisht që u cek edhe prej asamblistëve shërbimit që është ndërpre nëpër qendra nëpër bashkësi lokale ofrimi i shërbimeve të stomatologjisë po unë e kam një kërkesë që me bë shërbimi stomatologjik 24 orë në komunën e Vushtrisë, dhe mendon se nuk është shumë e nevojshme me i shpërndarë nëpër qendra se besoj që më mirë është me u rrit numri i shërbimeve brenda repartit që mendoj është shumë e nevojshme se pacientët e Vushtrisë duhet me u trajtuar në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë sepse tek ne nuk ka shërbim stomatologjik 24 orë e di që ke iniciativë dhe të përgëzoj drejtor por kisha pasur dëshirë që edhe të mbështes edhe publikisht është edhe kërkesë e kuvendit që me ofruar shërbimin 24 orë për ë pacientët për nevojat emergjente në repartin e stomatologjisë.

Lorik Maxhuni, drejtor i DSHPS-së- duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarë e kuvendit njoftoi e parë është tek EKG-ja. Është e vërtetë që ne kemi këtë aparaturë por nuk kemi material shpenzues. Jemi duke bërë të pamundurën që me u furnizuar, besoj që sot furnizohet pasi që dje kam pasur informata që kemi mbetur pa furnizim. Normalisht po mundohem me kapacitete që ka komuna Vushtrisë me një kontratë e cila është shumë e vogël me u furnizuar me aq sa është e mundur. Është problem tek KG-ja për shkak që kur ka marrë pozitën e Drejtorit të Shëndetësisë e kam parë që realisht ka pasur një farë lloj prej shumicës së stafit të vjetër që nuk kanë dashur me bë EKG ndoshta për shkak pasi që një kohë të gjatë nuk e kanë përdorur, edhe nuk kanë ditur realisht me përdorë. Unë e kam bërë një trajnim për EKG. E patëm këtë çështje të diskutimit në mbledhje dje në QKMF që ndoshta është e nevojshme edhe një trajnim me ja bë stafi në këtë qendër. Problemi tjetër është tek ne po flasim për mjekësi familjare ku zakonisht një përqindje të madhe të mjekëve kemi mjekë të përgjithshëm që dalin prej bankave shkollore të Universitetit të Prishtinës. Edhe ata që merren mjekësi e dinë dhe e kuptojnë rëndësinë e leximit të saktë të EKG-së edhe interpretimit të saj dhe sa e vështirë është.

ër këtë arsye shumica e tyre dhe hezitojnë me bërë leximin e EKG, dhe kështu gjithmonë udhëzohet për në shërbimin sekondar.

Megjithatë në urgjencë EKG, funksionon. Unë nuk besoj që ka neglizhencë në urgjencën tonë tek rastet të cilat mund të ketë raste sporadike, por në shumicën e rasteve në urgjencën tonë nuk ka neglizhencë të asnjë pacienti, sidomos të simptomave të infarkt të cilat janë të vërejtshme. Besoj që të gjitha procedurat merren në raport aty është cekur që koha e trajtimit të pacientëve në urgjencë është zgjatur, që flet për një cilësi më të më të madhe për shkak që i kushtohet vëmendje më të madhe qytetarëve. Pastaj tek mamografia, ne kemi marrë mamografinë në një bashkë donacion me Islamic Kosova.

Problemi qëndron te leximi i radiografive. Unë i kam shkruar Ministri Shëndetësisë në një farë lloj forme që të obligojë spitalin Sheik Zajed që të na e lexojë mamograficitë. Nuk kam has në mirëkuptim! Ne kemi pasur takime të rregullta me spitalin për shkak që ai udhëhiqet nga SHSKUK-ja kemi kompetenca të ndara. Ne kemi pasur për shembull një rast kur gratë e veteranëve dhe dëshmorëve kanë kryer mamografinë, por që të njëjtave nuk i është bërë leximi dhe interpretimi nga radiologjia shqiptare Sheikh Zayed. Jemi munduar me gjet një modul moduli që

ata kanë propozuar është i paarritshëm për shkak që baza e legjislacionit të kujdesit shëndetësor na e pamundëson. I kam shkruar Ministrin të Shëndetësisë, ja kam adresuar problemin.

Problemi i radiologut është problem që po na mundon realisht në radiologji. Kemi hapur një konkurs, me sa di tri konkurse kanë dështuar. Për këtë çështje jemi munduar me gjet zgjidhje përmes shërbimeve këshillëdhënëse përmes procedurave të prokurimit kemi hapur dy herë, dy herë nuk ka pasur aplikant, për shkak të pagës edhe për shkak që sektori privat po i merr të gjithë kuadrat e radiologjisë. Në laboratorin në Lumadh vërtetë që bëhen vetëm tre analiza. Edhe ky është një problem i riorganizimit dhe për këtë besoj që kemi me trajtuar një ditë në një seancë ku duhet me pas përkrahjen e juaj me bë një ndryshim të statutit ku obligohem që me i kthyer disa qendra në AMF-ja për shkak që kjo mbas po na penalizon në raport të performancës kur po bëhet tek QMF-ja. Kërkohet që secila QMF me pas laborator edhe realisht momentalisht në gjendje të cilën gjend komuna e Vushtrrisë ku po thuaj që është e pamundur që në të gjitha QMF-të të funksionojë laborator edhe në këtë mënyrë ndoshta ka qenë mirë që me rikthyer në AMF përveç tri qendrave që janë më të mëdha që bënë pjesë Lumadh, fshati Maxhunaj dhe fshati Smrekonicë janë tre lokalitete të mëdha dhe të tjerat me i zbërthyer në AMF.

Një dukuri tjetër është që në disa fshatra, për shembull në Stroc edhe në Skromë nuk janë funksionale. Edhe për ata unë mendoj që kuvendi i komunës duhet me i largu me anë të një propozimi-vendimi që duhet me bë për plotësim-ndryshim të statutit me i largu këto të dyja për shkak që nuk ofrohet shërbim se nuk ka banor në fshatin Shkrom, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është veç një është një banor. Patjetër që nuk është ndonjë lloj sekreti absolut unë mundem me ju drejtuar Drejtorisë së Prokurimit apo QKMF-së nëse kanë në databaz t'i përcjell në email i sheh i vlerëson pa asnjë problem. Tek receta është Sistemi Informativ Shëndetësor që funksionon në Republikën e Kosovës sistem elektronik të gjitha udhëzimet e receta që japin duhen me u fut në sistem për shkak që bëhet një kontroll shumë rigoroz prej inspektoratit shëndetësor. Edhe në këtë pikë ne e dimë që çdo recetë është një farë lloj kontrolli për shkak se sëmundjet kronike mundet shumë lehtë barnat me dërguar në një komplikim tjetër shëndetësor. Prandaj besoj që është i duhur dhe Udhëzimi Administrativ, por dhe rregullorja e Ministrisë së Shëndetësisë na obligon që duhet me pas receta për shkak që është procedurë e tillë të cilën ne nuk mundemi me ndryshuar. Duhet vullnet, tjetër.

Ne kemi mbledhje të kolegjiu me ku diskutojmë, por duhet një vullnet pak më i madh për me rregulluar këtë çështje. Tek stomatologjia 24 orë, e di që është e nevojshme për shkak që është një shërbim të cilin qytetarët e komunës tonë nuk e marrin 24 orë. Drejtohen gjithmonë nëpër qendrat në Mitrovicë. Është lehtë i arritshëm. Momentalisht ka qenë dhe premtim elektorale i kryetarit në fushatë që do ta bëjmë stomatologjinë 24 orë. Ky pa dyshim ky qëllim do të arrihet. Momentalisht për numër të banorëve duhet të ketë 1/mjek-stomatolog për çdo 6.000 banorë. Realisht numri është 10 stomatologë që i ka Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. Po flasim për dy stomatologë të cilët janë në specializim me drejtimin e Ortodoncis që do t'i kthehen QKMF-së, por që aktualisht nuk ofrojnë shërbime për QKMF-në. Gjithashtu po flasim edhe për një mungesë të një punëtore tjetër i cili ka qenë Drejtori i Shëndetësisë i cili ka qenë në një pushim pa pagesë për shkak të një sëmundje që e ka pasur një vjeçare. Gjithashtu një stomatologu është në pushimin e lehonisë. Ne aktualisht veprojmë me gjashtë stomatologë, por besoj që do ta rregullojmë edhe këtë çështje për të rritur numrin edhe për dy stomatologë, për ta çuar gjithsej në 12 dhe me rikthimin e këtyre stomatologëve që janë në specializim, ne do ta bëjmë shërbimin stomatologjik në 24 orë për shkak që është shumë i nevojshëm dhe qytetarët duhet me marrë këtë shërbim për shkak që për shkak të një dhimbje të dhëmbit nuk duhet me pasur nevojë me shkuar në Prishtinë ose në Mitrovicë.

Diellza Pllana, anëtare e kuvendit- e nderuar kryesuese, të nderuar anëtarë të Kuvendit, nuk e kisha në plan me dalë me fol, por marr parasysh ata që u fol këtu edhe marr parasysh faktin që unë jam studente e vitit të gjashtë të mjekësisë e ndjeva si obligim. Fjala jonë këtu ka peshë sidomos kur vjen prej anëtarëve të kuvendit që janë zgjidhur për të tretën herë me radhë siç është Gresa. Unë e kuptoj shqetësimin e anëtares së kuvendit znj. Gresa Muli si prind mirëpo e di që shumë prind të tjerë mund të ndikohen nga ky perceptim i Gresës. Vaksina është arritje ndër shekullore. Në momentin që IKSHPK-ja e rekomandon marrjen e një vaksine, ju si prind, ne si qytetarë absolutisht duhet të mirë informohemi. Për këtë arsye unë kërkoj nga Drejtori për Shëndetësi që fushatat sensibilizuese të prindërve për sa i përket kësaj fushe, këtij shqetësimi që realisht qenka shumë më i madh se sa që unë e kam menduar me qenë më të shpeshta përveç se më të shpeshta po ashtu edhe më efektive. Gjithashtu sa i përket një pjese tjetër që u cekë prej Drejtorit të Shëndetësisë që pjesa e hezitimit të doktorëve të rinj me lexuar EKG unë e shoh shumë më shqetësuese ose bazë shqetësuese sa edhe mungesa e materialit për me u realizuar EKG-ja atëherë kur është e nevojshme. Nuk dua me besu që ka doktorë të rinj që dalin prej bankave të Universitetit të Prishtinës edhe hezitojnë me bë një EKG rastin e dyshimit për infartë për shkak se nuk dinë me e lexuar, në rastet kur ka të tilla raste evidentoni edhe dënoni.

6. Informatë lidhur me lejet ndërtimore, kushte ndërtimore dhe leje rrënimi për vitin 2025;

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- informata që na ka ardhur lidhur me lejet ndërtimore dhe kushtet ndërtimore për vitin 2025 si dhe plotësim ose pyetjet që janë bërë nga kolegja Fatmire Cecelia gjatë KPF-së i kemi marrë këto informata. Pastaj pyeti Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit sa i përket pikës 1.1 të plotësimit që e keni dorëzuar në email-adresë para dy ditësh objekti përballë komunës së Vushtrrisë, jemi duke fol për parcelën ku ka qenë parkingu këtu afër. Si informatë unë po e shoh pak të paqartë ose ndoshta mundet me qenë pak e paqartë edhe për kolegët asamblistë e kemi një vendim të lejes ndërtimor të lëshuar në datë 10.06.2025 ndërsa më poshtë ceket që e kemi një vendim nga organi i shkallës së dytë përkatësisht vendimi nga MMPI-ja i datës 22/02/2024 me të cilin është anuluar vendimi i shkallës së parë cili vendim i shkallës së parë është anuluar, afërsisht po e di rrjedhojën e saj edhe në kohën kur kam qenë unë drejtor kemi pasur raste të tilla kur nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore e kemi refuzuar si lëndë përmes vendimit zakonisht investitorët kanë qenë të prirur që me gjet qoftë lidhje ose me kthyer një vendim dhe me anuluar vendimin tonë të Drejtorisë të Urbanizmit, edhe në raste të tilla Drejtoria e Urbanizmit konform Ligjit, të Ndërtimit si dhe Udhëzimeve Administrative e ka anuluar kërkesën e investitorit. Kemi pasur disa raste që Drejtoria e Urbanizmit ka bërë deri në tre anulime të asaj kërkesë për leje ndërtimore. Andaj nuk është shumë të arsyeshme që anulimi që ju ka ardhur për shfuqizim të vendimit të shkallës së parë nga MMPI-ja që ju të shkoni direkt me dhëniet e lejes ndërtimore, kemi kaluar këndej parë dhe e kemi parë dhe të jeni të bindur që nuk kemi asnjë kriter ligjor të respektuar. Nuk e kam parë projektin, nuk e di çfarë ka dorëzuar në Drejtori të Urbanizmit, por nëse flasim me gjendjen faktike, unë e them me përgjegjësi të plotë që janë shkelur të gjitha kriteret ndërtimore në bazë të Ligjit të Ndërtimit, Ligjit të Planifikimit Hapësinor dhe udhëzimeve administrative.

Sa i përket listës të kushteve dhe lejes ndërtimore, zakonisht ka qenë praktike e kuvendit edhe në vitet e kaluara që lista të sjellët në kuvend. Jemi munduar me shikuar edhe në faqe të komunës por nuk kam hasur një listë të tillë, kështu që do të ishte mirë që ajo praktikë e mirë e kuvendit të vazhdohet edhe tash dhe lista e lejeve dhe kusht ndërtimore të sjellët në kuvend në formë të shtypur për anëtarët e kuvendit.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-lidhur me këtë pikë të rendit të ditës për sa i përket informatës për lejë ndërtimore dhe kushtet ndërtimore, njoftoj se në mbledhjen e KPF kam kërkuar sqarim shtesë sa i përket kësaj informate me qenë se kemi pasur vetëm një fletë me dy faqe, një raport shumë i shkurtë dhe jo i detajuar. Tek pika 1.1 tek ky objekti përballë komunës që e kam cekur edhe në KPF, i nderuar drejtor, meqenëse kryetari nuk është këtu, a ka mundësi me na treguar çfarë ka ndodhur me këtë objekt? Qysh keni lejuar në sy të komunës me filluar me u ndërtuar ky objekt, me i'u mbyllë dritare banesës që është aty afër pothuajse në parcelë të banesës ka filluar me u ndërtuar me mbyllë dritaret, me ju mbyllë ballkonet, banorëve të këtij objektit afër tij. I keni shkelur të gjitha kriteret e lejes ndërtimore, këtu e keni cekë që ju i kemi dhënë leje objektit në muajin e gjashtë të vitit 2025 duke u thirr në vendimin e ministrisë që paraprakisht ju ka dhënë leje me refuzimet e juaja paraprake që kjo ka qenë një nuk e di qysh ka qysh funksionon në Drejtori të Urbanizmit mirëpo me këtë sa e shoh që është një shkelje. Në Komitetin për Politikë dhe Financa mua më është thënë nga kryetari që këtij objekti i' u ka revokuar leja. Drejtor a është revokuar leja? A ka leje? A ka me u ndërtuar ky objekt? Çfarë keni me ndërmarrë ju si Drejtori e Urbanizmit, meqenëse jeni organi që i jepni lejet ndërtimore. Tek objekti te pika 1.2 e kësaj informate e keni cekur këtu që as nuk ka kërkuar leje ndërtimore, as nuk ka leje ndërtimore, as ka kërkuar kurrfarë pëlqimi për leje. A bën me ditë ku është Drejtoria e Inspektimeve apo fare nuk është duke funksionuar, qysh me u ndërtuar objekti 2000 m² në sy tonë që për çdo ditë e shohim shumica prej neve e frekuentojnë atë rrugë edhe komuna mos me ditë që u ndërtua me thënë, s'ka kërkuar leje tash nëse s'ka kërkuar leje le të bënë çka donë le të ndërton çka të donë, le ta shkatërron tokën bujqësore.

Te ndërtesa, në rrugën "Ismail Qemajli" ku ka kërkuar sqarim shtesë e keni dhënë një arsyetim të pabazë, dhe paraprakisht i keni dhënë lejen dhe kushtet për leje ndërtimore ndërtuesit mandej e keni sjellë në kuvend këtu me shpronësu atë pjesën tek lokacioni konkretisht tek fi bello" mahalla që ka qenë ju na keni qitë para aktit të kryer, jeni tallur me ne me të gjithë anëtarët e kuvendit, sepse të gjithë kemi votuar <pro> sepse arsyetimi i kryetarit në këtë foltore ka qenë që votoni sepse ka me u zgjeruar rruga prej vendit të quajtur tek <kafja e sejdes> . Qysh e dimë ne prej udhëkryqit tek Selact ka me u zgjeruar rruga deri tek lokali Sueno që është aty afër Real market në kryq të rrugës. Prandaj shtroj ne për çka jemi këtu me na vu në lajthitje duke na mashtruar para syve të gjithëve këtu ne kemi votuar kemi qenë të pajtimt me zgjeruar rrugën sepse ne si grup çdo herë kur është interesi i përgjithshëm qytetar nuk jemi kundër mirëpo jo këtu ka pasur mashtrim dhe me këtë çështje duhet të merret prokuroria. Ne kemi votuar me këmbyer pronën komunale, për zgjerim rruge, mirëpo e vërteta është se ai investitori e ka marrë lejen shumë më herët, dhe kuvendi vetë i' a ka bërë aministrimin. Edhe në këtë rast është dashur të alarmohet Drejtoria e Inspektimeve duke dal në teren dhe në shikim të vendit dhe gjendjes faktike del se a ka leje ndërtimore dhe kur është lëshuar ajo leje ndërtimore, dhe se ka komunikim zyrtar mes Drejtorisë së Urbanizmit dhe asaj të Inspektimeve se me të vërtetë është shumë shqetësuese kjo çështje. Mandej vlerësoi se kjo është për mua shumë shqetësuese dhe kërkoj nga organet që të merren me këtë punë sepse askund nuk është zgjeruar rruga, dhe se në çdo vend janë shkelur vijat ndërtimore tek ky objekt prej ku ka filluar tek lagjia "Selaci" aty e deri tek lokali "Sueno" është shkel vija ndërtimore e që nuk është në rregull sepse qyteti po bëhet jo funksional me rrugë shumë të ngushta, ku as autobusi nuk mund të kalon aty, nuk e di pse po veproni kështu për qytetin po shkatërrohet për 100 vjet e ardhshme sepse atë objekt nuk mundesh ta rrënoh sepse e ke pajisë me leje ndërtimore.

Më tej pyeti Drejtorin e Urbanizmit pse nuk është e publikuar lista për kushte ndërtimore dhe për lejen ndërtimore, sepse kjo është shumë e rëndësishme, të dihet për kushtet ndërtimore dhe për leje

ndërtimore se kur qytetarët aplikojnë për leje ndërtimore, për kushtet ndërtimore dhe kur ja jepni, sepse keni rastin që dikush aplikon sot e merr pasnesër e dikush pret me vitet e tëra.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- Informata e Drejtorisë së Urbanizmit tregon qartë se prioriteti i kësaj qeverisjeje është betoni dhe jo qytetari. Nga 81 kërkesa për leje ndërtimi, pothuajse gjysma (34 leje) i përkasin Kategorisë II – pra objekteve kolektive dhe industriale. Përderisa lejet për ndërtesa të larta jepen me shumicë, në këtë raport nuk shohim asnjë rresht për hapësirat gjelbëruese. Pyetja për ju është: Sa është përqindja e hapësirave publike që këto 34 leje i kanë siguruar qytetit tonë, apo po vazhdojmë me betonizimin e egër vetëm për interesa të ndërtuesve? Gjithashtu, në faqen 3 të raportit, shohim se 15 kërkesa janë ende në procedurë. Ky është treguesi i burokracisë që i lodh investitorët dhe qytetarët që presin me muaj të tërë para dërve tuaja. Pyetjet për Drejtorin Jusufi: z. Drejtor, në këto 34 projekte të Kategorisë II që keni miratuar, sa metra katrorë hapësirë gjelbëruese dhe kënde lojërash janë siguruar? Sa është koha mesatare që një dosje rri në sirtarët tuaj para se t'i kthehet përgjigje qytetarit, duke pasur parasysh zvarritjen e 15 kërkesave që figuron në raport?

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit- I nderuar drejtor të falënderoj për këtë raport dhe bëri pyetje? A ka mundësi të paraqit lista e zyrave projektuese që kanë pasur më së shumti projektet të merituar gjatë vitit 2025? Më intereson ato zyrat projektuese numrin e saktë gjithsecila sa i ka, sa projekte janë miratuar për secilën zyrë projektuese dhe sa ka qenë koha mesatare e trajtimit për secilën prej tyre. Por ka edhe një shqetësim të paktë këtë shqetësim e kam për shkak se nëse një investitor investon 3 milion nuk është në gjendje do rrethoja me i vendos, kjo thjesht përpos që është e turpshme është edhe tepër e rrezikshme. Duhet thjesht të mendojmë që rrezikohen fëmijët tonë kur nuk është në gjendje disa rrethoja me i vendos një ndërtues që investon 3 milion unë nuk pajtohem me këtë gjendje. Ne jemi për me i përkrah me jep leje sa më shpejt me krijuar kushtet për investitorët, por nuk pajtohem që ai mos me vendos një rrethojë pa marrë parasysh kush është. Me të vërtetë është shqetësuese. Ndoshta janë afër shkollave nuk ka rrethojë. Nuk dua me fol për objekte individual. Nuk po më intereson kush është absolut. Rrethojën duhet me vendos mos me mund fëmija im me hy brenda atij rrethi dhe me u rrezikuar jeta e tij. Nuk po më intereson rrethojën duhet me pasur çdo objekt edhe nëse ka investuar e ka prerë rrugën asfaltin e i ka investuar 2 milion euro 2 metra asfalt duhet me i shtruar edhe ai duhet me u detyruar për këtë, ndryshe është e palogjikshme dhe e palejuar.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se në fjalimin e parë që e mbajta para rendit të ditës unë ju thashë qëllim i kësaj qeverie janë veç dy gjëra, dhe atë tenderët e mëdhenj edhe tokat, ndërtimet. Andaj shtoj se a po e shihni që krejt puna esenca e qeverisë të kryetarit z. Idrizi bazohet ose kulmon me qëllimin e vetëm tenderët milionësh edhe tokat, ndërsa ne i marrim disa sende të vogla nga pak.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit- deklaroi se ndoshta u keqkuptova më herët, sepse ai asnjëherë nuk kërcënon. Unë veç po kërkoj prej juve me u bë një grup i mirë. E për këto probleme që po diskutoni do të qëndron konsistent deri në fund, shpreson që edhe opozita do ta mbështet në adresimin e interesave qytetare.

Drilon Jusufi, drejtor i DUMM-së-tha se, si Drejtori e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Midisit kemi një staf të përbërë nga disa arkitektë, inxhinierë, juristë, të gjitha kërkesat për kushte dhe leje ndërtimore si dhe leje rrënimi, ato kalojnë për disa filtra para se lëshohen këto vendime. Sa i përket transparencës së këtyre vendimeve, ato janë publikuar edhe në faqen e komunës të Vushtrrisë, lejet ndërtimore, kushte ndërtimore dhe po ashtu mund të vini t'i shikoni dhe në zyrat tona edhe për afatet e lëshimit të këtyre kushteve dhe lejeve ndërtimore. Gjithashtu secili nga ju jeni mirëseardhur.

Sa i përket pyetjes së anëtarit të kuvendit z. Berat Sadiku, te pika 1.1 tek objekti mbrapa komunës këtu kemi pasur një refuzim nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të komunës e Vushtrrisë dhe pas këtij refuzimi të kërkesës së palës, atëherë pala ka dërguar një kërkesë tjetër në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor ku është kthyer një përgjigje për rishqyrtim dhe rivendosje në Drejtorinë e Urbanizmit. Pastaj ne pas shikimit të kësaj lëndës dhe zyrtarët tanë në pajtim me legjislacionin në fuqi, ligjet e ndërtimit dhe normat e planifikimit hapësinor atëherë i kemi lëshuar këtë leje ndërtimore duke respektuar dhe ndriçimin dhe distancat nga objekti mbrapa kësaj parcele. Çdo informatë shtesë për këtë lëndë mund të vini në zyrat tona të bëni ndonjë kërkesë. Lidhur me objektin tek Ura e Sitnicës njoftoj se gjatë kohës sa ka qenë drejtor nuk është bërë ndonjë kërkesë për kushte apo për leje ndërtimore por më herët nuk e di a ka pasur ndonjë kërkesë për atë parcelë apo jo. Ajo është përgjegjësi e Drejtorisë së Inspektimeve. Tek rruga “Ismajl Qemajli” po ashtu objekti në fjalë domethënë leja ndërtimore dhe kushtet ndërtimore janë lëshuar sipas profilit të rrugëve në Planin Zhvillimor Komunal të cilat janë të respektuara në leje për punën e respektimit në vend të ngjarjes domethënë është Drejtoria Inspektimeve e cila merret në inspektimet e vijave ndërtimore të atyre objekteve.

Lidhur me hapësirat gjelbëruese, për hapësirat gjelbëruese zakonisht në kushtet ndërtimore dhe në lejen ndërtimore ne e kemi kërkesën që të respektohen. Po ashtu ligjërisht është i kërkuar. Ka raste kur disa investitorë apo investues ndoshta nuk i respektojnë, nuk i bëjnë hapësira gjelbëruese, por me leje janë kushte kryesore që të lëshohet një leje ndërtimore. Objekti që ishte temë diskutimi ka leje të ndërtimit, por për momentin kam bërë disa tejkallime sipas informatave që kam në Drejtorinë e Inspektimeve, kam bërë disa tejkallime të vogla për ata për ata i kanë ndërprerë punimet dhe nuk e di se do të vazhdoj tutje lënda e saj leje ka për tejkallim është Drejtoria e Inspektimit që mund t'i bësh pyetje në atë drejtori. Sa i përket rrethojave të ndërtesave janë të obliguara po ashtu që të vendosen gjatë ndërtimit. Ajo përgjegjësi është e Drejtorisë së Inspektimit. Duhet inspektorët e ndërtimit ashtu edhe janë të obliguar të dalin në teren dhe të inspektojnë ndërtuesit se a i kanë vendosur rrethojat e sigurisë në punë.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se pyetjet të cilat i parashtruan kolegët e tij, në asnjërin prej tyre drejtori nuk dha përgjigje. Këtu u tha që ky objekti që ka filluar të ndërtohet afër objektit të komunës, asnjë standard urbanistik dhe të lejes ndërtimore nuk e ka respektuar. Me fjalë tjera ai ndërtim si tillë nuk e plotëson asnjë kriter urbanistik, ndërtimor. Tutje shtoj dhe vlerësoi se Drejtori i Urbanizmit është në hall të madh se ka për t'i miratuar krejt këto të “zezat” që kanë me i bë pushteti aktual, i vjen shumë keq prej tij. E dyta pyetja tjetër ishte rruga tek lokali i quajtur “Sueno”, ne kemi kërkuar ndërrim-këmbim të pronës komunale me pronën private, pyetja është a është bërë ky ndërrim i pronës? dhe se cilën pjesë e ka përfutur komuna në sajë të këtij këmbimi, si dhe a është realizuar zgjerimi i rrugës ashtu siç ishte kërkuar në vendimin e kuvendit që e kemi aprovuar në shtator të vitit 2023.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- tha se nëse Drejtoria e Urbanizmit ka vendosur njëherë me e refuzuar këtë lëndë dhe nëse pala ka ushtruar ankesë në shkallën e dytë dhe shkalla e dytë e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, nuk ka mundur prapë që ky staf i Drejtorisë së Urbanizmit kur e dina që ka arkitektë dhe inxhinierë me vendos konform ligjit dhe me lëshuar leje ndërtimore. Dhe shtoj se nuk e ka parë projektin po nga ajo çfarë është në terren nuk ka asnjë kriter të respektuar as të Ligjit të Ndërtimit e as të Udhëzimeve Administrative. E dimë që udhëzimet administrative, thonë që duhet me i marrë parasysh edhe ndërtesat ekzistuese. E kemi një objekt shumë banesor që ka ndriçim edhe nga ana e këtij objektit. Nuk e di sa ka do të shkojë ky objekt, po distancat, kriteret janë fatkeqësisht nuk janë në terren ata që e shoh nuk janë respektuar.

Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit-tha se nuk doli në foltore për të i'a bërë avokatin askujt, dhe vlerësoi se nuk është në rregull, që një lokal afër objektit që po diskutojmë t'i lejohet të ndërtoj dhe të pajiset me leje ndërtimi, dhe një lokal tjetër të i mohohet kjo e drejtë, sepse kjo po i bie shprehur figurativisht me e shua si biznes dhe me ja devaluat pronën e tij ndoshta milionëshe. Ai shtoi se në këtë rast është dashur të futet një kriter shtesë, që mos të lejohet të shtohet mbi 450 m², por nuk mund të mos i jepet leja e ndërtimit.

7. Raporti i sistemit të menaxhimit të performancës për vitin 2024.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka publikuar raportin e performancës të komunave i cili përfshin periudhën janar-dhjetor 2024 i cili prezanton rezultatet e komunave në 16 fusha të kompetencave që janë nën përgjegjësitë e tyre përmes 93 treguesve sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës të Komunave. Nga ky raport shihet se komuna e Vushtrrisë është e renditur me një përqindje mesatare prej 73.27% dhe si pasojë e kësaj komuna e Vushtrrisë nuk është përfituese e garantit të performancës për vitin 2024. Raporti analizon dy aspekte kryesore, mënyrën e qeverisjes së komunave sipas legjislacionit në fuqi dhe ofrimin e shërbimeve në aspektin cilësor dhe sasior.

Sa i përket performancës specifike sipas fushave, komuna e Vushtrrisë ka nivel të dobët të performancës në këto fusha: barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare, zhvillimi ekonomik lokal, përfaqësimi gjinor sipas komunave, infrastruktura rrugore dhe hapësira publike. I kam shkoqitur disa prej tyre, tek barazia në punësim kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësimin komunal si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komunë. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale. Në këtë fushë mesatarja e komunave të Kosovës është 58,11% kurse komuna e Vushtrrisë është e renditur nën këtë mesatare me përqindje 44.58. Sa i përket zhvillimit ekonomik lokal, kjo fushë matë aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktiviteteve në nivel lokal, duke mobilizuar pronat komunale dhe përditësimin e rregullt të regjistrimit të tatim paguesve si dhe shkallën e inkasimit të tatimit në pronë. Këtu kemi katër tregues, dy prej të cilëve po i potencoj. Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal ku komuna e Vushtrrisë është në një nivel të dobët dhe niveli i mbledhjes së faktuarve tatimit në pronë. Edhe këtu komuna e Vushtrrisë prej 100% ose 100 pikëve është e renditur dobët vetëm me 50% ose me 50 pikë. Tek përfaqësimi gjinor mesatarja në Kosovë është 49.77%, kurse komuna e Vushtrrisë edhe këtu nuk është e renditur mirë me 52.06. Treguesit për këtë pikë janë gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive, gratë e emëruara në pozita politike në komunë dhe barazia gjinore tek përbërja e këshillave të fshatrave.

Pika tjetër e kemi të hapësirat publike në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale komunat janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e të parqeve dhe hapësirave publike. Këtu i kam paraqitur dy tregues sipërfaqe e hapësirave të gjelbëruara që u cekë edhe më herët tek lejet ndërtimore dhe hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik. Kur ke dhe më herët fjala për siguri në qytet, duhet të potencojmë se sa më shumë ndriçim publik siguria e qytetarëve është më e madhe. Dhe krejt në fund komuna e Vushtrrisë duhet të angazhohet në zbatimin e plotë të standardeve minimale të konsultimeve publike duke mundësuar pjesëmarrje aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Përfshirja më e gjerë e qytetarëve në proceset buxhetore dhe në hartimin e planeve zhvillimore do të kontribuojë drejtpërdrejtë në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës. Në këtu po diskutojmë edhe e kemi besimin e qytetarëve edhe për juve të

nderuar asamblistë edhe për qytetarët. Por po e shohim që praktika e kësaj qeverisje lokale po vazhdon, nga fakti se nga 14 Drejtori sa i ka komuna e Vushtrisë këtu tash e kemi prezent vetëm një. Unë më herët e llogarita se kenë dy drejtorë, dy me 14 i bie që janë vetëm 14% e drejtorëve. Kurse tash e kemi veç një drejtor. Kjo paraqet, diskriminim, nënçmim, përbuzje edhe ndaj qytetarëve ndaj neve si kuvendarë.

Islam Latifi, koordinator i MPK-së në Komunën e Vushtrisë-pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi: për të pasur më të qartë ju në cilësinë e anëtarëve të kuvendit dhe për të sqaruar dilemat e ngritura në KPF në lidhje me hartuesin e këtij raporti ju njoftojmë se aktin përcjellës për këtë raport për shqyrtim të tij në KPF dhe Kuvend e kemi hartuar ne në cilësinë e koordinatorit ndërsa Raporti i publikuar i Performancës Komunale për vitin 2024 është shtojcë e aktit përcjellës, i cili raport derivon nga Sistemi Elektronik i menaxhimit të performancës, pra është produkt i punës së zyrtarëve raportues komunal të cilët prej lansimit të thirrjes për raportim nga ana e Departamentit të Performancës në MAPL për 45 ditë rresht vendosin të dhënat e kërkuara duke i shoqëruar ato me dokumentim. Pra raporti gjenerohet dhe përmbledhet nga sistemi apo platforma elektronike. Duke qenë se një prej treguesve të këtij sistemi që i përket fushës së përgjegjshmërisë komunale e që është diskutimi për raportin e performances komunale për vitin paraprak, ne sikurse çdo vit tjetër e kemi sjellë këtë raport për shqyrtim dhe diskutim në këtë seancë, dallimi qëndron vetëm në faktin se ky raport do të duhej të diskutohej para muajit shtator të vitit të kaluar, mirëpo për shkak të vonesave në publikim nga MAPL-ja dhe mbajtjen e zgjedhjeve, ka qenë e pamundur të sjellët në afatin e paraparë me Ligjin për performancën komunale.

Në aspektin sipërfaqësor sa i përket vlerësimit në sistem, është e mjaftueshme që ky raport të jetë pjesë e rendit të ditës për diskutim, pra nuk matë aspektin kohor dhe kualitativ të diskutimit të tij, megjithatë në esencë ka të bëjë me diskutimin e çështjeve apo fushave veç e veç që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe nuk nënkupton apriori kritikën apo kundërshtimin e tij. Ky raport përfshin 16 fusha të kompetencave komunale dhe 93 tregues matës, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi mënyrën e qeverisjes, nivelin e zbatimit të ligjit dhe cilësinë e shërbimeve që u ofrojmë qytetarëve. Sipas vlerësimit dhe përmbledhjes së vlerave apo përqindjeve, Vushtri ka arritur një performancë mesatare prej 73.27%, duke u renditur mbi mesataren e komunave të Kosovës. Ky rezultat është një dëshmi e angazhimit të administratës komunale, e bashkëpunimit institucional dhe e përkushtimit për të përmirësuar vazhdimisht këto shërbime. Megjithatë, ky raport nuk duhet të shihet vetëm si një arritje statistikore, nuk ka për qëllim vetëm renditjen e komunave, por rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Ai është një pasqyrë reale e punës sonë na ndihmon të kuptojmë ku qëndrojmë dhe ku duhet të përmirësohemi pra një udhërrëfyes për hapat e ardhshëm. Raporti thekson dhe rekomandon disa fusha ku kërkohet angazhim shtesë, ndër to:

- Rritja e përfshirjes së personave me nevoja të veçanta;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza;
- Zbatimi më efektiv i lejeve mjedisore;
- Hartimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike komunale, si Harta Zonale, Plani Operativ Emergjent Lokal, Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal, Plani për menaxhim të integruar të mbeturinave, Plani i Mobilitetit (në proces).
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse;
- Adresimi më i plotë i rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit;
- Rritja e inkasimit për menaxhimin e mbeturinave.

Këto rekomandime nuk janë kritika, por mundësi për përmirësim. Ato na obligojnë që të reflektojmë me seriozitet dhe të ndërmarrim masa konkrete, të planifikuara dhe të matshme. Është me rëndësi që ky Kuvend ta trajtojë këtë raport jo vetëm si dokument informues, por si bazë për:

- Rishikimin e prioriteteve buxhetore;
- Forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes;
- Rritjen e transparencës institucionale;
- Thelimin e bashkëpunimit me qytetarët.

Rezultati prej 73.27% është një bazë e mirë, por synimi ynë duhet të jetë avancimi i mëtejshëm, duke synuar standarde edhe më të larta në vitet në vijim. Në fund, dua të theksoj se performanca komunale është përgjegjësi e përbashkët – e ekzekutivit, e këtij Kuvendi dhe e çdo zyrtari publik. Vetëm përmes bashkëpunimit institucional dhe vendimmarrjes së përgjegjshme mund të sigurojmë zhvillim të qëndrueshëm dhe shërbime më të mira për qytetarët tanë. Ju faleminderit për vëmendjen.

8. Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2025.

9. Pyetje dhe përgjigje:

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-duke ju referuar seancën të Kuvendit të Kosovës që është mbajtur me datën 21 shkurt ku është aprovuar buxheti i Republikës së Kosovës nga Ministri i Financave është thënë që 11 komuna të Republikës së Kosovës nuk e kanë dërguar me kohë nuk i kanë miratuar buxhetet komunale me kohë mirëpo mbas takimeve që atje kanë pasur dy komuna pastaj janë përfshirë në buxhetin e Republikës. E kemi parë që është përfshirë komuna e Prishtinës edhe komuna e Shtimes dhe kanë mbetur edhe nëntë komuna. Pyetja ime për kryetarin e komunës është, pra ka mbetur nën komuna pa përfshirë në buxhetin e republikës. Pyetja ime është a është e përfshirë Komuna e Vushtrrisë në buxhetin që është miratuar në Kuvendin e Republikës apo Vushtrria është në mesin e atyre nëntë komunave të cilat kanë mbetur pa u përfshi në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe kjo pastaj do të jetë shumë problematike për realizimin edhe të investimeve kapitale dhe punëve të tjera të cilat janë në komunë.

Abit Abiti, ZKF- sqaroi se komuna e Vushtrrisë e ka dorëzuar buxhetin e saj në pajtim me nenin 62 pika tretë të Ligjit të Financave Publike, d.m.th. para miratimit të buxhetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës edhe ata Ministria e Financave kanë qenë e obliguar që me bë pjesë të Ligjit të Buxhetit edhe vendimin e buxhetit edhe tabelat e buxhetit të komunës të Vushtrrisë. Unë këtë informacion e kam marrë të mirëqenë që e kemi dorëzuar me kohë buxhetin domethënë para miratimit në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo tash do të interesohem a është ajo veç që ka thënë ministri se ne me domethënë e kemi dorëzuar shumë më herët para aprovimit në Kuvendin e Kosovës.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- parashtroj disa pyetje dhe atë si në vijim: Kam informata që tri ekipe njëra është në Super Ligen e Kosovës dhe dy ekipe të tjera në Ligën e parë që janë duke u tërhequr nga garat, dhe arsyeja është mjete financiare. A ka mjete financiare të mjaftueshme për vitet 2026 dhe 2027 komuna e Vushtrrisë konkretisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për t'i financuar dhe për të i'u dalë në ndihmë sa do pak këtyre klubeve?

Pastaj edhe njëherë ju drejtua Drejtoreshës të Arsimit se po merret shumë me ligj e ligjin e ka vetë në dorë, te Drejtoria e Arsimit ku së paku deri 10-të drejtorë janë duke u sjellë nëpër oborre të shkollës e të cilët i kanë kryer nga dy mandate dhe ende nuk po zbatohet ligji që të tërheqin nga pozitat që i kanë përfunduar realisht. Prandaj pyetja është se kur do të ndërmerren masa për zbatimin e ligjit për t'i liruar pozita e përfunduar këta drejtorë dhe kur do të vendosen drejtorët e rinj në baza ligjore? Po ashtu ka disa drejtor në disa shkolla të cilët po vendosen në pozita pa u shpallur fare konkursi. Një pyetje tjetër për DKA-në është se kemi afër 50 mësimdhënës që nuk janë në listat e pagave, cilat veprime i keni ndërmarrë për këto raste? Për Drejtorin e Shërbimeve Publike pyeti se përse në rrugën “Fazli Shabani” e gjithë rruga është e ndriçuar, ndërsa tek familja Kutlllovci, është e vetmja shtëpi që nuk ka ndriçim publik?

Mbledhja përfundoj në ora 12:30

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-34/26 26.03.2026

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË: 5 MARS 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, dhe filloj në orën 11:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Gresa Muli, , Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Melihate Basholli-Latifi, Mentor Hasani, Pllumb Maliqi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Behar Duraku, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Hava Rruka-Mlinaku, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzi, dhe Stefan Markovic.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhergrova drejtorët e drejtorive komunale, Komandanti i Policës në Vushtri, kreu i Bashkësisë Islame në Vushtri, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, anëtarë të familjeve të dëshmorëve, përfaqësues të subjekteve politike në Vushtri, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtarë tjerë komunal.

Në fillim të mbledhjes u intonua himni kombëtar dhe ai shtetëror i Kosovës, në nderim të jetës dhe veprës së Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe Epopesë së UÇK-së.

Më pas kuvendi me një minutë heshtje nderoi jetën dhe veprën e Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe gjithë të rënëve për liri.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-në adresimin e saj para kuvendi dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë deklaroi: Jam e nderuar dhe thellësisht e privilegjuar të shpall të hapur këtë seancë të veçante solemne, kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve, martirëve e të rënëve për lirinë e vendit tonë. Në këto ditë të 5, 6 dhe 7 marsit, kujtesa jonë kombëtare ndalet në Prekaz. Aty ku toka u njom me gjakun e bijave dhe bijve të saj, aty ku qëndresa u bë betim dhe sakrifica u bë dritë për një popull të tërë. Adem Jashari është mishërim i shpirtit të pathyeshëm të Kosovës. Ai është zëri që nuk pranoi të heshte, është qëndresa që nuk u përkul, është fjala "liri" e kthyer në jetë. Ai dhe familja e tij u bënë kushttrim për një popull që

kërkonte të zgjohej. Rënia e tyre nuk ishte fund, ishte rilindje. Nga flijimi i tyre mori hov të ri një luftë që nuk mund të ndalej më deri në çlirim. Sakrifica e familjes Jashari është një akt që e tejkalon kohën, është një testament që dëshmon se liria kërkon guxim, se dinjiteti kërkon qëndresë dhe se atdheu kërkon përkushtim deri në flijim. Ajo sakrificë u bë zemra që rrahu më fort se frika dhe drita që çau terrin e robërisë. Në këtë përvjetor ne përkujtojmë sakrificën sublime, botërisht unike, të familjes Jashari, e cila me guximin dhe vendosmërinë e saj u bë simbol i qëndresës dhe i luftës për çlirim. Kujtojmë me dhembje, krenari e përgjegjësi dëshmorët, martirët, të rënë e viktimat civile. Nderojmë me respekt të veçantë familjarët e dëshmorëve, veteranët e invalidët e luftës, të burgosurit politikë dhe të gjithë ata që kontribuan me përkushtim për çlirimin dhe shtetndërtimin e Kosovës. Epopeja e UÇK-së na mëson se liria është vepër e gjakut dhe e guximit. Ajo është amanet i shenjtë, i skalitur në kujtesën tonë kombëtare, andaj brez pas brezi e kemi për detyrë ta mbrojmë, ta forcojmë dhe ta lartësojmë atë. Sot, në përvjetorin e 28-të të Epopesë së UÇK-së, ndiejmë mungesën e figurave kyçe të saj, udhëheqësve që bartën mbi supet peshën e luftës dhe shpresën e popullit për çlirim. Ata po mbahen ende padrejtësisht prapa grilave. Besojmë thellësisht se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe se e vërteta e saj është e gdhendur në ndërgjegjen tonë kombëtare. Historia nuk zhbëhet, sepse ajo është e shkruar me sakrificë dhe nuk rishkruhet. Sa herë që përmendim emrin e Adem Jasharit, sa herë që kujtojmë luftën e UÇK-së, ne zgjojmë brenda vetes një frymë. Një frymë që na thërret për unitet, për përgjegjësi dhe për përkushtim ndaj shtetit që lindi nga sakrifica. Le të jetë kjo seancë ripërtëritje e zotimit tonë. Të jemi të denjë për sakrificën e tyre. Të jemi roje të lirisë sonë. Të jemi ndërtues të së tashmes e të së ardhmes që ata e ëndërruan. Qoftë i përjetshëm nderimi dhe kujtimi për Komandantin Legjendar Adem Jashari dhe Familjen Jashari! Qoftë i përjetshëm kujtimi e nderimi për të gjithë dëshmorët, martirët dhe të rënë për lirinë e Kosovës! U bëfshim ne brezi që e mban gjallë idealin e tyre, që e shndërron sakrificën në forcë dhe që ndërton një të ardhme të denjë mbi themelet e gjakut, guximit dhe dashurisë për atdheun.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- në adresimin e tij para kuvendi dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë deklaroi: sot më 5 mars në këtë seancë solemne përulemi me respekt dhe mirënjohje të thellë para sakrificës së Komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Kjo datë shënon njërin nga faqet më të ndritura të historisë sonë, një akt pashembullt heroizmi dhe përkushtimi ndaj atdheut. Para 28 vitesh në Prekaz u vulos rruga jonë drejt lirisë me gjakun e të rënëve. Familja Jashari me sakrificën sublime na mësoi se liria nuk dhurohet, por fitohet me guxim, vendosmëri dhe dashuri të pakufishme për atdheun. Ata u bënë simbol i qëndresës, shembull i pavdekësisë dhe frymëzim për brezat që erdhën pas. Epopeja e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është vetëm një kujtim historik, por një amanet që na obligon të punojmë për një Kosovë më të zhvilluar, të jemi unik në situata kur duhet për vendin, për atdheun me të drejtë dhe më të fortë. Detyra jonë sot është të nderojmë këtë sakrificë duke e ndërtuar një të ardhme me të denjë për brezat që vijnë duke mbrojtur vlerat për të cilat ata ranë dhe duke punuar për forcimin e shtetit tonë. Sot në këtë 28 dhjetor të epopesë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, padrejtësisht mbahen prapa grilave me akuza tërësisht të fabrikuara, udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe udhëheqësit e shtetit të Kosovës Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi. Kjo është një padrejtësi e llojit të vetë, sepse lufta e Ushtrisë Çlirimtare ishte e drejtë, obliguese për popullin shqiptar e pastër dhe e mbështetur nga faktori ndërkombëtar nga aleanca Veri atlantike e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndaj në emër tim dhe të komunës së Vushtrrisë i shpreh mirënjohjen dhe falënderimin e thellë të gjithë atyre që na ndihmuan që sot këtë vend, këtë shtet ta kemi të lirë. Në emrin të komunës së Vushtrrisë shpreh nderimin dhe respektin më të

madh për të gjithë dëshmorët e kombit, martirët dhe të rënit për liri, për të gjithë ish të burgosurit politik. Lavdi e përjetshme veprës së komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari! Lavdi për të gjithë dëshmorët e kombit! Falënderim për të gjithë ata që kontribuan! Falënderim për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe të gjithë ata që kontribuan për popullin e Kosovës që sot ta kemi këtë liri. Lavdi për të rënë për liri.

Gëzim Zuçaku, kryetar i shoqatës së familjeve të Dëshmorëve në Vushtrri- në adresimin e tij para kuvendi dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë deklaroi: sot në këtë seancë solemni jemi mbledhur me nderim të thellë për ta kujtuar dhe përjetësuar një nga momentet më të lavdishme të historisë sonë kombëtare 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998 me përlujë dhe krenari kujton ditët kur në Prekaz u shkrua epopeja më e ndritur në historinë tonë kombëtare. Këto janë ditët kur në historinë e Kosovës u hap një kapitulli i lavdisë, i sakrificës dhe i qëndresës së pashembullt. Në ato ditë zjarri, i betejës në Prekaz, u bë simbol i pavdekshëm i guximit dhe i dashurisë për atdheun. Në krye të kësaj qëndrese heroike qëndronte komandanti legjendar Adem Jashari i cili bashkë me familjen e tij zgjodhi rrugën më të vështirë por më të lavdishme rrugën e sakrificës për lirinë e Kosovës. Për tre ditë e dy netë familja Jashari bëri ballë një makinerie të tërë ushtarake. Ata nuk u dorëzuan sepse e dinin liria nuk dhurohet. Ajo fitohet me sakrificë dhe me gjak. Në atë betejë të pabarabartë ata i treguan botës që shqiptari mund të vritet por nuk mund të nënshtrohet. Shtëpia e Jasharve në Prekaz u kthye në një kala të lirisë. Aty u shkrua një epope që do të kujtohet për jetë në historinë e popullit shqiptar. Sakrifika e tyre u bë dritë e shpresë për një popull të tërë dhe një kushtim për t'u ngritur në luftë për liri. Nga gjaku i familjes Jashari u ngrit zëri i fuqishëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nga ajo sakrificë u bashkua populli shqiptar në një qëllim të vetëm, çlirimin e Kosovës dhe forcimin e shtetit tonë. Epopeja e Prekazit nuk ishte vetëm një ngjarje historike. Ajo është një amanet i shenjtë për të gjithë ne. Është kujtesa që liria e Kosovës është ndërtuar mbi sakrificën më të madh, mbi jetën e bijave dhe bijve më të mirë të këtij vendi. Sot kur kujtojmë këto ditë të mëdha përulëm me respekt të thellë para dëshmorëve tanë dhe para familjes Jashari. Ata ranë për të mos vdekur kurrë sepse emrat e tyre janë shkruar përgjithmonë në historinë në zemrat e popullit shqiptar. Detyra jonë sot është ta ruajmë këtë amanet, ta ruajmë lirinë, ta duam Kosovën dhe ta ndërtojmë një shtet të fortë e të drejtë ashtu siç e ëndërruan ata që e dhanë jetën për këtë vend. Sepse një popull që i nderon dëshmorët e vet dhe nuk i harron sakrificën e tyre është një popull që nuk mposhtet kurrë. Prandaj sot me krenari dhe respekt të madh them me zë të lartë Lavdi përjetë komandantit legjendar Adem Jasharit dhe familjes së tij. Lavdi të gjithë dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rroftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, respekt deri në përlujë para çlirimtarëve dhe invalidët e luftës.

Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit- në adresimin e saj para kuvendi dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë deklaroi: Unë i përkas një brezi që ka lindur pas luftës. Nuk kam kujtime personale nga ato ditë. Gjithçka që di për atë kohë janë tregimet, kujtimet dhe mësimet që i kam dëgjuar gjatë viteve. I kam dëgjuar nga familjarët e mi, nga njerëzit që e kanë përjetuar luftën dhe që e mbajnë ende në kujtesë atë kohë të vështirë. I kam dëgjuar nga rrëfimet e atyre që e kanë parë nga afër sakrificën dhe qëndresën e popullit tonë. Për ato ngjarje kam mësuar edhe përmes librave të historisë, dokumentarëve, kronikave dhe dëshmive që janë ruajtur ndër vite. Dhe nga të gjitha këto rrëfime, nga të gjitha këto kujtime dhe dëshmi, një gjë mbetet e qartë: respekti dhe mirënjohja e thellë për atë ushtri dhe për atë familje që u bënë simbol i qëndresës dhe i sakrificës për lirinë e Kosovës. Por edhe pse nuk i kam përjetuar ato ditë, ka vende që ta bëjnë historinë të ndihet shumë më afër. Kur qëndron te Kulla e Jasharëve dhe pranë varrezave të tyre, e kupton se aty nuk është vetëm një vend historik – aty është dëshmia e një sakrifice të jashtëzakonshme. Sakrifika e një familjeje që nuk e kishte frikë vdekjen, nëse ajo vinte me çmimin e lirisë. Ta mendosh se ata u

flijuan duke e ditur se lirinë nuk do ta shijonin vetë, është një mendim që të jep një ndjenjë të thellë përgjegjësie. Të bën ta kuptosh se liria që ne e gëzojmë sot nuk është e rastësishme, por është rezultat i një sakrifice të madhe që dikush tjetër e bëri për ne. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është ushtria që arriti ta bëjë realitet përpjekjen shekullore të popullit tonë për liri. Ajo ishte momenti kur një popull vendosi se robëria nuk është më një opsion. Nëse duhet të mësojmë diçka nga ato ngjarje, është kjo: të mos e lëshojmë njëri-tjetrin kur vendi ynë ka nevojë. Të mos e lëshojmë njëri-tjetrin kur integriteti i vendit tonë vihet në provë. Sepse të gjithë duhet ta dimë se i takojmë një Kosovë që është e ujitur me gjak. Dhe kjo nuk është vetëm një fjali historike – kjo është një përgjegjësi që bie mbi secilin prej nesh. Ne sot kemi vetëm një detyrë: të bëjmë krenarë ata që dhanë jetën për këtë Kosovë. E krenarë mund t'i bëjmë vetëm nëse, kur vjen puna te atdheu, jemi një. Një në qëndrim. Një në përgjegjësi. Dhe një në mbrojtjen e Kosovës. Sepse vetëm kështu mund të jemi të denjë për sakrificën e tyre. Lavdi e përjetshme Komandantit Legjendar Adem Jashari, Lavdi familjes Jashari, Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para kuvendi dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë deklaroi: Sot jemi mbledhur për të përkujtuar një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 5,6 dhe 7 mars të vitit 1998 tre breza të familjes Jashari 59 veta gjithsej u flijuan për çlirimin e Kosovës dhe për lirinë e saj. Kjo epope shënon sakrificën sublime të familjes heroike të Adem Jasharit si dhe të gjithë dëshmorëve që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Marsi në Kosovë nuk është thjesht një muaj në kalendar, por një kujtesë e përhershme e sakrificës, heroizmit dhe vendosmërisë së popullit për liri. Në kohët më të errëta, familja, familja Jashari ndezën dritën e shpresës. Në sfidat më të mëdha ata gjetën forcën për të ecur përpara. Në momentet kur liria dhe e ardhmja e Kosovës u vë në pikëpyetje, ata u bënë përgjegjësia, mburoja dhe zemra e këtij vendi. Në Prekaz u shkrua një nga faqet më të ndritura të historisë së popullit tonë, ku liria u pagua me gjakun e bijve dhe bijave më të mira të vendit. Epopeja e UÇK-së nuk është vetëm një histori. Është mësim për brezat e rinj se liria ka çmim dhe se ajo ruhet me përkushtim punë dhe dashuri për atdheun. Lavdi kryekomandantit legjendar Adem Jashari. Lavdi të rënëve në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars 1998. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para kuvendi dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë deklaroi: sot jemi mbledhur për të përkujtuar një nga kapitujt më të lavdishëm dhe më të dhimbshëm të historisë sonë, Epopenë e UÇK-së dhe rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe gjithë dëshmorëve e martirëve të kombit. Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e lidhur përjetësisht me Prekazin heroik dhe me Prekaz, nuk është vetëm një ngjarje historike; ajo është themeli mbi të cilin u ngrit liria jonë; ajo është dëshmi e sakrificës sublime, e vendosmërisë së pathyeshme dhe e dashurisë së pakushtëzuar për atdheun. Në marsin e vitit 1998, kur forcat serbe rrethuan kullat e Jasharajve, aty nuk u zhvillua thjesht një betejë; aty u vulos një epokë. Komandanti Legjendar Adem Jashari zgjodhi qëndresën deri në flijim, duke u bërë simbol i përjetshëm i rezistencës sonë kombëtare. Bashkë me të ranë anëtarë të familjes së tij: gra, pleq e fëmijë, duke e kthyer sakrificën e tyre në një thirrje të fuqishme për liri. Rënia e familjes Jashari nuk e trembi popullin e Kosovës, përkundrazi, e zgjoi dhe e bashkoi atë. Nga ajo ditë, mijëra djem e vajza iu bashkuan radhëve të UÇK-së, duke e shndërruar luftën për liri në një vullnet mbarëpopullor. Sot, kur përulemi me respekt para veprës së tyre, ne nuk kujtojmë vetëm dhimbjen; ne kujtojmë krenarinë; kujtojmë guximin; kujtojmë besimin se liria ka çmim dhe se ky çmim u pagua me gjakun më të shtrenjtë. Dëshmorët e kombit, martirët dhe të rënët për liri janë themeli moral i shtetit tonë. Ata nuk kërkuar asgjë për vete; ata dhanë gjithçka për ne. Prandaj, përgjegjësia jonë sot është ta ruajmë dhe ta forcojmë shtetin për të cilin ata u flijuan. Ta ndërtojmë me drejtësi,

me barazi, me zhvillim dhe me dinjitet. Si qytetarë, si përfaqësues institucionalë dhe si brezi që gëzon frytin e sakrificës së tyre, kemi obligim që kujtesën ta mbajmë të gjallë jo vetëm me fjalë, por me vepra. Të punojmë për unitet, për forcimin e institucioneve dhe për një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë. Epopeja e UÇK-së nuk është vetëm histori; ajo është amanet. Lavdi e përjetshme Komandantit Legjendar Adem Jashari! Lavdi familjes Jashari! Lavdi të gjithë dëshmorëve, martirëve dhe të rënëve për lirinë e Kosovës!

Diellza Pllana, anëtare e kuvendit- në adresimin e saj para kuvendi dhe qytetarëve të komunës së Vushtrisë deklaroi: sot jemi mbledhur për të kujtuar 5, 6 dhe 7 marsin e vitit 1998 që mbetën ndër ditët më të dhimbshme dhe më krenare të historisë sonë. Sot jemi këtu për t'u përlulur me nderim të thellë para sakrificës së familjes Jashari dhe para figurës madhështore të komandantit legjendar Adem Jashari, simbol i qëndresës dhe i lirisë tonë. Epopeja e UÇK-së nuk është vetëm histori, ajo është plagë, është dhimbje, është krenari. Unë si edhe disa kolegë të mi këtu në kuvend gjithashtu i përkasim gjeneratës së lirisë, gjeneratës e cila është rritur me rrëfimet e përjetimeve të luftës. Ne nuk i kemi përjetuar as netët e tmerrit e as nuk i kemi dëgjuar zhurmët e armëve, mirëpo jemi rritur me historitë mbi to. Ne jemi rritur me emrat e dëshmorëve nëpër shkolla, me fotografitë e tyre nëpër mure, me heshtjen e dhimbshme e të heshtur të familjarëve që dhanë më të shtrenjtët e tyre për lirinë që gëzohemi ne sot. Në një kohë kur bota po përballet me konflikte të reja, me tensione dhe pasiguri, populli ynë më mirë se çdo popull tjetër e din se sa e brishtë është paqja. Ne e dimë shumë mirë se liria nuk është e përhershme nëse nuk mbrohet çdo ditë me unitet, me maturi dhe mbi të gjitha me institucione të forta. Mesazhi ynë sot duhet të jetë i qartë. Nderimi për të rënë të bëhet vetëm me fjalë, por me veprime, me drejtësi, me përgjegjësi publike, me vendime që e forcojnë Kosovën dhe i shërbejnë çdo qytetari pa dallim. Sakrifika e tyre na obligon të jemi më të bashkuar se kurrë mbi çdo ndarje politike. Lavdia e Dëshmorëve është e përjetshme. Detyra jonë është ta bëjmë Kosovën çdo ditë e më të denjë për sakrificën e tyre. Lavdi Epopesë së UÇK-së, Lavdi të Rënëve për Liri! Lavdi Kosovës!

Mbledhja përfundoj në ora 12:40

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



R A P O R T

PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE INVESTUESE PËR VITIN 2025

Mars 2026

Hyrje

Raporti për situatën ekonomike financiare dhe zbatimin e planeve investuese është i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Planin e Punës për vitin 2025. Në këtë raport është paraqitë puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës përkatësisht Ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave si dhe përgjegjësi të tyre gjatë këtij viti raportues.

Gjatë vitit 2025 sikurse edhe në vitin 2024 sfida kryesore ka qenë përballja me pagesat e projekteve kapitale për shkak të mungesës së mjeteve financiare të cilat i kanë marrë përmbaruesit për punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë bazuar në kontratën kolektive. Ky trend i marrjes së mjeteve financiare sigurisht që do të vazhdoj edhe në këtë vit për shkak të pamundësisë së realizimit të pagesave deri në fund të vitit të kaluar. Mirëpo edhe përkundër këtyre vështirësive me të cilat jemi ballafaquar kemi arritë që ta realizojmë buxhetin e vitit 2025 në shkallë të kënaqshme.

Në vitin raportues janë mbajtur takime me qytetarë, ku përveç një takimi i cili është mbajtur në muajin qershor 2025 janë mbajtur edhe takime tjera me rastin e shqyrtimit të draft buxhetit dhe projekteve prioritare për vitin vijues në të cilat qytetarët i kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat për prioritetet e projekteve në meset e tyre. Takimin e dytë me qytetarë e kemi mbajtur në mbarim të muajit dhjetorë 2025 ku i kemi njoftuar qytetarët me punën dhe projektet të cilat janë kryer gjatë këtij viti si dhe kemi shpalosur prioritetet tona për projektet e planifikuara për vitin 2026, të miratuara në kuvendin e komunës. Janë mbajtur gjithashtu edhe takime tjera si: Takime me fermerë për të dëgjuar kërkesat, sugjerimet e tyre, takime me përfaqësues të bizneseve organizata dhe shoqata nga shoqëria civile OJQ etj.

Në punët dhe aktivitetet që duhet përmendur:

- Raportimi i rregullt në kuvendin e komunës – çdo tre muaj, për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore,
- Mbikëqyrja e realizimit të buxhetit të komunës për vitin fiskal dhe realizimit të hyrave vetanake,
- Angazhimet për realizim të projekteve kapitale të komunës, edhe pse kemi pasë njaft vështirësi financiare për shkak të mungesës së mjeteve financiare,
- Propozim-aktet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje të kuvendit të komunës,
- Mbikëqyrja në zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës,
- Bashkëpunimi me komunitetin për realizim të projekteve të ndryshme,
- Bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe organizata të ndryshme për realizim të projekteve me bashkëfinancim me interes për komunën dhe qytetarët,
- Mbikëqyrja në ngritjen e performancës në administratën e komunës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarë etj.

Në vijim të këtij raporti do të paraqitet në mënyrë të detajuar realizimi i punëve dhe aktiviteteve brenda vitit 2025, përkatësisht planet investuese të komunës sipas drejtorive.

Buxheti dhe Financat

Planifikimi i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 14,667,904.25€
- Mallra dhe shërbime..... 6,743,739.67€
- Shpenzime Komunale..... 679,182.75€
- Subvencione dhe transfero..... 1,855,000€
- Investime kapitale..... 5,977,402.24€

Totali i buxhetit për vitin 2025 është..... 29,923,228.91€

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 14,666,686.25€
- Mallra dhe shërbime..... 6,699,679.44€
- Shpenzime Komunale..... 673,631.60€
- Subvencione dhe transfero..... 1,853,868.94€
- Investime kapitale..... 5,947,018.59€

Totali i buxhetit për vitin 2025 është..... 29,840,984.82€

Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti i planifikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Totali i planifikimit në këto kategori ekonomike është 29,923,228.91euro.Realizimi i shpenzimeve është 29,840,984.82 euro, Realizimi 100%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2025	Buxheti i mbetur për 2025	Plan i reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10= 7-9	11
		€	€	%	€	€	€	€	€
Financimi nga kushtetimet	04			0%			0.00	0.00	
Granti Qeveritar	10	24,992,828.25	24,936,221.95	100%	24,992,828.25	56,606.30	0.00	24,992,828.25	23,348,947.44
Të hyrat vetanake	21	3,895,024.75	3,886,480.56	100%	3,895,024.75	8,544.19	0.00	3,895,024.75	2,764,622.96
Mjesset e shtars	22	1,007,972.29	1,005,740.38	100%	1,007,972.29	2,231.91	0.00	1,007,972.29	1,367,808.46
Donacionet e brendshme	31	3,623.23	0.00	0%	3,623.23	3,623.23	0.00	3,623.23	2,000.98
Donacionet e jashtme	32	23,780.39	11,541.83	49%	23,780.39	12,238.46	0.00	23,780.39	12,886.71
TOTALI		29,923,228.91	29,840,984.82	100%	29,923,228.91	82,244.09	0.00	29,923,228.91	27,485,274.97

Sqarim: Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit sipas kategorive ekonomike është si vijon:

Granti Qeveritar për periudhën Janar-Dhjetor 2025, planifikimi është 24,992,828.25 euro, Realizimi është 24,936,221.95 eur, përqindja e realizimit 100%

Kategoria Të Hyrat vetanake fondi 21 për periudhën Janar-Dhjetor 2025, planifikimi është 3,895,024.75 euro, Realizimi i shpenzimit shuma 3,886,480.56 euro, Realizimi 100%

Kategoria Të Hyrat vetanake fondi 22 për periudhën Janar-Dhjetor 2025, planifikimi është 1,007,972.29 euro, Realizimi i shpenzimit shuma 1,005,740.38 euro, Realizimi 100%

Donacionet e brendshme të planifikuara janë 3,623.23 euro, barten në vitin 2026

Donacionet e jashtme barten në vitin 2025, janë 23,780.39 euro, realizimi 11,541.83, shprehur në përqindje realizimi është 49%

Totali i planifikimit të këto kategori ekonomike është 29,923,228.91 euro, Realizimi i shpenzimeve është 29,840,984.82 euro, realizimi 100%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuara në PR	Përqindja e buxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2023	Buxheti i mbetur për 2025	Plani i reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2024
		€	€	%	€	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	464,814.03	463,774.93	100%	464,814.03	1,035.10	0.00	464,814.03	515,304.59
Administrata dhe personeli	163	552,873.93	552,891.27	100%	552,873.93	182.66	0.00	552,873.93	529,354.88
Inspektimet	166	159,534.40	156,929.08	98%	159,534.40	2,605.32	0.00	159,534.40	139,752.82
Prokurimi	167	48,253.95	48,196.24	100%	48,253.95	57.71	0.00	48,253.95	55,816.47
Zyra e Kuvendit Komunal	169	296,312.28	296,219.52	100%	296,312.28	93.73		296,219.52	277,165.31
Buxheti dhe financat	175	236,573.88	234,832.35	99%	236,573.88	1,641.53	0.00	236,573.88	208,827.64
Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjencë	180	5,603,821.38	5,583,939.64	100%	5,603,821.38	19,881.74	0.00	5,603,821.38	4,943,912.10
Zyra totale e komuniteteve	195	107,961.88	107,381.89	99%	107,961.88	600.00	0.00	107,961.88	82,755.56
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	2,323,571.72	2,320,771.75	100%	2,323,571.72	2,799.97	0.00	2,323,571.72	973,243.33
Qjendat dhe Kadasat	650	144,155.07	144,155.07	100%	144,155.07	0.00	0.00	144,155.07	101,757.49
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	2,515,928.07	2,503,064.57	100%	2,515,928.07	6,863.50	0.00	2,515,928.07	3,019,770.98
Shëndetësia primare	730	3,453,095.05	3,432,093.45	99%	3,453,095.05	21,001.60	0.00	3,453,095.05	3,107,076.65
Shërbimet sociale residenciale		355,577.54	349,248.30	98%	355,577.54	6,328.71	0.00		311,410.82
Kulturë, rinë, sport	850	783,114.30	778,599.81	100%	783,114.30	3,515.49	0.00	783,114.30	477,081.50
Rezim	920	12,877,641.46	12,852,006.43	100%	12,877,641.46	15,633.03	0.00	12,877,641.46	12,752,543.80
TOTALI		29,923,228.91	29,840,984.82	100%	29,923,228.91	82,244.09	0.00	29,923,228.91	27,485,274.97
Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti i planifikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2025.									
Totali i planifikimit në këto kategori ekonomike është 29,923,228.91 euro. Realizimi i shpenzimeve është 29,840,984.82 euro, Realizimi 100%									

Ekonomi dhe Investime Kapitale

Sektori për biznes

Qendra Komunale e Biznesit funksionon në bazë të një sistem elektronik modern që thjeshton procesin e regjistrimit për bizneset e reja dhe ekzistuese, duke mundësuar shërbime të shpejta, të qasshme dhe pa kosto për fillimin e aktivitetit ekonomik.

Ky sistem "one-stop-shop" është krijuar për të ofruar një përvojë të lehtë dhe efektive për bizneset, duke ulur burokracinë dhe duke rritur transparencën, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Europian. Është punuar në mënyrë sistematike dhe në shërbim maksimal për ofrimin e kushteve biznesore për kryerjen e shërbimeve të tyre duke ofruar shërbime të besueshme dhe efektive. Në besojmë në ofrimin e një shërbimi institucional të përgjegjshëm dhe të qasshëm për të gjithë operatorët ekonomikë. Qëllimi ynë është të ndihmojmë bizneset në çdo hap të procesit të regjistrimit dhe administrimit, duke siguruar një kulturë administrative që mbështet rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01. – 31.12.2025

CODE	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-31.12.2025	%
1	2	3	4
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	27	9.60
B	Minierat dhe gurorët (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	35	12.46
12.5 D E	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të tregatimit të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria	41	14.59
G	Treg me shumicë dhe pakicë,	91	32.38

	riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë		
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	5	1.78
I	Transporti dhe magazinimi Informimi dhe komunikimi	16	5.7
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	17	6.05
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	3	1.07
M	Arsimi	20	7.12
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	17	6.05
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese	9	3.20
P	Aktivitetet e ekonomive familjare		
	Gjithsej	281	100

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme, si veprimtari dominuese ekonomike është tregtia me 32.38% apo me 91 biznese prej numrit të përgjithshëm, pastaj, ndërtimtaria me 14.59% apo me 41 industria përpunuese me 35 biznese apo me 12.46 %, bujqësia me 9.60% apo me 27 biznese, etj.

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të shuar, sipas veprimtarive ekonomike.

Kodi	VEPRIMTARIT EKONOMIK	Bizneset prej 01.01-31.12.2025	%
1	2	3	4
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	8	12.9

B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	9	14.52
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë	1	1.61
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të tjerat të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria	3	4.83
G	Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	20	32.26
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	2	3.23
I	Transporti dhe magazinimi Informimi dhe komunikimi	3	4.84
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	2	3.23
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	4	6.45
M	Arsimi	4	6.45
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	1	1.61
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese	3	4.84
P	Aktivitetet e ekonomive familjare	2	3.23
	Totali	62	100

Sic shifet nga te dhënat e tabelës edhe tek shuarjet dominon po ashtu tregtia me 21 biznese apo me 32.26 % etj.

Deri më 31.12.2025 janë kryer gjithsej këto shërbime:

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	Biznese të reja (të regjistruara)	281	
2.	Shuarje të bizneseve	62	
3.	Ndërrime të logove të certifikatave	288	
4.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	178	
5.	Vërtetim	2	
	Gjithsej	811	

Përveç shërbimeve të lartshënuara, Sektori i Bizneseve ka kryer edhe lëndë të tjera si:

- | | |
|---|----|
| - Leje Pune për Auto Taxi - | 2 |
| - vazhdimin e lejeve për transportin autotaxi | 25 |
| - dhënia e certifikatave për kontribute - vitet e '90 | 12 |

Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Ky raport paraqet aktivitetet, arritjet, sfidat dhe rekomandimet e Drejtorisë së Bujqësisë gjatë vitit 2025. Qëllimi i raportit është të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të verifikueshme mbi zbatimin e politikave zhvillimore në fushën e bujqësisë, mbështetjen e fermerëve dhe menaxhimin e resurseve bujqësore në territorin e komunës.

Objektivat Kryesore gjatë vitit 2025;

- Rritja e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.
- Mbështetja e fermerëve përmes subvencioneve dhe asistencës teknike.
- Përmirësimi i menaxhimit të tokës bujqësore dhe ujitjes.
- Zhvillimi i qëndrueshëm rural dhe rritja e punësimit në zonat rurale.
- Rritja e sigurisë ushqimore dhe cilësisë së produkteve bujqësore.

Aktivitetet kryesore të realizuara;

- Mbështetja e Fermerëve
- Identifikimi dhe regjistrimi i fermerëve aktivë.
- Përpunimi i kërkesave për subvencione bujqësore.
- Ofrimi i këshillimeve profesionale në fushën e prodhimit bimor dhe blegtoral.
- Ofrimi i këshillave për aplikim për grante
- Mbështetje për kultivimin e drithërave, perimeve dhe pemëtarinë.
- Promovimi i praktikave moderne dhe të qëndrueshme bujqësore.
- Monitorimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në kultura bujqësore.
- Mbikëqyrja e fermave blegtorale.
- Bashkëpunim me fermerët për shfrytëzim racional të resurseve ujore.

Bashkëpunimi Institucional:

- Bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe institucionet qendrore.
- Koordinim me drejtoritë tjera komunale.
- Përfshirja e organizatave joqeveritare dhe donatorëve në projekte bujqësore.

Sfidat;

- Mungesa e mjeteve financiare të mjaftueshme.
- Interesi i kufizuar i të rinjve për aktivitetet bujqësore.

Tabela e obligimeve për vite:

Nr	Projktet - subvencionet - marrëveshjet	Shuma e obligimit	Kohe e realizimit
1	Subvencionimi i qumështit (mbetje nga viti 2024- I-2024)	78,000.00	
2	Subvencionimi i qumështit (mbetje nga viti 2024 II- 2024)	78,000.00	
3	Projekt me IADK (obligime nga viti 2025)	16,000.00	
4	Ibër Lepenc- pagesa 50% e shpenzimeve të ujitjes	45,000.00	
5	Subvencionimi i bletëve	45,000.00	
6	Subvencionimi i deleve dhe dhive	16,000.00	
	Gjithsej:	278,000.00	
	Vititi 2024 obligime	278,000.00	

Viti 2025 obligime	278,000.00	
Viti 2026 planifikim	278,000.00	
278,000.00 x 3 vite = 834000.00	834,000.00	

Vendime për ndërrim destinimi të tokës bujqësore; 46 me vlerë të përgjithshme 136,665.66 euro.

Rekomandime për Vitin e Ardhshëm,

- Rritja e buxhetit për Drejtorinë e Bujqësisë.
- Intensifikimi i trajnimeve për fermerët.

Administrata

Drejtoria e Administratës është një nga drejtoritë kyçe të Komunës së Vushtrisë dhe përfaqëson një shtyllë të rëndësishme të funksionimit institucional. Detyra e saj kryesore është të sigurojë funksionimin e rregullt, efikas dhe transparent të shërbimeve administrative për qytetarët, bizneset dhe institucionet komunale, duke garantuar që çdo proces të zhvillohet në përputhje me legjislacionin dhe standardet e qeverisjes së mirë. Në kuadër të kompetencave të saj, Drejtoria ofron shërbime të përgjithshme administrative dhe shërbime direkte për qytetarët; menaxhon sistemet e teknologjisë informative, logjistikën dhe furnizimet; si dhe ofron mbështetje të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale në ushtrimin e funksioneve të tyre ligjore. Një rol i rëndësishëm i kësaj drejtorie është edhe promovimi i të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse në nivel institucional.

Drejtoria e Administratës synon të ofrojë shërbime moderne, të qasshme dhe të standardizuara, duke avancuar digjitalizimin e proceseve, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimin e komunikimit me qytetarët. Përkushtimi i saj është orientuar drejt krijimit të një administrate efikase, të besueshme dhe transparente.

Një ndër shtyllat kryesore të punës së Drejtorisë është administrimi efikas i dokumentacionit zyrtar në komunë, duke përfshirë pranimin, regjistrimin, përpunimin, ruajtjen, arkivimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, si dhe zbatimin e standardeve të transparencës dhe menaxhimit të informacionit. Në këtë kuadër, Drejtoria bashkëpunon ngushtë me të gjitha drejtoritë komunale, duke garantuar koordinim institucional, qartësi procedurale dhe ofrim cilësor të shërbimeve.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria ka avancuar në mënyrë të konsiderueshme proceset administrative dhe digjitalizimin e shërbimeve, përmes realizimit të disa aktiviteteve të rëndësishme, përfshirë:

- Zyrtarizimin dhe përdorimin e mbështjellësve të lëndëve (për herë të parë në vitin 2025)
- Arkivimin elektronik dhe përdorimin e sistemit SMAED (për herë të parë në vitin 2025)
- Implementimin dhe zbatimin e udhëzuesve dhe rregullave të brendshme të hartuara nga institucionet e komunës (për herë të parë në vitin 2025)

- Administrimin elektronik të dokumenteve, duke përdorur sistemin elektronik, INTRANET dhe sistemin SMAED (për herë të parë në vitin 2025)
- Implementimin e politikave për backup dhe ruajtje të sigurt të dokumenteve

Bashkëpunimi ndërkombëtar – Projekti “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal”

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Administratës ka zhvilluar dy takime pune me delegacionin e Komunës së Vaxjö-s (Suedia), në kuadër të projektit të përbashkët “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal”. Ky projekt do të zgjasë tre (3) vite dhe synon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy komunave për avancimin dhe standardizimin e procedurave të arkivimit dhe digjitalizimit të dokumentacionit. Në kuadër të përmirësimit të shërbimit dhe qasjes më të mirë ndaj qytetarëve, gjatë muajve të verës është ofruar shërbim i veçantë për bashkatdhetarët. Për këtë qëllim janë caktuar tre (3) sportele të veçanta për shërbimin e mërgimtarëve, me synim ofrimin e shërbimit më të shpejtë dhe më efikas për bashkatdhetarët e komunës.

Po ashtu, me vendim të Kryetarit të Komunës, Zyra e Gjendjes Civile ka filluar të punojë edhe të shtunave, në orarin 10:00 – 14:00, si dhe gjatë kohës së pushimit, me qëllim të përmirësimit të aksesit dhe lehtësimit të shërbimit për qytetarët, në veçanti për bashkatdhetarët që frekuentojnë shërbimet në periudhën e verës.

Në vijim të këtij raporti, paraqiten raportet e detajuara për secilin sektor, me aktivitete, rezultate, sfida dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

Zyra e Gjendjes Civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhave janar-dhjetor ka ofruar të gjitha shërbimet që janë në kompetencë dhe që kryhen në këtë zyrë, trendi i ngritjes së efikasitetit dhe ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimin, profesionalizmin dhe punën që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesin e digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendjes civile dhe harmonizimin e procedurave në ofrimin e Shërbimeve, lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile. Përmes Qendrës së Regjistrimit Elektronik të gjendjes civile është bërë edhe ndërliohja dhe harmonizimi i dhënave personale të gjendjes civile për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës me platformën (elektronike) online E-Kosova, dhe që nga data 01 qershor i vitit 2022 është mundësuar pajisja (nxjerrja) e certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë pa pasur nevojë që të kontaktohen zyrat e gjendjes civile. Në vazhdim të ofrimit të shërbimeve më efikase dhe më efektive i kemi thjeshtëzuar procedurat e pagesave për marrjen e certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile, duke i liruar nga pagesa e certifikatave për përdorim të brendshëm të gjithë qytetarët me vendbanim në komunën tonë.

Zyra e gjendjes civile i ka marrë të gjitha masat që të zbatojë vendimin e MAPL-së për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve të lindjes për komunitetin RAE, mirëpo në zyrën e gjendjes civile në komunën e Vushtrisë nuk është paraqitur asnjë rast i këtij komuniteti për regjistrim me vonesë dhe falas.

Vlen të theksohet se në Zyrën e Gjendjes Civile realizohen edhe praktika profesionale nga nxënësit e shkollave të mesme, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Komunës dhe institucioneve arsimore.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat të qytetarëve dhe ju kemi dhënë përgjigje sipas afateve ligjore dhe janë dhënë shërbime efikase dhe efektive.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të tjera:

1.	Anulim i regjistrimit të lindjes	28
2.	Anulim i vendimit nga DA dhe shfuqizim i vendimit	02
3.	Korigjim i të dhënave personale në RL	69
4.	Korigjim i të dhënave personale në RM	04
5.	Korigjim i të dhënave personale në RV	03
6.	Korigjim i të dhënave të arkivuara në RL	27
7.	Dëshmi të vdekjes	565
8.	Lajmërime të adresës së vendbanimit dhe në Ekosova	44278
9.	Korigjim i të dhënave të arkivuara në RV	01
10.	Ndrrim i emrit personal	77
11.	Refuzim-per ndrrimin e emrit personal	01
12.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë)	218
13.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	16
14.	Regjistrim i mevonshëm i lindjes	07
15.	Regjistrim i mevonshëm i vdekjes	69
Gjithsej regjistrime të bëra		45365

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	28764
2.	Certifikata të lindjes	13445

3.	Certifikata të martesës	5770
4.	Certifikata të vdekjes	2182
5.	Certifikata të Statusit martesor	1080
6.	Certifikata të shtetësisë	2032
7.	Certifikata familjare	4448
8.	Certifikata të vendbanimit	5823
9.	Vërtetim nga arkivi	3739
Gjithsej		67283

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	335
2.	Martesa	577
3.	Regjistrime të vdekjes	373
4.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	352
5.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	108
6.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	41
7.	Shkurorëzime	109
Gjithsejtë regjistrime të bëra		1895

Në bazë të të dhënave, numri i lindjeve të banorëve rezidentë me vendbanim në Komunën e Vushtrrisë, por që kanë lindur jashtë territorit të Komunës së Vushtrrisë në vitin 2025 është 890 lindje.

Shërbimet online nga eKosova:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	11130
2.	Certifikata të lindjes	10703

3.	Certifikata të martesës	3209
4.	Certifikata të vdekjes	453
Totali		25495

Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Qendra për shërbim të qytetarëve në komunë gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të të gjithë qytetarëve, duke iu dhënë informacionet e duhura mbi kërkesat e tyre, duke iu ndihmuar në përpilimin e kërkesave dhe duke përcjell përgjigjet në kërkesa nga të gjitha drejtoritë. Përveç aktiviteteve dhe detyrave të përditshme zyrtarët e qendrës për shërbim të qytetarëve kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së epërëve të tyre siç janë, menaxherë të kontratave, komisione për vlerësim, komisione për pranim dhe në komisione të tjera sipas nevojave zyrtare.

Objektiv i përgjithshëm strategjik i Qendrës për Shërbim të Qytetarëve ka qenë: Të sigurohet administrimi, menaxhimi dhe arkivimi efikas, ligjor dhe i digjitalizuar i dokumenteve zyrtare komunale, me qëllim rritjen e transparencës, sigurisë së informacionit dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe institucioneve përkatësisht përmirësimi i administrimit dhe qarkullimit të dokumenteve, digjitalizimi dhe arkivimi elektronik, siguria, ligjshmëria dhe ruajtja e dokumenteve.

Me qëllim të realizimit të këtyre objektivave dhe të digjitalizimit të administratës Qendra për Shërbim të Qytetarëve ka hartuar dhe ka filluar së zbatuari tri(3) aktet administrative që kanë të bëjnë me administrimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivimin elektronik të tyre.

- Listën e Shenjave të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre për Komunën e Vushtrrisë,
- Rregullat për Administrimin dhe Menaxhimin Zyrtar të Dokumenteve dhe Arkivimin e tyre,
- Udhëzuesin për informacione lidhur me shërbimet komunale.

Ka vazhduar përpjekja për implementimin e koncept dokumentit të punuar nga grupi punues për administratë i komunës së Vushtrrisë në bashkëpunim me grupin punues nga komuna e Vaxho-Suedisë për një administratë digjitale dhe një arkiv digjital.

Gjatë periudhës prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nga zyrtarët e qendrës për shërbim të qytetarëve janë digjitalizuar rreth 560 lëndë të cilat kanë kaluar përmes QSHQ-së dhe pas përfundimit nga zyrtari përgjegjës janë sjellë sërish në QSHQ për digjitalizim dhe arkivim.

Sfidë për qendrën për shërbim të qytetarëve mbetet:

Mungesa e hapësirës së mjaftueshme e cila po ndikon negativisht në organizimin dhe efikasitetin e punës së QSHQ-së, andaj krijimi i një ambienti më funksional është domosdoshmëri dhe do të ndihmonte në rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së punës.

Sfidë tjetër është edhe numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve që janë aktualisht në qendrën për shërbim të qytetarëve, ku momentalisht janë një(1) zyrtar regjistruar i kërkesave që punon në sportel, një(1) arkivist, një(1) zyrtar për protokollim dhe një shpërndarës i postës, andaj pas vlerësimit dhe

analizës si me ky numër i zyrtarëve nuk mjafton në raport me volumin e punëve dhe përgjegjësiqe që i ka njësia në fjalë, e sidomos edhe me përgjegjësiqe që i janë deleguar me rastin e delegimit edhe të kërkesave dhe faturave të operatorëve ekonomik, andaj kërkoj që kjo njësi të plotësohet me numër të mjaftueshëm të zyrtarëve sipas këtij numri të zyrtarëve nga 5 sa janë aktualisht në 9 zyrtar gjithsej, me arsyetimin se secili zyrtar i ka specifikat e veçanta të punës dhe kërkohet që të kenë nga një zëvendësues gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Tabela e më poshtme përshkruan numrin e kërkesave të parashtruara në drejtoritë komunale të cilat janë pranuar dhe procesuar nga zyrtarët e QSHQ-së.

Në drejtim të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 65402 kërkesa, prej të cilave janë si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1	Kuvendi Komunal	150
2	Kryetari i Komunës	990
3	Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport	444
4	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	43765
5	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	725
6	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2007
7	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2598
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	992
9	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	390
10	Drejtoria për Arsim	750
11	Drejtoria për Shërbime Publike	772
12	Zyra Lokale e Komuniteteve	3
13	Drejtoria për Inspeksion	903
14	Drejtoria e Prokurimit	18
15	Zyra Ligjore	6
16	Njësia e Auditimit të Brendshëm	5

18	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	9222
20	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	1453
21	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	209
		65402

Qendra e thirrjeve

Përmbledhja e thirrjeve të pranuar sipas drejtorive:

Zyra e Kryetarit	54
Drejtoria e Administratës së përgjithshme	135
Drejtoria për Urbanizëm	38
Drejtoria për Shërbime Publike	98
Drejtoria e Inspektoriatit	97
Drejtoria për Kadastër	16
Drejtoria për Arsimit	45
Drejtoria për shëndetësi	50
Drejtoria për kulturë, rinë dhe sport	12
Drejtoria për bujqësi	39
Drejtoria për prokurim	6
Drejtoria për buxhet dhe financa	216
Zyra për kthim dhe komunitet	1
Komuna nuk është kompetente	74
Zyra Ligjore	0
Zyra për informim	0

Qendra e zjarrfikësve	146
Sekretaria e Kuvendit Komunal	4
Personeli	75
Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim	112
Qendra për pajisje me dokumente të identifikimit	83
Totali	1311

Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informativ

Bazuar në raportin periodik, sektori ka realizuar një numër të konsiderueshëm të punëve në fushat e TI-së, mirëmbajtjes, përkthimit dhe lekturimit. Më poshtë paraqitet tabela e përmblodhur e punëve dhe aktiviteteve operative dhe teknike të kryera:

Përshkrimi i Punës	Numri i Veprimeve
Administrim i sistemeve të TI	36
Instalim, përditësim i Sistemit Operativ	24
Instalime, konfigurime, zgjidhje e problemeve softuerike	301
Krijimi i llogarive elektronike në sisteme	9
Mbështetje lidhur me shfrytëzimin e resurseve të TI	328
Postim në ueb-faqe dhe mirëmbajtja e ueb-faqës zyrtare të komunës	17
Zgjidhje e problemeve të ndryshme teknike	200
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës si dhe konsultime për lekturim	35

Përshkrimi i Punës	Numri i Veprimeve
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simultan sipas nevojës të organeve komunale	76
Administrimi i depos, përfshirë regjistrimin e faturave, ngarkimin dhe transferimin e aseteve, si dhe transaksionet tjera lidhura me administrimin e saj	226
Riparime dhe mirëmbajtje të objektit komunal, duke përfshirë rregullime elektrike, hidrosanitare dhe të inventarit, mirëmbajtje ditore të sistemit të ngrohjes/ftohjes, si dhe punë të tjera teknike	345

Këto veprime reflektojnë angazhimin e përditshëm të sektorit në mbështetje të funksionimit të administratës komunale.

Njësi për të Drejtat e Njeriut

Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjimore me aktivitetet dhe angazhimin e tyre gjatë këtij viti kanë pasur qëllim kryesor promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjimore, promovimin e të drejtave të fëmijëve, promovimin e të drejtave dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara, grave vetushqyese.

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2025 janë zhvilluar aktivitete të ndryshme si: shënimi i datave të rëndësishme për të drejtat e njeriut, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara; kemi organizuar tryeza të diskutimit, kemi qenë pjesëmarrës në disa tryeza të organizuar nga institucionet dhe organizatat tjera qoftë në cilësinë si penalistë qoftë si pjesëmarrës të tyre, kemi pasur takime të ndryshme me OJQ vendore dhe ndërkombëtare; kemi pasur vizita në shkollat e komunës dhe institucione të ndryshme, kemi qenë pjesëmarrës në trajnime dhe punëtori të ndryshme të organizuara nga institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kemi qenë pjesëmarrës në konferencën Zyrtarja për barazi gjimore, sipas detyrës zyrtare ka marr pjesë në mbledhjet e kuvendit komunal, të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje, komisionit komunal për riatdhesim etj.

Arsimi

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor, gjithnjë, sipas kalendarit të vitit shkollor 2024/25. Viti shkollor 2024/25 ka filluar më 2 shtator 2024, ndërsa gjysmëvjetori i parë ka përfunduar më 24 dhjetor 2024, bazuar në UA.04/2024 Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 8 janar 2025 ndërsa ka përfunduar për klasën 12 -të (maturantë) me datë: 15.05.2025, për klasat 9, 10, 11, më datë: 5.06.2025, për klasat parafillore dhe 1-8 -të më: 23.06.2025.

Informata të përgjithshme për vitin shkollor 2024/2025:

Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore;

- 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizikë e cila është në procedurë të pavarësimi;
- 3 shkolla fillore;
- 2 Shkolla të mesme të ulëta;
- 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta;
- 3 shkolla të mesme të larta;
- Numri i punonjësve: 1124;
- Numri i paraleleve: 642;
- Numri i nxënësve që kanë braktisë mësimin në arsimin e obliguar: 0
- Orët mësimore të planifikuara: 320738, të mbajtura 325329 dhe të pa mbajtura 459
- Shkolla me objekte me efikasitet nga 46 objekte 42 janë me efikasitet, me energji solare nuk ka, si dhe me sisteme gjeotermike nuk ka asnjë shkollë;
- Shkolla me kamera 37;
- Shkolla me rrethoja 36;
- Salla sportive 2;
- Kabinete me laboratorë 20;
- Shkolla me biblioteka 25;
- Shkolla me orëndi të zakonshme 37;
- Shkolla që kanë projektorë 36 ;
- Shkolla që raportojnë dy herë në vit 37 (sipas shkollave amë);
- Nxënës me nevojë të veçanta arsimore :131;
- Kërkesa për vlerësim të nx. me NVA 25;
- Nxënës të vlerësuar nga ekipi komunal 25 nxënës;

Numri i nxënësve:

- Niveli 0: (grup moshat 1-6 dhe çerdhet) 1046 fëmijë/nxënës;
- Numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare që vijnë kopshtin në zona rurale dhe urbane viti shkollor 2024/2025, në zona urbane 169, ndërsa në rurale ska.
- Niveli 1(klasa 1-5): 4721 nxënës;
- Niveli 2 (klasa 6-9): 3951 nxënës;
- Niveli 3 (klasa 10-12): 2193 nxënës;
- Gjithsej: 11911 nxënës;

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimeve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2024/25, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë raport. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë datat me kohë më qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrisë, e që në objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regional të Arsimit;
- Takime të rregullta me MASHT;
- Takime të rregullta me KFORIN sloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiun për Arsim;
- Gjatë kësaj periudhe janë pensionuar 11 mësime, 25 mësime në pushim të lehonisë, janë shpallur 17 konkurse;
- Në të gjitha shkollat u shënuar dita e internetit të sigurt;
- Është organizuar java e dyerve të hapura, ku nxënësit e klasave të IX-ta janë pritur nga shkollat profesionale;
- U mbajt program artistik për nder të 7 Marsit- Ditës së mësuesit;
- Transporti i nxënësve është realizuar në 35 vija udhëuese;
- Certifikimi i 50 mësimeve të SHMU-2 Vushtri, i cili trajnim u krye me bazë në shkollë;
- Në SHMP "Bahri Haxha" – Vushtri, është realizuar projekti i stipes Çmimi mjedisor „Dervish Rozhaja” në vlerë 10.000 euro. Me këtë projekt janë instaluar 15 klima efiente, 18 BTU financuar nga YENI dhe CARITASI Zvicëran nga pjesëmarrja në projektin „Ndikimi i rinisë në mjedis” YENI I CARITASIT „Ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike. -Eko-klubi i SHMP „Bahri Haxha”, ishte fitues i çmimit të parë mjedisor.
- 46 nxënës të Vushtrisë u përfshinë në projektin Drejt Malit, skijim në Brezovicë, 20 nxënës të SHMU-2, 20 nxënës të SHFMU "Liria" Stroc, dhe 6 nxënës që kanë fituar në garat e matematikës;
- Është nënshkruar marrëveshja me të cilën SHMP "Bahri Haxha" do të jetë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin CultVeting, ndër shkollat e para publike e përfshirë në këtë program (gjatë muajit nëntor është realizuar vizita e dytë studimore në Bruksel). Njëzet e dy nxënës janë trajnuar dhe certifikuar në trajnimin "Edukimi i të rinjve për artin, kulturën dhe trashëgiminë". Është nënshkruar marrëveshja e financimit për grantin e fituar nga RCF (fondi rajonal i sfidave i cili financohet nga Qeveria gjermane dhe Zvicëran) në vlerën 491899 euro. - SHMP "Bahri Haxha" është pjesë e "Super shkollave", financuar nga zyra e RYCO-s në Prishtinë;
- Në SHMU-1 u pasurua biblioteka me mbi 700 tituj nga autorë të ndryshëm, si dhe u certifikuan 400 nxënës për kodim;
- Më datën: 20 shtator 2024 nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Kryqin e Kuq për mbajtjen e ligjëratave të Ndihmës së Parë Bazike në shkollat e Komunës sonë ku u certifikuan ekipet e të gjithë shkollave;

- Më datë: 02.10.2024, Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri dhe OJQ – Olimpiada Speciale e Kosovës,- Drita Dushi-Parduzi, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit e cila synon gjithëpërfshirjen në aktivitete sportive të fëmijëve me nevoja të veçanta;
- U mbajt tryezë diskutimi me temë kryesore: Shëndeti mendor, Sfidat dhe mundësitë e njeriut në shek. XXI". - Në këtë tryezë morën pjesë psikologë të shkollave, drejtorë dhe dr. Ferid Agani;
- U mbajt aktivitet me nxënësit e Gjinnazit "Eqrem Çabej", për shëndetin mendor;
- U mbajt tryezë informuese për ditën e vajzave në SHMU2;
- Aktiviteti në shkollën "Mustafë Venhari", shitja e produkteve nga ana e nxënësve për t'i dalë në ndihmë familjeve skamnore;
- U mbajt ligjëratë informuese me nxënësit e klasës së VII në SHFMU Nacakoc me temën: "Pasojat e përdorimit të tepërt të rrjeteve sociale si dhe vetëlëndimet";
- U mbajt tryezë e diskutimi për të shënuar Ditën Botërore Kundër Abuzimit të Fëmijëve, për të vënë në pah rëndësinë e ndikimit të kësaj teme në shëndetin mendor të secilit nxënës. Takimi u mbajt në SHMU 1 – Vushtri, më datë: 19.11.2024, nga ora 11:00;
- Datë 22. 11. 2024, u mbajt aktivitet në SHMP "Bahri Haxha" projekti për trashëgimi kulturore ku nxënësit u pisen me certifikata;
- Më 29. 11. 2024, u mbajt aktivitet me fëmijët me nevoja të veçanta. Aktiviteti u realizua në shtëpinë e kulturës;
- Më datë: 02.12.2024 ndanë 43 certifikata për zhvillim profesional me bazë në shkollë për shkollat: SHF "Mustafë Vehari" Vushtri, SHMU-1 Vushtri, SHF "Naim Frashëri" Vushtri, SHF "Ali Kelmendi" Vushtri;
- Më datë: 02. 12. 2024, nga përfaqësues të MASHT-it u prezantua Zbatimi i politikave për mbrojtjen e fëmijëve;
- Dt. 04. 12. 2024, nga organizata Terres de Hommes u trajnuan zyrtarë me temën "Hyrje në antigipsizëm";
- Më datë 19. 12. 2024, u mbajt sesion informues për hartimin e Planit Individual të Arsimit në bashkëpunim me Qendrën Burimore "Nënë Tereza" – Mitrovicë;
- U shënuar dita e internetit në shumicën e shkollave të komunës së Vushtrisë;
- Me datë 19.02.2024 Në Vushtri, Drejtoria Komunale e Arsimit me bashkëpunim me shtëpinë botuese "Hamilton House" organizuan garën "Spelling Bee 2025", me pjesëmarrjen e 130 nxënësve nga shkollat e qytetit. Kjo garë u mbajt në Gjinnazin "Eqrem Çabej" Vushtri. Ky aktivitet ka për qëllim të nxisë nxënësit që të përmirësojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze dhe të rrisin shkathtësitë e komunikimit;
- Bashkëpunimi me shkollat e shtetit të Maqedonisë, me programin e nxënësve të SHMP "Bahri Haxha" dhe nxënësve të Tetovës në projektin "Super shkollat";
- U mbajt ligjëratë nga policia në 10 shkolla me temë: "Siguria në trafikun rrugor" si dhe "Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik";
- Më 05.03.2025, fond i Eficiencës së Energjisë, një eksperte e energjisë, përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, përfaqësues nga komuna si dhe nga Giz dhe INDEP organizuan; ekspozitë "Ndriçojmë të Ardhmen" – ekspozitë dhe shpërblime për tre pikturat më të mira. Vendi i parë SHMU-1, Vendi i dytë Gjinnazi "Eqrem Çabej" Vushtri, Vendi i tretë SHMU-2 Vushtri. Të tri shkollave ju dhurua nga një Smard board me vlerë 1654 euro;

- U realizua hulumtimi nga Selim Mehmeti – IPK në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit jemi duke bërë një studim për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve;
- Më datë 11 mars 2025 u mbajtën garat e Olimpiadës së Gjuhës shqipe në nivel komunal vendet;
- Ju vlerësua përforma e drejtorëve të shkollave: SHMU-2, SHMP "Bahri Haxha" . SHP "Naim Frashëri", SHFMU "Rilindja" , dhe SHFM 28 Nëntori dhe zëvendës drejtori i "Lutfi Musiqi;
- Me datën: 25.04.2025, në Shtëpinë e Kulturës "Hasan Prishtina"-Vushtri u mbajt festivali për fëmijë "Zëbyllylat e Vicianës" në të cilin morë pjesë 21 nxënës të shkollave të komunës së Vushtrrisë;
- Me datën 30 prill 2025 në Gjinnazin "Eqrem Çabej" u mbajt Pansiri i Shkencës dhe Kulturës, i cili i filloi punimet nga ora 10:00 deri në ora 15:00. U mbajt testit PISA me datë:13, 14 maj 2025 ku morën pjesë 319 nxënës;
- SHFMU "Enver Hadri" Smeconicë: kompania Instabuild i ka dhënë donacion d një SMART Board dhe një fotokopje;
- Gjatë periudhës janar – qershor 2025 Ekipi Komunal për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore ka vlerësuar gjithsej 19 nxënës.
- Gjatë kësaj periudhe kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Arsimit (24 janar), maturantët e gjinnazit "Eqrem Çabej" vizituan Bibliotekën Kombëtare të Kosovës të organizuar nga DKA në bashkëpunim me menaxhmentin e gjinnazit dhe po ashtu me aktivitetet të ndryshme në shkolla u shënuar kjo ditë;
- Janë mbajtur takime të rregullta me ekipin e EPRMB-së me qëllim të zvogëlimit të braktisjes së arsimit parauniversitar;
- Siguria e të dhënave dhe mbrojtja e tyre në internet, aktiviteti i mbajtur në SHFMU "A.Z.Çajupi";
- Kemi shënuar Ditën Botërore të Down Syndrome me 21 Mars;
- Kemi realizuar projektin për matjen e nivelit të stresit dhe ndikimin e tij në performancën e punës te shërbuesit civil- Dita Ndërkombëtare e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (28 Prill);
- Kemi realizuar dy takime pune me drejtorin dhe mësueset udhëuese të Qendrës; Burimore "Nënë Tereza" në Mitrovicë për zgjerimin e bashkëpunimit në vazhdimësi;
- SHMP "Bahri Haxha" Vushtri: - Janë pajisur me SMART TV të gjitha klasat e mësimi dhe kabinetet (planifikim me buxhetin e shkollës)
- Janë pajisur me laptop personal të gjithë mësimdhënësit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- Është realizuar projekti për përmirësimin e kushteve në firmën ushtrimore të Ekonomisë me 20 kompjuter të ri dhe një Smartbord, financuar nga MASHTI;
- Ka vazhduar projekti mësimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI dhe XII kanë kryer praktikën në vendin e punës;
- Ka vazhduar „Mësimi dual,, për 24 nxënësit e profilit „Tregtarë me pakicë dhe shumicë,, klasa e XI (ka pasur vështirësi për shkak të mosgatishmërisë së bizneseve për të përmbushur kontratat me nxënës ku parashihet edhe pagesa mujore);
- Janë pajisur me pajisje bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale kabinetet e kimsë, teknologjisë ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- SHMP „Bahri Haxha” është pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin CultiVeting ndër shkollat e para publike e përfshirë në këtë 22 nxënës janë trajnuar dhe certifikuar në trajnimin „Edukimi i të rinjve për artin, kulturën dhe trashëgiminë”;
- Është finalizuar projekti për realizimin e grantit të ftuar nga RCF;

- Në SHMP „Bahri Haxha”, ka përfundur digjitalizimin e procesit mësimor
- Drejtoria për Arsimit, me 16.07.2025 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Childproof (CIPOF) për hapjen e dy kopshteve të reja me bazë në komunitet, në fshatrat Stanoc i Epërm dhe Shtitaricë;
- Me datë: 18.06.2025 u përfunduan kabinetet moderne të Kimisë, Fizikës dhe Biologjisë në ShMU-2;
- Janë hapur dy qendër publiko-private me bazë në komunitet në bashkëpunim me organizatën CIPOF, njëra në fshatin Stanoc dhe tjetra në fshatin Shtitaricë.

Bursat dhe shpërblimet për nxënës,

- Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/e për studime brenda vendit;
- Numri i bursave jashtë vendit - 15 (pesëmbëdhjetë);
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës- 1000.00 € (një mijë euro) për student/e për vendet e BE-së;
- Konkursi i bursave ka qenë i hapur nga data: 18.03.2025 - 01.04.2025
- Komisioni i ndarjes së bursave është përbërë nga: Enver Bajrami, kryesues i komisionit, Sadete Gërguri, anëtare e komisionit dhe Hashim Hajrizi, anëtar i komisionit;
- Komisioni i ankesave për studentë të cilët nuk kanë përfutur bursë është përbërë nga: Musaj Tërëbunja, kryesues, Arianit Jashari, anëtar, dhe Bastri Duraku, anëtar;
- Gjithsej aplikantë të bursave 180, prej tyre 39 kanë aplikuar për drejtimet të cilat nuk i kemi shpallur. Fitues të bursave 85 studentë.
- Me datë: 15.04.2025, komisioni shpalli listën jo- përfundimtare të bursave;
- Me datën: 28.04.2025 komisioni i ankesave shqyrtoi 14 ankesa,
- Me datën: 30.04.2025 është shpallë lista përfundimtare e bursave;
- Në konkurrencë brenda vendit kanë tepëruar 15 bursa dhe janë bartur në këtë kategori duke u bazuar në notën mesatare;
- Ndërsa jashtë vendit
- kanë tepëruar 2 bursa dhe janë bartur në këtë kategori duke u bazuar në notën mesatare;
- 39 studentë kanë konkurruar nga drejtimet të cilat nuk i kemi shpallur;
- Përfutues të bursave sipas gjinisë: 57 janë studente, dhe 28 janë studentë;
- Studentë në Greqi – në York city college janë 3 studentë 2 baç dhe 1 master dhe janë subvencionuar 17.185.00 euro
- Gjithsej përfutues 87 studentë me vlerë euro 72.185.00.

Shpërblimet e nxënësve;

- Janë subvencionuar për transport 79 nxënës me nevoja të veçanta arsimor me nga 500 euro në vlerë totale 39 500 euro;

- Janë subvencionuar 7 nxënës të cilët kanë përfaqësuar vendin në gara ndërkombëtare ku 6 prej tyre me nga 500 euro dhe 1 me 1000 euro pasi që ka marr pjesë në universitetin Santa Cruz në Kaliforni - USA. Gjithsej 4000.00 euro;

Garat, aktivitetet dhe të arriturat

U mbajtën garat e diturisë në tri nivele për nivelin ka fituar vendi e parë: SHF "Mustafë Venhari" Vushtrri ndërsa në nivelin 2 vendin e parë SHMU-2, Vendin e dytë SHFMU "Enver Hadri" Smrekonicë, Vendin e tretë SHFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë

Të arriturat e garave nga Gjinnazi:

Garat regjionale në Kimi; Anisë Kutllavci- X/3- Vendi i Parë, Melika Tiriqi – X/4- Vendi i Dytë, Tina Gashi- XI/1- Vendi i Dytë, Armelinda Shala- XI/5- Vendi i dytë, Redon Hajrizi – XI/6- Vendi i tretë;

Garat Komunale në Fizikë; Klasët e 10-ta, Ajdesë Kadriu – Vendi i parë

Tuana Sadiku – Vendi i dytë, Ilajda Hoxha - Vendi i tretë. Klasët e 11-ta, Aida Kovaçi- Vendi i parë, Tina Gashi – Vendi i dytë, Redon Hajrizi – Vendi i tretë Klasët e 12-ta, Erti Rushiti- Vendi i parë, Bedri Haliti- Vendi i dytë; Garat Republikane në Fizikë; Erti Rushiti- Vendi i tretë,

Garat Komunale në Futsall; vendin e parë djemtë dhe vajzat;

Garat Komunale në Basketboll; vendin e parë djemtë dhe vajzat;

Garat Komunale në Volejbol: vendin e parë.

SHFMU "Liria" Stroc: ka zënë vendin e parë në nivel republike në garën Spelling Bee. Nxënësi Rrezon Aliu ka fituar vendin e parë ku shkolla ka fituar një set me libra dhe nxënësi ka fituar një iPad.

SHFMU- Nedaçoc në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2024/2025 është Vendi i parë në garën komunale për esenë më të mirë.

Vlerësimet e jashtme

Testi i maturës 2025

Testi i maturës u mbajt me 21 qershor 2025, në 5 qendra testimi. Në test morën pjesë tre institucione të arsimit të mesëm të lartë: Gjinnazi "Eqrem Çabej", SH.M.T. "Lutfi Musiqi", dhe SH.M.P. "Bahri Haxha" Vushtrri. Gjatë këtij viti pati në ndryshime në proces të testit maturës si në paraqitje e provimit shtetëror dhe ndarja e nxënësve gjatë testimit.

Përmes tabelës dhe grafiqeve pasqyrojmë përqindjen e kalueshmërisë dhe krahasimit me vitin paraprak.

SHKOLLA:	2024	2025	Krahasueshmëria
Gjinnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri	88.80%	90.00%	-1.20%

SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri	49.80%	42.00%	7.80%
SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri	58.82%	41.84%	16.98

Testi i Arritshmërisë 2025

Testi i Arritshmërisë u mbajt më 27 qershor. Në test u përfshin 9 lëndë dhe gjithsej 100 kërkesa (pyetje, detyra). Drejtoria Komunale për Arsimit ka digjitalizuar dhe përpunuar të dhënat e testit të arritshmërisë dhe ka nxjerrë analiza statistikore të cilat do të jenë shumë të dobishme për Drejtorinë dhe shkollat e komunës sonë.

Nr. i kërkesave:

- | | |
|------------------|-----------|
| 1. Gjuhë shqipe | 20 pyetje |
| 2. Gjuhë angleze | 5 pyetje |
| 3. Histori | 13 pyetje |
| 4. Gjeografi | 12 pyetje |
| 5. Matematikë | 20 pyetje |
| 6. Informatikë | 5 pyetje |
| 7. Fizikë | 8 pyetje |
| 8. Kimi | 8 pyetje |
| 9. Biologji | 9 pyetje |

Lënda:	Kalueshmëri a në %, viti 2024	Kalueshmëri a në %, viti 2025	Krahasimi
Mesatarja në nivel Komune	47.79	44.87	2.92

Kalueshmëria në shkollat:

Nr.	Shkolla	Përqindja	Meshkuj	Femra
1	SHMU-2 Vushtri	49.18	48.26	50.29
2	SHFMU "Mustafë Shyti" Oshlan	46.82	43.63	50.00
3	SHFMU "Rexhep Musa" Ceceli	95.21	90.41	99.42
4	SHFMU "12 Qershori" Mihaliq	44.39	46.87	39.21
5	SHFMU - Nedakoc	42.21	25.07	17.14
6	SHMU-1	52.26	52.27	52.25
7	SHFMU "Rilindja" Maxhunaj	41.82	42.29	41.36
8	SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtri	50.76	49.78	51.87
9	SHFMU "Adem Voca" Pasomë	49.20	44.85	59.33
10	SHFMU Pestovë	97.31	88.42	113.31
11	SHFMU "Nazmi Zhegrova" Stanoc I P.	47.14	27.91	19.22
12	SHFMU "Latif Berisha" Doberllukë	46.84	42.60	52.15
13	SHFMU "Bahri Kuqi" Shtitaricë	45.78	45.01	46.91
14	SHFMU "Enver Hadri" Smrekonicë	52.96	58.53	47.80
15	SHFMU "Liria" Stroc	0.46	0.42	0.49
16	SHFMU "7 marsi" Bukosh	45.60	40.33	49.95
17	SHFMU "Dëshmorët" Zhilivodë	36.30	33.20	40.98
18	SHFMU "28 Nëntori" Vërmicë	51.24	55.52	47.49

19	SHFMU "Lumni Surdull" Samadrexhë	43.28	39.67	45.29
20	SHFMU "Migjeni" Stanoc i E.	42.02	42.30	41.58
21	SHFMU "Jusuf Gërvalla" Dumnicë e P.	0.41	0.40	0.42
22	SHFMU "Bajram Curri" Dumnicë e Lj	0.49	0.59	0.43
23	SHFMU "Emin Duraku" Novolan	47.47	44.90	53.14
24	SHFMU "Gj.K.Skenderbeu" Pantinë	54.10	56.70	50.70
25	SHFMU "Hajrullah Shala" Akrahticë	50.11	48.00	52.75
26	SHFMU "Martirët" Reznik	49.58	41.42	55.30
27	SHFMU "Azem Bejta" Doboc	46.90	50.68	42.58
28	SHFMU "Abdyl Frashëri" Druar	43.60	42.78	47.51
29	SHFMU "Lummadh"	35.75	29.95	53.14
	Kalueshmëria	44.87	41.94	45.51

Investimet nga komuna

- SHFMU "Liria" – Stroc u pajis nga Komuna me 4 televizorë "Fuego 60", në vlerë 2000 €;
- SHFMU "Bahri Kuqi", është pajisur me dy "Smart TV 65" dhe një klimë 1200 BTU për ngrohje;
- Gjinnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri, nga Komuna u pajis me perde (për 6 klasë) në vlerë 1000 euro, si dhe regullimi i ndriçimit në sallën e sporteve, riparimi i një pjese të njeve sanitare, riparimi i disa qeramikeve në korridoret e shkollës me vlerë 2600 euro.
- SHFMU "Latif Berisha" – Doberllukë, u pajis nga Komuna me 1 smart TV LED dhe një projektor;
- SHFMU "Mustafë Shyti" – Oshlan, është pajis nga Komuna me 2 smart TV;
- SHMP "Bahri Haxha" – Vushtri, janë pajisur me SMART TV të gjitha klasat e mësimi dhe kabinetet (planifikim me buxhetin e shkollës). Janë pajisur me lloptopë personal të gjithë mësuesit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- Investime në ShMU 1, nga buxheti i shkollës dhe i Komunës: televizor për klastë, video-projektor për klastë, perde për klastë, makinë dore për bari (trimer), makinë dore për bari (trimer), aparatet për fikjen e zjarrit, 20 drunj dekorativ, zhavori për parking, ndërrimi i dyerve të tualeteve, ngjyrë për disa klasë, makinë e bari;

- SHMU 2, u pajis nga Komuna nga 23 laptopë;
- SHMP "Bahri Haxha" – Vushtri, është pajisur me mjete bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale, kabinetet e kimisë, teknologjisë ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës).
- Adaptimi i qendrës së kulturës në Shtitaricë dhe për çerdhe me vlerë 135,942.70 €;
- Adaptimi i shkollës së vjetër në Stanoc të epërm për çerdhe me vlerë 204,132.15 €;
- Rregullimi i hyrjes së shkollës me e qeramikën në n Studime të Epërme 4,366.00 €;
- Renovimi i dyshemesë së klasave në SHMU-2 me vlerë 82,476.00€;
- Rregullimi i platos në SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtri me vlerë 69,515.00€;
- Renovimi i dyshemesë së klasave në SHMU-1 me vlerë 2,557.50 €;
- Ngjyrosja me fasadë hapësirat e brendshme të shkollës në SHFMU "Gj.K.Skënderbeu" Pantinë me vlerë 5,124.00€;
- Ndërtimi i shkollës "Musafë Venhari" vazhdim i projektit 2024;
- Në SHMP "Bahri Haxha" Vushtri janë vendosur dyer e reja dhe panelet e ndriçimit me vlerë 9000.00€ dhe tualet 8000.00€;
- Janë pajisur shkollat me tabela të mençura: SHFMU "A.Z.Çajup" Vushtri me 13 tabela, SHFMU "Mustafë Venhari" Vushtri me 16 tabela, SHMU-1 Vushtri me 15 tabela, Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtri me 12, gjithsej 56 tabela të mençura me vlerë 97, 888.00 euro.

Donacionet

- SHFMU "Liria" – Storc, pranoi donacion nga Këshilli i fshatrave Stroc, Beçuk, Gllavotin, Bivolak dhe Zhilivodë. Donacion shkollës me dy klima SENSSECCO 12BTU – në vlerë prej 1000 € si dhe nga Sticing MIRA – Donacion shkollës me dy klima SENSSECCO 18 BTU në vlerë prej 1200 €;
- SHFMU "Bahri Kuqi" Shtitaricë, pranoi donacion nga Sami Pilana dhe Besnik Pilana, të dy banues në Gjermani, kontribuan me nga 250€, duke siguruar gjithsej 500€, me të cilat u realizua instalimi i ri i ujit dhe u vendosën fontana dhe rubinete të reja për banjot e nxënësve si Rexhep Pilana dhuroi 150€, të cilat gjatë gjysmëvjetorit të parë u shpenzuan për nevojat e shkollës, për programet festive dhe higjienën;
- Foleja 2 – Vushtri, pranoi donacion nga Fabrika e miellit dhe keksëve "Molitoria". – Dhuroi disa kilogramë miell dhe disa pako me keksa për institucionin tonë. Kompania "Liri", dhuroi çanta dhe keksa për fëmijët e grupmoshës 2-3 vjeç. Kompania "Fruti", dhuroi lëngje për fundvit për të gjithë fëmijët e kopshtit tonë;
- Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri, ka pranuar donacion nga fondet e Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me Kosova Education Center dhe Ipko Foundation, Klubi Kundër Diskriminimit, i cili është nën mentorimin e profesorit Artin Dushi, është shpërblyer me një dron si vlerësim për kontributet e tyre, dhe për t'i ndihmuar ata në realizimin e projekteve që i kanë në kuadër të projektit "Action Against Discrimination For All". – Donacion nga Prof. Raif Mehmeti, ish-profesor i gjimnazit që vepron në Suedi, ka dhuruar 300 euro për tre nxënës nga 100 euro. Donacion nga Ndërmarrja Komunale "Përparimi", Ndërmarrja komunale "Përparimi" i ka dhuruar shkollës 8 pisha për mbjellje në oborrin e shkollës;
- SHFMU "Latif Berisha" – Dobërllukë, kanë dhuruar 259 euro për shkollën;

- SHFMU "Mustafë Shyti" – Oshlan, ka vazhduar marrëveshjen që ka pasur me MZHE-në për internet të shpejtë dhe të sigurt, ku tashmë interneti funksionon në komplet objektin, me pajisje extra-moderne;
- SHF "Mustafë Venhari" Vushtrri: Kompania Kosmonte Foods shpërndau dhurata për nxënësit e klasave të para si dhe INTEREX, me pronar z. Shaip Mikullovi, duke i gëzuar me dhuratat tuaja për festat e fundvitit;
- SHF "Naim Frashëri" Vushtrri pranoi donacion nga prindërvë janë instaluar 7 klima nëpër klasë. Po ashtu dy prindër dhuruan 140 euro për veshje kombëtare si dhe një prind dhuroi 21 lektyra të ndryshme për klasën II/3;
- Në SHFMU "Pestova, "Vipa Chips" ka dhuruar nxënësve dhurata për fundvit;
- SHMU-1 pranoi donacion: Inventar nga QKMF, tavolina për zyre karrige dhe dollapa nga QKMF-ja me vlerë 1400€. Biblioteka e shkollës 350€ drejtori, 100€ zv, Bibliotekistja 50€ dhe 230 € mësime nxënësve. Ujëmbledhëse për banjot dhe pas shkollës, drejtori i shkollës me vlerë 85€. Kamerat në koridor, 5 copa, 200€ nga drejtori, koordinatori dhe mësime nxënësve. Bravë për dyer, drejtori i shkollës me vlerë 150€. Ngjyrë për kabinetin e artit nga drejtori me vlerë 90€. Zyra e koordinatorit të cilësisë nga koordinatori me vlerë 50€. Ngjitja e fjalëve të urta në shkallë nga Burim Plakolli me vlerë 250€. Zmadhuesi i zërit dhe 4 mikrofonat nga Fllanza Ademi, Drejtori-Koordinatori me vlerë 220€. Ngjyra brusha pëlhura për nxënës, nga OJQ Harea 350€. Qeshmja e shkollës nga drejtori i shkollës 40€. Guaca e pezmes nga Sekretarja 130€. Donacion i Tv-së nga Benny Shop me vlerë 400€. Printer dhe dollap me vlerë 200€. 3 projektor nga Naser Imeri me vlerë 1200€. Laptop nga Safet Imeri me vlerë 400€. Pesë kubik beton për oborr të shkollës dhe ulëse nga Ariani Company me vlerë 350. Ngjyrë për klasë nga German Color 50€ Makinë për ujë të pijes nga Interplast me vlerë 120€. Smart tabelë dhe një projektor nga IPKO me vlerë 2000€. Ndërsa edhe mësime nxënësve të cilët dhanë donacion në mjete: Jehona Zabërxha me 560 €, Esat Beka me 265€, Majlinda Ramaj me vlerë 1200€, Valdete Bunjaku me vlerë 400€. Sebahate Vatovci me vlerë 200€. Fllanza Ademi me vlerë 450€, Lulejtë Miftari me vlerë 100€. Dafina Dërguti me vlerë 71€. Xhenta Venhari me vlerë 151€ dhe Medije Hyseni me vlerë 105€. Afërsisht donacion që ka tërhequr kjo shkollë 13.000€;
- SHFMU "Nazmi Zhegrova" – Stanoc, ka pranuar donacion nga KFORI Danez, klima në të gjitha klasat e mësimit;
- SHFMU" Rexhep Musa" – Ceceli, ka pranuar donacion nga bashkëqytetari Irfan Perçuku, i cili jeton dhe vepron në Gjermani, i ka dhuru shkollës një donacion me pajisje sportive, në vlerë 108 euro;
- SHFMU "A. Z. Çajupi" – Vushtrri, ka pranuar donacion: Rregullimi i bankave për dy klasë dhe ngjyrosja e një klase nga prindërit; Ndërrimi i të gjitha dritave led në klasa, donacion nga kompania "Zariqi Group" në vlerë 1100€; Firma "Urban Group" me pronar Agim Maloku, investoj në rregullimin e dy dyerve të bodrumeve në katin e parë; Ngjyrosja e korridoreve të shkollës, ndërrimi i dritave led dhe rregullim i parmakëve, në vlerë 2600€, donacion nga kompanitë (mobileria "Duli", fabrika e dyerve "Preteni", "German Color" "Soni Tours" dhe prindërit e komunitetit të shkollës;
- SHMU 2, pranoi donacion 26 palë dresa për ekipet e shkollës, donacion nga kompania "NIKU Travel".
- Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri: ka pranuar donacion Smartbord me vlerë 1164 euro, donacion nga GLZ në bashkëpunim me Indep. Donacion me vlerë 400 euro nga Shtëpia Botuese PEMA, për bibliotekën e shkollës. Donacion nga Qendra për Arsimin e Kosovës (KEC) në partneritet me Ipko Foundation (IF), Laptop Lenovo, Sasia 1. NP "Përparimi", 500 lule dhe 8 pisha për ambientin e shkollës;

- SHFMU "Emin Duraku" Novolan: Donacion nga KFORI danez në vlerë prej 2000 euro, dhe pajisja e të gjitha klasave me klima të gjitha donacion nga Danimarka. Donacion rregullimi i perdeve nga prindi Emin Muzaqi për klasën e IX-të. Donacion nga mërgimtari Arian Dërguti në vlerë 280 euro, materiale shkollore për nxënës si dhe renovimi i pillakës së emrit të shkollës. Donacion anonim me një kontingjent pre 200 librave për pasurimin e bibliotekës së shkollës sonë;
- SHMU-2 Vushtri ka përfituar donacion 2 aparata të ujit Sharjah Charity International;
- SHMU-1 Vushtri ka përfituar donacion 1 aparata të ujit Sharjah Charity International;

Suksesi i përfundimit të vitit shkollor 2024/25

Suksesi i fundit të vitit shkollor 2024/25 klasa 1- 5, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak						
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftuesh	Të panotuar
2025	67.22%	19.12%	10.57%	2.98%	0.07%	0.02%
2024	65.97%	19.51%	11.06%	3.27%	0.06%	0%
Krahasueshmëria	1.25%	-0.39%	-0.49%	-0.29%	0.01%	0.02%

Suksesi i fundit të vitit shkollor 2024/25 klasa 6- 9, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftuesh	Kanë përsëritur klasën	Të panotuar
2025	28.85%	21.39%	26.51%	15.41%	7.33%	0.38%	0.13%
2024	28.25%	21.26%	27.85%	16.69%	2.82%	0.25%	0.05%
Krahasueshmëria	0.60%	0.13%	-1.34%	-1.28%	4.51%	0.13%	0.08%

Suksesi i fundit të vitit shkollor 2024/25 klasa 10- 12, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftuesh	Kanë përsëritur	Të panotuar
2025	13.85%	20.24%	32.93%	29.94%	0.98%	0.89%	1.16%
2024	15.04%	21.07%	33.16%	27.35%	0.78%	0.34%	0.68%
Krahasueshmëria	-1.19%	-0.83%	-0.23%	2.59%	0.20%	0.55%	0.48%

Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2025/2026

Të gjitha institucionet shkollore kanë bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2025/2026 me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e procesit mësimor. Viti shkollor 2025-2026 ka filluar me 1 shtator 2025. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka hapur platformën

për aplikim për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore. Aplikimin për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore ka qenë i hapur në Platformën E-Kosova deri në fund të muajit shtator. Në muajin gusht janë bërë të gjitha përgatitjet teknike të shkollave dhe të gjitha objektet kanë qenë të gatshme për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor.

Numri i nxënësve në nivele për vitin shkollor 2025/26:

Niveli 0: 1082 nx.
Niveli 1: (1-5) 4570 nx.
Niveli 2: (6-9) 3820 nx.
Niveli 3: (10-12) 2174 nx.
Gj; nxënës: 11646

Numri i paraleleve:

Grupa 5-6 – Parafillor: 40
Fillor klasa 1-5: 266
I mesëm i ultë: 206
I mesëm i lartë: 105
Gjithsej: 642 paralele

Personeli:

Zyrtarë të DKA-së: 11
Drejtues: 38
Zëvendës drejtues: 8
Pedagog/e: 10
Psikolog/e: 10
Asistent/e: 12
Bibliotekist: 9
Këshilltarë karriere: 2
Sekretar/e: 11
Punëtorë teknik: 140
Edukatore: 86
Mësimdhënës klase: 265
Mësimdhënës lëndor kl.6-9: 372
Mësimdhënës lëndor kl.10-12: 174

Gjithsej mësime dhënë/e edukatore dhe mësime dhënë/e 897
 Numri total i punëtorëve: 1147

Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2025/2026

Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2025/2026

Klasë	Shkollëqësor	%	Sh. mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Më mirë notë të dobët	%	Më mirë notë të dobët	%	Më mirë me shumë nota të dobëta	%	Të pa notuar	%	Gjithëj
Klasa 1	720	86.96	70	8.45	25	3.02	11	1.33	0	0.0	2	0.24	0	0	0	0.00	828
Klasa 2	659	74.13	136	15.30	61	6.86	30	3.37	0	0.0	0	0.00	1	0.112	2	0.22	869
Klasa 3	694	66.22	186	20.74	92	10.26	20	2.23	1	0.1	0	0.00	3	0.334	1	0.11	897
Klasa 4	508	55.96	225	24.75	136	15.29	37	4.07	2	0.2	0	0.00	0	0	1	0.11	909
Klasa 5	482	53.67	230	25.61	124	13.81	43	4.79	14	1.6	4	0.46	1	0.111	0	0.00	896
Klasa 6	278	31.80	246	28.23	143	16.47	11	1.27	62	7.1	31	3.57	100	11.52	0	0.00	868
Klasa 7	217	23.77	212	23.22	145	15.88	30	3.29	97	10.6	48	5.26	159	17.42	5	0.56	913
Klasa 8	189	19.48	182	18.76	161	16.60	22	2.27	75	7.7	56	6.06	279	28.76	3	0.31	970
Klasa 9	208	24.50	166	19.79	144	15.96	22	2.59	78	9.2	46	5.65	181	21.32	0	0.00	849
Klasa 10	29	4.55	111	17.43	114	17.90	68	13.61	68	10.6	40	6.28	183	28.73	3	0.47	637
Klasa 11	55	10.07	91	16.67	88	16.12	60	10.99	36	7.1	25	4.58	167	34.25	1	0.18	546
Klasa 12	70	12.03	121	20.79	73	12.54	63	10.62	47	8.1	33	5.67	171	29.38	4	0.69	582
Gjithëj	4004	40.92	1977	20.20	1309	13.38	437	4.47	484	4.9	290	2.96	1265	12.83	20	0.20	9788

Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

D.SH.P.S dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Ligjin për Shëndetësi, U/A për K.P.Sh, Statutin e QKMF në Vushtri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Drejtoria e Shëndetësisë, në kuadër të realizimit të politikave sociale dhe shëndetësore, ka planifikuar dhe realizuar shpenzime buxhetore nga kategoria e subvencioneve për mbështetjen e qytetarëve dhe organizatave të ndryshme. Në kuadër të subvencioneve për shërim, është ndarë shuma prej **66,750.00 Euro**, e cila ka për qëllim mbulimin e kostove të trajtimeve mjekësore për qytetarët në nevojë, brenda dhe jashtë vendit. Këto mjete kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e qasjes në shërbime shëndetësore për rastet që kërkojnë trajtim të specializuar. Për shtesat për fëmijë, është alokuar shuma prej **120,360.00 Euro**, me qëllim mbështetjen financiare të familjeve dhe përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve. Ky subvencion synon të lehtësojë barrën ekonomike të familjeve dhe të ndikojë pozitivisht në zhvillimin dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Në kuadër të bashkëpunimit me organizata humanitare, është realizuar subvencion në vlerë prej **69,694.86 Euro** për organizatën **Islamic Relief**, e cila zhvillon aktivitete humanitare dhe sociale në mbështetje të shtresave në nevojë. Gjithashtu, nga kategoria e subvencioneve është realizuar pagesa në vlerë prej **86,431.70 Euro** për përmbuesin, në përmbushje të obligimeve financiare të përcaktuara me vendime përkatëse.

Organizimi i KPSH bazohet në Ligjin për Shëndetësi, aktet nën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, Statutin e Komunës dhe Statutin e QKMF-së. Me ligjin për vetqeverisjen lokale përgjegjësi për organizimin dhe kompetencat në KPSH i takojnë nivelit lokal të qeverisjes.

QKMF-ja është përgjegjëse për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare, si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

RRJETI I INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Aktualisht kujdesi parësor shëndetësor në komunën e Vushtrisë është i organizuar përmes institucioneve shëndetësore si në vijim:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - institucioni themelor i KPSH-së,

10 Qendrat të Mjekësisë Familjare (QMF) - si njësi përbërëse të QKMF-së

9 Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF) - si njësi përbërëse të QMF-së

Figura 1. Struktura organizative e KPSH-së në Vushtri

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr.Safet Idrizi" në Vushtri është institucioni shëndetësor kryesor që ofron dhe zbaton Kujdesin Parësor Shëndetësor publik në gjithë territorin e komunës, sipas U/A për KPSH. QKMF ka obligim ligjor që të kujdeset për qytetarët e komunës për sa i përket Kujdesit Parësor Shëndetësor, nën mbikqyrjen dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Shëndetësisë (DSHPS), të cilës njeherit i raporton për të arriturat apo sfidat, duke i zgjedhur bashkarisht shqetësimet që hasen gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore. DSHPS-së s'bashku me menaxhmentin e QKMF-së caktojnë dhe implementojnë politikat shëndetësore për Komunën e Vushtrisë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës pa dallim etnike, gjinie, religjioni, race etj.

Promovimin shëndetësor, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin,

Promovim: informim, komunikim dhe edukim në institucione, shkolla dhe komunitete,

Parandalim: imunizimin/vaksinimin, monitorim të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve përmes vizitave sistematike, mjekim: përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor, kujdesin akut përfshirë ofrimin e kujdesit urgjent, mbikqyrjen dhe transportin deri në institucionet përkatëse, rehabilitim: kujdesi palativ/terminal.

Raporti vjetor i shërbimeve shëndetësore janar - dhjetor në QKMF 2025

Tabela 1. Do të paraqesim në formë tabelare rrjetet e QMF dhe AMF-Janare-Dhjetor 2025 në kuadër të QKMF për vizitat mjekësore .

Janar-Dhjetor 2025												
Nr.	Emri i shërbimit	Totali	Meshkuj	Femra	Pac. që kanë Particu	Shërbime	Referime	Malinje	Kronike	Nga Mjeku Privat		Paliativ
										Inek.	Infuzi	
1	QKMF	65249	30264	34985	13754	210753	2954	105	3753	3243	4608	32
2	Urgjenca	35528	16555	18973	6529	170824	4431	330	6476	1944	2804	2063
3	Laboratori	15360	6307	9053	4119	149996	0	0	0	0	0	0
4	Stomatologjia	7812	3659	4153	1179	31711	157	0	0	190	0	0
5	RTG	5667	2649	3018	1655	16013	0	0	0	0	0	0
6	Rtg e dhembit	371	143	228	79	881	0	0	0	0	0	0
7	Vaksinimi	4966	2692	2274	0	12567	0	0	0	0	0	0
8	QMF-1	65614	30619	34995	18240	244779	5040	215	3676	2379	2609	19
9	QMF-2	6157	2741	3416	1016	38083	410	0	466	580	458	0

10	QMF-3	7567	3604	3963	1696	49689	42	0	1274	258	208	0
11	QMF-AMF	23508	10674	12834	4203	95415	4105	103	2750	802	696	0
12	Mamografia	77	0	77	0	390	0	0	0	0	0	0
	Gjithsejt	237876	109907	127969	52470	1021101	17139	753	18395	9396	11383	2114

Tabela 2. QMF dhe AMF, 12 mujori për vizitat mjekësore dhe shërbime 2025.

	QMF-AMF	Totali	M	F	Referime t	Participi m	Shërbim e tjera	Vizita me kartel e	S.Malinj e	S.Kronik e	Nga Mjeku Privat	
											I.M	Infuzjon e
QMF dhe AMF	QMF Lumadh	7381	3559	4251	291	1589	40719	555	41	492	534	470
	QMF Smrekonicë	3287	1793	1655	713	713	12990	75	10	426	58	46
	QMF Pantinë	2391	1131	1390	917	476	10345	0	33	501	28	44
	QMF Druar	1918	983	1029	829	318	5886	61	3	37	12	5
	QMF Novolan	839	464	418	103	1	2591	2	0	145	18	36
	QMF Maxhunaj	3602	1937	1884	717	923	11674	0	0	370	69	69
	QMF Dumnicë	549	256	316	187	47	2991	0	0	24	20	7
	AMF Samadrexhë	1239	631	683	276	38	8501	183	0	296	37	5
	AMF Stravc	739	356	414	204	82	2445	54	3	105	17	12
	AMF Pasomë	569	282	303	6	6	2590	112	0	40	2	0
	AMF Oshlan	368	208	166	15	3	554	23	0	0	2	2
	AMF Beçiq	252	144	108	71	3	410	0	0	6	0	0
	Amf Dubovc	64	35	29	5	0	97	0	0	2	0	0
	AMF Ceceli	310	131	188	71	4	2316	0	0	53	5	0
	Gjithsejt:	23508	11911	12834	4405	4203	104109	1065	90	2497	802	696

SHËNDETI PUBLIK

Tabela 4. Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë për komunën e Vushtrrisë,

SËMUNDJA	Presi mon ia/A RI	ILI	Diarrh eac	Vari çell a	Infl uen ca A	Infl uen ca B	CO VI D- 19	Me nin gju ser osa	Meri ngoe ncep halit ac.	**M orbi lli	Parot ins epide miza	Pe rtu ssi s	Hep atit ac. B	Hep atit ac. C	Helvi met me ushqi m	Bru celo zu	Tal are mi	Sal mon ello za	E.c oli	IS T	HI V	TB	mes t strep tokok sike të m	Sëm. t jera ngitë se	Eriz ipel a	Totali
MITROVICË	700	9225	7820	354	145	240	1	2	2		3	2	5	3	74			8		3	1	18		108	2	18716
MITROVICË E V.																										
SKËNDERAJ	165	1044	1658	69				1		1					167					1		2				3109
VUSHTRRI	339	1435	1261	152			1	4	1		5	3	2	1	30	3	3	2	7			19	3	423		3695
Z POTOX																										
ZVEÇAN																										
TOTALI	1205	11704	10740	575	145	240	2	7	3	1	8	5	7	4	271	3	3	10	7	4	1	39	3	531	2	25520

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykocet, Mononucleoza

** Raste të importuara: Malarie, Mpx, Morbill

Sektori i Vaksinit dhe Immunizimit :

Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vakcina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet si dhe në fshatra.

Tabela 4. Paraqet administrimin e vaksinave në 6 qendrat e KPSH si më poshtë:

Raporti i Shërbimit të Vaksinimit 2025											
	Totali	M	F	QKMF	QMF-1	QMF-2	Lumadh	Maxhunaj	Pantine	Smrekonic	Sherbimet
Janar	383	202	181	186	103	32	28	17	17	0	1038
Shkurt	338	196	142	181	105	21	17	0	14	0	849
Mars	405	231	174	174	116	38	28	10	19	23	981
Prill	481	258	223	216	145	47	29	11	19	14	1167
Maj	455	225	230	217	138	36	32	17	15	0	1084
Qershor	461	246	215	221	169	32	9	3	15	12	1049
Korrik	464	255	209	232	136	29	31	18	3	15	1156
Gusht	383	187	196	179	143	22	19	7	13	0	880
Shator	445	268	177	205	158	32	26	14	10	0	1131
Tetor	418	213	205	186	150	32	27	14	9	0	1009
Nentor	353	197	156	160	130	26	21	7	9	0	889
Dhjetor	380	214	166	180	125	25	22	11	13	4	818
Gjithsej	4966	2692	2274	2337	1618	372	289	129	156	68	12051

Tabela 6. Paraqet Vaksinat kundër gripit sezonal që janë administruar:

Nr.	Përshkrimi	Vaksina
1	Vaksina kundër gripit sezonal	2430

Menaxhimi i zingjirit të ftohtë është sipas standardeve, paisjet për standardizim dhe arritjen e kushteve maksimale të respektimit të zingjirit të ftohtë është në nivelin e duhur.

Tabela nr.7 Pasqyra e përfshirjes së nxënësve të vaksinuar 2025:

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vaksinim						
SHFMU	Nxënës të planifikuar		Kanë refuzuar		Vaksina të administruara	
	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	
Klasa I	941	100%	40	4.25%	901	95.75 %
Klasa VI	945	100%	119	12.59 %	826	87.41%
Klasa XII	660	100%	10	1.51 %	650	98.46 %
Totali	2546	100%	169	6.63 %	826	93.36%

Për herë të dytë është administruar vakcina HPV të vajzat e moshës 12 vjeçare dhe tek djemët të moshës 12 vjeçar. Ka pasur hezitim për marrjen e vaksinës në fjalë, por fal angazhimit të ekipës rezultati ka qenë i kënaqshëm, por në këtë drejtim duhet të punohet ende. Të planifikuar kanë qenë 945 nxenese, të vaksinuara janë 422 femra dhe 404 djem statistikave me përqindje janë të paraqitura në tabelë nr.7 të klasëve të VI. Vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta në SHFMU-të të Komunës së Vushtrrisë.

Qëllimet e vizitave sistematike

- Vlerësimi i nivelit të rritjes dhe zhvillimit të grupmoshës së caktuar, përkatësisht nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta të shkollave fillore .
- Njohja dhe identifikimi i veçorive specifike të problemeve shëndetësore të këtyre grupmosha, që do të mundëson zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe anomalive/çrregullimeve eventuale të fëmijët.
- Dizajnimi dhe organizimi i intervenimeve me natyrë preventive, të bazuara në shkollë dhe komunitet.
- Krijimi i një baze të të dhënave nga rezultatet e vizitave të realizuara e cila do të mbështesë modifikimin dhe përpilimin e politikave shëndetësore më favorizuese për fëmijët.

Parametrat e vlerësuar:

Është vlerësuar zhvillimi i përgjithshëm psikofizik dhe shëndeti oral Kronologjia e aktiviteteve

Tabela 8. Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike						
SHFMU	Nxënës të planifikuar për vizita sistematike		Munguar		Vizita të realizuara	
	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%
Klasat I	883	100	9	1%	874	99%
Klasat V	891	100	34	4%	857	96%
Klasat IX	949	100	58	6%	891	94%
Gjithsejtë	2723	100	101	4%	2622	96%

Tabela nr. 1- Pasqyrë e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike
 Nga gjithsejtë 2723 nxënës të planifikuar për vizita, vizita të realizuara janë 2622 apo 96%, ndërsa numri i nxënësve të cilët kanë munguar është 101 apo 4% .
 Shkalla e realizimit të vizitave është paraqitur në tabelën dhe në grafikoni nr.1.

Raporti gjinor i nxënësve të vizituar :

Raporti gjinor i nxënësve të përfshirë në vizita sistematike						
SHFMU	Nxënës të vizituar		Meshkuj		Femra	
	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%
Klasat I	874	100	495	57%	379	43%
Klasat V	857	100	448	52%	409	48%
Klasat IX	891	100	452	51%	439	49%
Gjithsejtë	2622	100	1395	53%	1227	47%

tabela nr. 2. - Raporti gjinor i nxënësve të vizituar

Janë vizituar gjithsejtë Meshkuj 1395 (53%) dhe vajza 1227 (47%). Struktura gjinore e nxënësve të vizituar, paraqitet në tabelën nr. 2. dhe në grafikun nr. 2.

VLERËSIMI I REZULTATEVE

Nga vlerësimi i rezultateve të dalë nga vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta, mund të konstatohet se në përgjithësi kemi të bëjmë me një kategori të popullatës (nxënës) të shëndoshë, përjashtimisht problemeve të shëndetit oral, patologjive refraktare të syve. Përndryshe, shkalla e përgjithshme e shprehur në përqindje e parametrave të vlerësuar me veçori patologjike në shumicën e parametrave është shumë e vogël përjashtimisht dyshimit në çrregullimet refraktare të syve, mbipeshës, kariesit të dhëmbëve të qumështit dhe higjienës jo të mirë orale dhe rasteve të dyshuara me VCC.

Higjiena orale e nxënësve nuk është e mirë, e shprehur në përqindje nga numri total i nxënësve të kontrolluar, del se 48.4% e tyre janë me nivel të ulët të higjienës orale. Gjendja e mukozës dhe gingivave me veçori patologjike prezanton të jetë 1.1% nga numri total i nxënësve të vizituar.

Sa i përket zhvillimit të përgjithshëm psikofizik, veçori patologjike në shkallë më të madhe janë konstatuar të të pamurit e të cilat kanë të bëjnë kryesisht me anomalitë refraktare (ametropia).

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar (2622 nxënës), shkalla e përgjithshme e veçorive patologjike të të pamurit arrin në 17.7% (465 nxënës), ndërsa numri i nxënësve të cilët bëjnë bartin syze për korrigjim të refrakcionit është 163, përkatësisht 6.2%.

Statusi psikik- Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, në aspektin psikik, nga numri total i nxënësve të ekzaminuar (2622), si raste të dyshimta me veçori patologjike janë 59 nxënës (2.3%). Veçoritë patologjike të identifikuar adresohen kryesisht në drejtim të çrregullimit të mësuarit dhe mungesës së vëmendjes.

Gjatë ekzaminimit të të dëgjuarit nuk kemi gjetur raste patologjike të cilat do të konsideroheshin si shumë relevante dhe të besueshme, për shkak se nuk kemi pasur hapësirat adekuate për të kryer ekzaminimet për dëgjim. Janë të dyshuar 15 nxënës (0.6%).

Zemra- nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, 9 nxënës (0.3%) janë të dyshuar për veçori patologjike të zemrës.

Gjatë evoluimit të projektit, të SWOT analiza u përmenden disa rreziqe të cilat do të reflektonin dukshëm në mundësinë e mos arritjes së rezultatit të pritur apo zëvendësimin e tij me ndonjë rezultat tjetër, atëherë shtrohet pyetja se cili do të duhej të ishte menaxhimi i supozimeve dhe rreziqeve në këtë rast:

1. Supozimet dhe rreziqet e rëndësishme veç janë identifikuar (sidomos pika 2,3,4 dhe 5);
2. Të minimizohen gjasat e rrezikut apo të eliminohet rreziku (në këtë rast rreziku për mos arritje të rezultatit të dëshiruar është nga faktori njeri, gjegjësisht nga të gjitha palët e interesit: drejtori i shkollës; mësuesi, prindi si dhe nga ekipi zbatues i projektit).
3. Meqenëse neve në këtë rast po na mungon informata kthyesë mbi numrin e nxënësve të cilët i kemi referuar si raste të dyshimta, atëherë që të minimizohet apo të eliminohet rreziku, hartuesi dhe zbatuesi i projektit duhet që më fillimin e vitit të ri shkollor serish të bëjë ri monitorim për secilin rast të dyshuar dhe në secilën shkollë në mënyrë që rastet eventuale të cilat kanë qenë të referuara për ekzaminim të mëtejshëm të identifikohen dhe të realizohen këto ekzaminime.

ROLI DHE RËNDËSIA E SISTEMIT INFORMATIV SHËNDETËSOR

Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH) paraqet një komponent thelbësor në funksionimin e shërbimeve shëndetësore parësore. Ai mundëson:

- Regjistrimin elektronik të pacientëve

- Evidentimin e vizitave mjekësore dhe stomatologjike
- Menaxhimin e të dhënave për imunizim dhe vaksinim
- Përgatitjen e raporteve mujore dhe vjetore
- Monitorimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse

Gjatë vitit 2025, SISH ka qenë mjeti kryesor për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave shëndetësore në QKMF Vushtri dhe njësitë vartëse.

FUNKSIONIMI I SISH NË QKMF VUSHTRRI

Në vitin 2025, Sistemi Informativ Shëndetësor është përdorur në mënyrë të vazhdueshme dhe aktive në të gjitha sektorët e QKMF Vushtrri, përfshirë:

- Mjekësinë Familjare
- Shërbimet Stomatologjike
- Tretmanin dhe shërbimet infermierore
- Infuzionet
- Lidhetoret
- Imunizimin dhe Vaksinimin

Sistemi ka funksionuar si platformë unike për regjistrimin e shërbimeve dhe ka kontribuar në standardizimin e punës dhe rritjen e transparencës institucionale.

SHPËRNDARJA DHE AKTIVIZIMI I SISTEMIT BHIS

Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF)

Gjatë vitit 2025, sistemi BHIS ka qenë i aktivizuar dhe funksional në këto QMF:

- QMF 1 Vushtri
- QMF 2 Vushtri
- QMF 3 Vushtri
- QMF Lumadh
- QMF Pantinë
- QMF Smrekonicë
- QMF Maxhunaj
- QMF Druar
- QMF Novolan
- QMF Dumnicë

Në të gjitha këto qendra është funksional edhe moduli i BHIS, duke mundësuar raportim të saktë dhe në kohë reale.

Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)

Sistemi BHIS është aktiv edhe në këto AMF:

- AMF Samadrexh
- AMF Strovë

- AMF Ceceli
- AMF Pasomë
- AMF Oshlan
- AMF Beçiq nuk është funksionale
- AMF Dubove nuk është funksionale

Aktivizimi i sistemit në AMF ka ndikuar në përmirësimin e mbledhjes së të dhënave në zonat rurale.

MIRËMBAJTJA TEKNIKE DHE SIGURIA

Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitete të shumta teknike, të cilat përfshijnë:

- Montimin e kamerave të sigurisë
- Konfigurimin e sistemeve të monitorimit
- Mirëmbajtjen dhe testimin e pajisjeve

Këto aktivitete janë kryer në:

- QMF 1 Vushtri
- QMF 2 Vushtri

Kjo ka ndikuar në:

- Rritjen e sigurisë së objekteve shëndetësore
- Mbrojtjen e stafit dhe pacientëve
- Parandalimin e dëmtimeve dhe incidenteve

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsej 8694 pacient dhe ka dhënë 39608 shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllobimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora 07^h deri në ora 20^h në QKMF dhe në QMF-1, ndërsa në QMF-2 dhe QMF-3 nga ora 07^h deri në ora 14^h, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora 07^a deri në ora 19^a.

Shërbimet për nxjerrjen e dhëmbit: Caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, eks. Dhëmbit, tamponade e alveolës, këshilla për pacientin.

Shërbimet për vizita: caktimi i diagnozës, aplikim lokal me udhëzim për rtg dhe terapia e përgjithshme.

Shërbimet për shërimin e karriesit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit, vendosja e shtresës (me ose pa kalcimol), vendosja e bllobës dhe polirimi dhe korigjimi i pikave kontaktuese.

Shërbimet te pulpitet e dhëmbëve: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit deri në hyrje të kanaleve, eksterpimi i pulpës, mbushja e kanalit dhe vendosja e bllozës.

Shërbimet te gjakëderdhja pas nxjerrjes së dhëmbit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, kiretazha e alveolës, vendosja e hemostatikut dhe tamponade e alveolës.

Trajtimi i gingiviteve: largimi i pigmenteve të buta dhe të forta me kavitron dhe past me brush.

Bazuar në statistikat sipas regjistrat të popullsisë të vitit 2024 në ASK komuna e Vushtrise ka gjithësej 61528 banor, KPSH në Vushtri ka gjithësej 10 stomatolog, sipas U/A 6000 banor për një stomatolog.

Tabela 9. Paraqet Shërbime në sektorin e shëndetit oral preventive duke përfshi të gjitha qendrat:

Raporti 12 mujor i shërbimit te Stomatologjise 2025											
Muji	Totali	M	F	Prej tyre te para	Vizita serike	Pa mjekim	Me mjekim	Dhëmbë të nxjerrë	Intervenime tjera	Shërbimet	Participimi
Janar	843	414	429	848	2	2	341	189	201	4244	112
Shkurt	706	323	383	706	6	0	231	120	229	3161	82
Mars	476	226	250	485	0	2	137	110	167	2139	66
Prill	775	372	403	772	5	4	256	175	218	3281	130
Maj	697	328	369	698	0	1	186	151	155	2976	68
Qershor	505	226	279	505	2	1	198	108	138	2114	73
Korrik	713	353	360	701	0	0	275	151	163	3134	66
Gusht	639	324	315	639	0	2	281	133	114	2900	82
Shator	585	270	315	585	1	5	195	171	162	2801	94
Tetor	584	235	349	584	1	2	166	205	181	2675	122
Gjendja shëndetësore është stabile përjashtim të disa gripa sezonal tek disa prej pacientëve si dhe me disa probleme dentare të cilat janë evidentuar në QKMF-ne e Fshatit Lumadh. Të gjithë rezidentët janë kontrolluar nga Dr.Azem Haliti me të cilin kemi kontratë 3 vjeçare për ofrimin e shërbimeve, ku për secilin është përshkruar terapia dhe në bashkëpunim edhe me infermieret është caktuar koha e marrjes së terapisë. Qendra e Mjekësisë Familjare ka kryer shërbimin me analiza ku secilit rezident i është marrë mostra e gjakut dhe rezultatet janë kontrolluar nga Dr.Luljeta Zahiti këtu në QKMF Lumadh. Kam kërkuar në vazhdimi gjatë tërë vitit që rezidenti A.M të transferohet në Institutin Special Shtime për shkak të mospershtatjes së tij në ambientin e institucionit.Paraprakisht është njoftuar menaxheri i rastit z.Selim Peci në Mitrovicë dhe Ministria e Drejtësisë. Njoftimi zyrtar ka qenë që nuk ka vend të lirë dhe ende zgjidhje për këtë çështje nuk kemi pavarësisht perpjekjeve edhe të avokatit të popullit që ka qenë gjatë gjithë kohës në monitorim të rastit.

Vizita kemi vazhdimisht nga zyra për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Komunitetit të Vushtrrisë, ku si aktiviteti kanë sjelle dhuratat për rezident. Vizita nga QPS-të brenda vitit kemi vetëm nga komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës,Shtimes, dhe Skenderaj ku kemi bashkëpunim të ndërsjellët me menaxheret e rasteve.

Rezidentet të cilët janë të vendosur në Shtëpi të Rezidenciale janë nga komunat si në vijim:

Komuna e Vushtrisë 5 rezidentë
Komuna e Mitrovicës 2 rezidentë
Komuna e Skenderajt 2 rezidentë
Komuna e Prishtinës 1 rezidentë
Komuna e Obiliqit 1 rezident
Komuna e Shtimes 1 rezident

Puna Individuale me Rezidentë

Ka si pike synimi që rezidentet të marrin asistencë individuale nga punëtorët dhe të ndiejnë siguri në veprimet e veta dhe kjo arrihet me vete përmbajtje dhe durim të madh tek punonjësit socialë pasi që veprimet e rezidentëve janë të ngadalshme dhe të pa koordinuara varësisht shkallës së zhvillimit psikik, andaj kujdesi duhet të jetë maksimal.

-Puna në grup

Kjo metodë e punës sociale kërkon një durim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm pasi që të gjitha veprimet e rezidentëve janë të pa koordinuara. Puna në grup ka për qëllim rritjen e shkallës së shkathtësisë sociale personale të rezidentëve që me punë dhe veprime të ndryshme të kërkohet që të arrihet qëllimi i caktuar i integritetit dhe bashkëpunimit me të mirë në rrethin social.

-Intervenimi në Krizë (situata emergjente)

Duke u bazuar në gjendjen e tyre shpirtërore dhe shkallën e tyre të zhvillimit psikik rezidentët kanë shpesh edhe nevojë emergjente apo krizë të ndryshme që krijon trajtim dhe menaxhim të shpejtë, pasi që mund të ballafaqohemi edhe me situata të dhunës mes rezidentëve, andaj puna me rezident duhet të jetë sistematike dhe profesionalisht në nivelin e duhur. Punëtori se pari duhet të vërej ndryshimet tek rezidenti duke filluar nga shikimi, të ushqyerit, reagimi i tij gjatë marrjes së ushqimit, qëndrimi ndaj rezidentëve të tjerë të cilat nuk janë karakteristika të tij/saj.

Qendra për Punë Sociale

Detyrat programore të Qendrës për Punë Sociale janë të rregulluara me Ligjin mbi Asistencën Sociale, Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Përkujdesjen Materiale të Familjeve me Fëmijë të Afërsisht të Kufizuar si dhe Ligje dhe Akte tjera të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në periudhën raportuese mund të themi se kanë ardhur në shprehje maksimale të gjitha grupmoshat të shprehura përmes kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale dhe janë ofruar shërbime apo forma adekuate të mbrojtjes sociale. Krahasuar me vitin paraprak kemi ngritje të shërbimeve dhe të kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale.

Asistenca Sociale

Pranë QPS-së, Vushtrri në Asistencë Sociale janë 918 familje, prej tyre 3967 anëtarë janë shqiptarë, si dhe 56 familje me 85 anëtarë janë minoritete. Gjatë këtij viti janë parashtruar 19 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 9 janë aprovuar kurse, 10 prej tyre janë refuzuar si familje, të cilat nuk

I kanë plotësuar kriteret. Ndërsa, janë riaktivizuar 4 familje.

Asistenca sociale i është ndërprerë 68 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuesë të asistencës sociale.

Në këtë periudhë raportuese kërkesa për ndihmë momentale janë 1, e cila nuk është aprovuar.

Gjatë kësaj periudhe në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 789 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 776 aplikues, janë refuzuar 13 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 0.

Gjatë kësaj periudhe 15 familje i kanë kthyer mjetet, pasi që janë refuzuar nga ATK dhe janë të obliguar t'i kthejnë mjetet. Kthimi i mjeteve bëhet për shumën e marrë të ndihmës sociale për një muaj, kurse janë dorëzuar për Gjykatë gjithsej 0 lëndë, të cilat nuk e kanë bërë kthimin e mjeteve.

Gjatë kësaj kohe të raportimit janë shpërndarë ndihma në pako për shfrytëzuesit e ndihmës sociale përkrahur nga organizata të ndryshme, si Organizata Relief Islamic që ka shpërndarë 300 pako ushqimore me mish, si dhe Ambasada e Shteteve Arabe 200 pako ushqimore dhe 30 familje me veshmbathje.

Gjatë kësaj kohe, në kuadër të projektit SAS janë realizuar 581 vizita në familje. Ku, prej tyre kanë përfituar ndihmë 126 familje, si dhe janë pranuar 22 ankesa.

Shërbimet Sociale

Në periudhën raportuese krahasuar me vitin paraprak numerikisht numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale. Të gjitha këto konkretizohen përmes shënimeve të mëtuajshme.

Vlenë të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 47 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 7 kanë arritur pajtim dhe 24 ndarje.

Nga këto familje janë 51 fëmijë, prej tyre 22 i janë besuar nënës në përkujdesje, 29 ndërsa ju janë besuar babait në përkujdesje.

Fëmijë pa kujdes prindor

Edhe në këtë periudhë QPS-ja detyrë prioritare ka pasur punën me fëmijët pa kujdes prindëror dhe në përgjithësi fëmijët nga familjet devijante. Është bërë evidentimi i këtyre fëmijëve, hapja e dosjeve dhe përpunimi profesional i kësaj kategorie deri në përfundim e sipër si punë permanente. Kemi pasur 1 fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar, kurse gjatë këtij viti kemi 2 fëmijë të braktisur, pra gjithsej 3 fëmijë, ku i janë ofruar këto shërbime. Pas qëndrimit në spital për një periudhë një muajore fëmijët janë regjistruar, ju është caktuar kujdestari ligjor; 1 rast i bartur nga viti i kaluar është adoptuar; 1 rast i braktisjes së këtij viti është vendosur në strehim familjar në komunitet deri në zgjidhje të statusit ligjor të tij, pastaj do të vazhdojmë me procedurat e adoptimit, 1 fëmijë pas qëndrimit disa ditë në spital dhe ofrimit të shërbimeve të nevojshme ka kaluar në bashkim familjar me nënën. Gjatë kësaj periudhe kemi 1 kërkesë nga Gjykata për vërtetim të atësisë.

Gjatë këtij viti i kemi pasur 16 kërkesa për kujdestari të veçantë, kemi caktuar kujdestar ligjor për 11 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake, gjithsej 23 kujdestari aktive. Strehim familjar 19 raste, 12 fëmijë janë në strehim familjar të afërmit dhe 7 fëmijë në strehim familjar në komunitet. Janë vizituar të gjitha rastet problematike, janë trajtuar në formën e duhur duke iu ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluese, e shërbime të tjera të nevojshme, DPSF na ka njoftuar përmes trajnimeve të organizuara me OJQ, OFAP sipas nevojave të kërkuara nga QPS mund të ofrohen

shërbime dhe trajtime në fushën e psikologjisë për fëmijët në strehim familjar të të afërmit dhe në komunitet. Poashtu, kemi asistuar në gjykatë dhe kemi dhënë mendim, raport për 1 rast, martesë e të miturve.

Pra, krahasuar me vitin paraprak në periodën raportuese janë zbatuar në masë më të madhe format e mbrojtjes sociale si, vënia nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindëror, 2 raste, 11 kujdestari për raste të veçanta, asistencë sociale si dhe shërbime të tjera të punës sociale. Ndihma në natyrë këtë vit krahasuar me atë paraprak ka qenë shumë e vogël me që është varur nga donatorët.

Të miturit me sjellje të çrregulluara dhe delikuent të mitur

Në këtë periudë kemi këtë gjendje 23 raste të delikuençës së të miturëve dhe 16 raste fëmijë në konflikt me ligjin, 7 raporte vlersuese rreth gjendjes sociale për fëmijë të cilët kanë bërë kundravajtje. Puntorët e shërbimeve sociale asistojnë në polici dhe gjykatë për rastet e të miturëve delikuent në përgjethësi. Për kategorinë e fëmijëve që bëjnë kundravajtje japin raport vlersues dhe propozues për masat ndëshkuese. Ndërsa për të miturit delikuent trajtimin dhe përpunimin e rasteve e bënë Shërbimi Sprovues të Kosovës, pra dhëjen e mendimeve gjykatave, ndërsa në i trajtojmë edhe më tutje në aspektin e mbikqyrjes. Në këtë drejtim me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtëpërdrejt me policinë, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjektet e tjera.

Veprat me të cilat karakterizohen të miturit me sjellje asociale janë bredhja, si rezultat i kësaj është prezente edhe trafikimi i vajzave të mitura. Ndërsa delikuenca e të miturëve karakterizohet më tepër me vepra penale, si vjedhje nga neni 135 LPK. Si dhe veprat prishje e rendit dhe qetësis publike, drejtim i automjetit pa patent shofer. Gjatë tretmanit psiko-social të këtyre fëmijëve dhe të miturëve Qendra ka vendos kontakte permanente me të miturit, familjet apo kujdestarët e tyre si dhe bashkëpunim me subjekte tjera si OJQ, shkollat etj. Puna ka qenë e përqëndruar në identifikimin gjegjësisht diagnostifikimin e rastit, hulumtimin e personalitetit të fëmijut, identifikimin e interesave të të miturit dhe harmonizimin me normat e përgjithshme morale dhe juridike, organizimi dhe racionalizimi i kohës së të miturëve, etj.

Viktimat e trafikimit dhe tentim dhunimit

Gjatë periodes raportuese kemi 2 raste tentim dhunimi të të miturës, të cilat janë trajtuar nga Instituti i Mjeksis Ligjore dhe janë referuar për trajtim psikologjik pas trajtimit viktimat janë rikthyer në familjen e tyre, dhe 1 rast ngacmimi seksual rasti është në procedurë. Në këtë vit nuk kemi raste të rriturave të cilat dyshohet për trafikim

Ekipi i shërbimeve sociale në këto raste përcjellë këto viktimat prej fillimit të hetuesisë në bashkëpunim me policinë, gjykatën, familjet dhe subjektet e tjera. Vlen të theksohet se nga QPS-ja në këtë vit janë ndihmuar rreth riintegrit 2 viktimat të trafikimit nga vitet paraprake këto viktimat të trafikimit kanë pasur edhe mbështetjen financiare me qëllim të rehabilitimit dhe reintegrimit të tyre. Pra puna kryesore ka qenë e fokusuar në risocializimin, kthimin e tyre në familje dhe të rikthimit në shkollim të rregullt. Në këtë drejtim nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me qendrën e shëndetit mendor, kemi pasur raste të trajtuar nga kjo qendër dhe mendojmë se ka pasur sukses në stabilizimin e tyre psiko-social.

Dhuna në familje

Gjatë periodes që po raportojmë ka pasur shtim të rasteve ku kemi 27 raste të raportimit të dhunës familjare, ndaj femrave dhe raste ndaj antarëve

të familjes, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e Qendrës për Punë Sociale duhet të jenë në gadishmëri dhe të ju ofrojnë asistim në polici, asistim në gjykatë, vendosje në strehim të përkohshëm, seanca konsultuese e këshilluese dhe bashkimin familjarë. Në këtë vit kemi 3 gra dhe 2 vajzë, e cila është vendosur në strehimoren Raba Voca Mitrovicë. Dhe 1 rast të mbartur nga vitet e kaluara e vendosur në Shtëpinë e Sigurt Gjakovë.

Janë dhënë 20 urdhra mbrojtje prej gjykatës për rastet e dhunës në familje, 3 raste kemi arritur ta pajtojmë, 14 ndarje, ndërsa rastet e tjera janë në procedurë. Punëtorëve të shërbimeve sociale ju mbetet të vazhdojnë me trajtimin e këtyre rasteve në vitin vijues.

Personat e moshuar

Sikurse edhe kategoritë tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periudë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 5 raste 4 në shtëpinë e pleqëve Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 2 kërkesa të reja, 2 kërkesa janë në procedurë për tu vendosur në shtëpi të pleqëve Prishtinë, dhe janë dhënë 9 raporte për bashkim familjar tek të afërmeve jashtë shtetit.

Kategori dhe shërbime tjera

Në Qendër për Punë Sociale ofrohen shërbime edhe për këto kategori janë dhënë:

Vertetime për lirim nga shtetësia e Kosovës 15

Vertetime për fitim të shtetësisë së Kosovës 78

Certifikata për zotësi të veprimtimit për punë dhe për ambajti 685,

Asistime në polici për fëmijët e mitur dhe raste të dhunës në familje 98,

Pjesëmarrje në seanca gjyqësore 156,

Vizita në familje 457,

Kontaktim prind fëmijë 348,

Seanca konsultime dhe këshillime 511

Bashkëpunim me Institucione 245

Konstatime Zyrtarë 27

Regjistrim i më vonshëm i fëmijëve 1 etj

Gjatë këtij viti janë mbajtur 4 komisione mjekësore për fëmijët me aftësi të kufizuar në muajin Shkurt, Maj, Shtator dhe Dhjetor kanë aplikuar 44 raste të reja, kemi pasur 2 ankese, 24 janë miratuar 2 plotësime dhe 10 janë refuzuar, 8 mangojnë.

Është punuar në bazë të shërbimeve sociale, bazën e strehimit familjar dhe bazë të fëmijëve me aftësi të kufizuar gjithsej 153 raste. Gjatë këtij viti është bërë lëshimi i një baze të re online për dhunën në familje.

Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, prandaj mbështetur në planin e punës së kryetarit të komunës, ka përgatitur Raportin e punës për periudhën Janar-Dhjetor 2026.

Drejtoria për Shërbime Publike bënë rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, bënë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjell largimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrë punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon me procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve dhe gjelbërimit të qytetit, mbikëqyrë dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, etj.

Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve pas shqyrtimit në nivel të Drejtorisë, janë dërguar në procedura të mëtutjeshme për vendosje, siç është Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës. Është konstatuar se nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për rregullimin e infrastrukturës dhe problemeve tjera komunale, janë shumë të mëdha por për shkak të buxhetit të limituar dhe gjendjes jo të mirë ekonomike të vetë komunitetit, zgjedhja e këtyre problemeve është e vështirësuar.

Furnizimi me ujë

Gjatë këtij viti kemi qenë të orientuar në vazhdimin e instalimit të pompave për furnizim me ujë të konomive familjare fshatrave Ropicë Vilanc Samadrexhë dhe fshatrat tjera në pjesën lindore të Komunës së Vushtrrisë. Gjithashtu kemi qenë të orientuar në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të kësaj fabrike si dhe krijimin e TASK FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes në mënyrë që të kemi furnizim më të rregullt me ujë. **Numri i projekteve apo punë të planifikuara për rrjetin e ujësjellësit në vitin 2025 ka qenë vazhdimi i kontratës tre vjeçare, i cili është finalizuar gjatë vitit 2025.**

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonomitë familjare sipas ASK-së, bizneset dhe institucionet që pranojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijes.

Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit po ashtu janë bërë investime të shumta sidomos në shtrirjen e rrjetit primar – kolektorëve kryesor në një numër të konsiderueshëm të fshatrave, duke implementuar kontratat për projekte dy vjeçare për vitet 2024-2025. Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet e planifikuara dhe të kontraktuara pra tri kontrata dy vjeçare **LOT 1, LOT 2 dhe LOT 3** për të cilat janë realizuar mjetet e planifikuara duke përfshirë nga **LOT 2** fshatrat Akrahticë – Balinc 2655 m, Shtitaricë 900 m, Stanoc i Poshtëm 1780 m, Reznik 2056 m, Mihalij 3315 m, Bruznik 1215 m dhe qytet rruga „Nimon Ferizi” 620 m, Zhilivodë 1655 m, Beqok 1270 m, Stroc 750 m, nga **LOT 3** fshatrat Duboc 1817 m, Galicë 171 m, Liqej 1585 m, Pantinë-Ashlan 1126 m, Bukosh 502 m, Smrekonicë 439 m, Kollë 605 m, Gllavotin 527 m, Gojbulë 679 m, Pasomë 2203 m, Pantinë lagja Shaqiri 918 m, dhe Pestovë 926 m. **Ndërsa në LOT 1** janë realizuar punë në fshatrat Dumnice e Poshtme 2760 m dhe një pjesë në Nadakoc – Studime 1900 m, fshatin Sfaragjak 4256 m dhe Maxhunaj 3200 m. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonomitë familjare sipas ASK-se. **Pra gjatë vitit 2025 kanë qenë të planifikuara gjithsej 26 aktivitete dhe janë realizuar 26.**

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së Drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen Përparimi.

Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, ka qenë i planifikuar aktiviteti për rishikimin e planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2022-2026 dhe është bërë ky aktivitet. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1600 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuara në qendrën për paketim në Bukosh. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale dhe aktualisht i kemi vetëm tri deponi të tilla. Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „Përparimi” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit.

Tashmë shërbimet bazike të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve konsiderohen të përmbushura si rezultat i implementimit të plotë të Planit Operativ.

Sipas Planit Operativ aktivitete të planifikuara për grumbullim, transportim dhe deponim të mbetjeve kanë qenë 365 dhe janë realizuar gjithsej 365.

Përveç përmbylljes së proceseve për shërbimet bazike, janë zhvilluar aktivitete për fillimin e procesit të ndarjes së mbeturinave në burim.

Edhe pse jemi ballafaquar me problemet e shkaktuara nga ngritjet enorme të konsumit ditor, kemi arritur që në raport me faturimin në vlerën 1 062 792 €, të bëjmë inkasimin e mjeteve në vlerën 598,243.09 € si dhe kemi bërë filtrimin e listave duke implementuar Vendimet paraprake të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për lirim nga pagesa të rasteve sociale si dhe filtrimin e listave në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe vlerësimit të komisionit për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Është ky viti i katërt prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale „Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e luleve dekorative, mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimit publik.

Gjithashtu përmes Ndërmarrjes komunale „Përparimi” është bërë mirëmbajtja e të gjitha hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së hapësirave publike në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës si dhe është bërë punë më e madhe në terren.

Gjithashtu Ndërmarrjes „Përparimi” i është kaluar në menaxhim i tërë procesi i grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2024 dhe gjithashtu është hartuar dhe dorëzuar në MAPL Raporti i Sistemit për Menaxhim të Performancës në ofrimin e shërbimeve komunale për vitin 2024.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonominë familjare, bizneset dhe institucionet që pranojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Në fushën e mirëmbajtjes së gjelbërimit me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si:

- Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ;
- Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit;
- Plani i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rrethojës, inventarit, gjelbërimit dhe drunjve në parqe;

- Plani i mirëmbajtjes së stazave dhe rrugicave në parqe;
- Është punuar edhe në planin e mirëmbajtjes së varrezave, në varreza të dëshmorëve, martirëve dhe atyre të qytetit

Gjithashtu është në realizim kontrata „Mobilari urban” me ç’rast janë përmbyllur ndërtimet e 20000 m² në fshatin Lumadh dhe rreth 1000 m², fshatin Vërnice, parku i qytetit, parku në qendër ish Sheshi i Lirisë, pra gjithsej sipërfaqja e parqeve dhe sheshe është 321272 m². Është bërë ndërtimi i shtëpisë së komunitetit në fshatin Oshlan dhe ndërtimi i parkut të banesat e bardha në vlerën prej 59,000.00 €.

Rikonstruim- rehabilitim i rrugëve të asfaltuara

Në kuadër të planit për rikonstruim - rehabilitim të rrugëve të asfaltuara është realizuar plani për riasfaltim përmes kontratës për riasfaltim të rrugëve në fshatin Dumnice e Poshtme – Dumnice e Epërme në vlerën prej 1,296,417.00 euro në gjatësinë L= 10600 m dhe gjerësinë b=5.4 m, si dhe riasfaltimi së bashku me ndërtimin e kanalizimit në rr. Dëshmorët e Kombit” në vlerë prej 643, 045.87 € në gjatësi prej 791 m dhe gjerësi b=16.5 m.

Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni

Në kuadër të projektit për ndërtimin e rrugëve me kubza betoni janë realizuar tri kontrata dhe janë investuar në LOT II 142,282.50 euro në rrugët „Salih Muzaqi”, segment i rr. „Bekim Berisha Abeja”, rr. „Nysret Zymberi” dy segmente, rr. „Demir Halili”, rr. „Kërçova”, rr. „Selim Ferati”, rr. „17 Shkurti”, rr. „Sefedin Morina”, segment dhe segment i rrugës „Azem Bejta”. dhe janë realizuar gjithsej 450 m në LOT 3 43000.00 euro në gjatësinë 480 m, si dhe në LOT I janë realizuar rr. „Asllan Xhemajli”, rr. „Mazhiqi” dhe rr. „Gostivari”.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar zgjerimi dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit të rrugëve në qytet dhe në fshatra si dhe ndriçimi i parqeve dhe shesheve sipas Marrëveshjes me Ndërmarrjen Publike Lokale „Përparimi” për vitin 2024.

Ndërtimi i trotuareve

Me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë për këmbësorët është duke u investuar në ndërtimin e trotuareve në 3 vendbanime në vlerën prej 40,000.00 € prej të cilave në fsh. Dobërlugë në gjatësinë 280 m, në fshatin Reznik në gjatësinë 470 m dhe në fshatin Stroc 315 m, Maxhunaj 280 m.

Ndërtimi i urave

Në kuadër të projektit për ndërtimin e urave janë investuar 35,470.50 euro dhe atë në fshatrat Karaq, Maxhunaj dhe Dobërlugë. Është bërë ndërtimi i vigave mbi lumin Silnica në fshatin Novolan dhe të shëtitorja në vlerën prej 81,700.00 euro.

Komunikacion

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Në fushën e transportit është hartuar Plani Komunal për Transport Lokal Publik të udhëtarëve 2024-2028 dhe gjithashtu në bashkëpunim me UN-Habitat-in është duke u hartuar Plani i Mobilitetit për Komunën e Vushtrrisë përmes së cilit synojmë të krijojmë një rrjet funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të lirë të biçikletave

Po ashtu janë menaxhuar kontratat për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale.

Në fushën e transportit publik në kuadër të aktiviteteve të planifikuara, është bërë organizimi i transportit të nxënësve brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë, është bërë përpilimi i rendeve të udhëtimit për operatorët e licensuar, fushata informuese dhe ka vazhduar mbajtja e rendit të udhëtimit nga Operatorët Ekonomik të cilët mbulojnë rreth 54 vendbanime.

Parkingjet publike

Hapësira për parkingje brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë të cilat janë në shërbim të qytetarëve janë 29 me gjithsej 1168 vend parkingje prej të cilave 22 hapësira posedojnë vende të rezervuara për persona me nevojë të veçanta. Ndërsa lokacioni i rezervuar për parkimin e mjeteve motorike TAKSI është 62.

Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjatë vitit 2025 fokus të posaçëm ka pasur hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024, kemi mbajtur një numer të madh takimesh me grupin punës të Planit Zhvillimor Komunal për mbajtjen e takimeve lidhur me diskutimet publike me qytetarët, grupet e interesit, kompanit publike

Po ashtu kemi mbajtur disa takime si ekip komunale në konsultim me kompanin Konsulente e cila është kontraktuar nga komuna për mbështetjen në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032 përmes prokurimit publik me të cilën edhe tani jemi në fazën e prezantimit të disa skenereve të këtij dokumenti të planifikimit PZHK-së së re 2024-2032.

Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e kanë përcjellë angazhime të shumta në shërbim të qytetarëve që kanë rezultuar me përfundimin dhe realizim të shumë projekteve kapitale përkatësisht ndërtimin e objekteve publike: shkollave, objekteve shëndetësore dhe projekteve tjera infrastrukturore.

-DUMM sa i përket planeve hapësinore ka vetëm Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024 i aprovuar me vendim nr.01/Nr.126/17 të dt.04.05.2017 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë për periudhën 2016-2024, i cili është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshin planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare

Gjatë periudhës Janar –Djetor 2025, DUMM ka zbatuar në përpikëri Planin Zhvillimor Komunal ku zyrtarët përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranura që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK-lë) 2016-2024.

Sektori i Urbanizmit –gjatë periudhës janar-dhjetor për vitin 2025 është marr me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me caktim të lokacioneve, Kushtet e Ndërtimit, Lejeve Ndërtimore për kategorinë I dhe II, Pëlqimeve Paraprake, Lejeve për rrënimin e objekteve, Leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese duke kaluar nëpërmes procesit të daljes në teren dhe incizimit të gjendjes faktike në terren ku përmes sektorit për planifikim urban e ka vazhduar procesin e mëtutjeshëm për finalizim si dhe punë të tjera në komisione siç janë: Shfrytëzime të hapësirave publike para lokaleve etj.

Legalizimi- Gjatë këtij viti kemi pranuar 99 kërkesa të parashtruara nga palët për legalizimin e objekteve për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimit,

Duke parë volumin e madh të punëve në drejtori si dhe mungesën e stafit, shpresojmë që ta rrisim stafin e kësaj drejtorie.

Pranimi i kërkesave për legalizim regjistrimi sistemimi, shqyrtimi i kërkesave përgatitja e faturave ,vendimmarrja , dërgimi i lëndëve në Kadastër për regjistrimin e objekteve të legalizuara në RDPP.

• Vendime për legalizim.....	76
• Vendime për Listën e Pritjes.....	27
• Dërgesë dokumentacioni – dorëzim palës.....	23
• Dërgimi i dosjeve të legalizimit në Kadastër.....	76
• Kërkesat e reja të pranura.....	99

Të gjitha kërkesat e pranura për legalizim gjatë vitit 2025 (99) janë trajtuar:

-39 kërkesa janë vendos me Vendime për Dhënie e Certifikatës Për Legalizim dhe 7 kërkesa janë vendos në Listën e Pritjes.

Kërkesa tjera janë në procedurë është bërë shqyrtimi i të gjithave, përgatitja e njoftimeve për plotësime të lëndëve, ju kanë dërgua palëve, varësisht nga plotësimi i kërkesave nga pala bëhet edhe vendosje e tyre.

Si dhe janë duke u trajtuar edhe kërkesat tjera të pranura nga vitetë paraprake .

Taksat e inkasuara për Legalizimin e objekteve pa leje përfshinë vlerën: 70983,35€

Kërkesat për Kushte Ndërtimore (72 kërkesa)

- 28 kërkesa janë përfunduar me Vendime për Kushte Ndërtimore të Kategorisë I,
- 35 kërkesa janë përfunduar me Vendime për Kushte Ndërtimore të Kategorisë II,
- 8 kërkesa janë hedhur poshtë,
- 3 kërkesa janë ende në procedurë shqyrtimi.

Lejet ndërtimore:

- kërkesat për vitin 2025

- 81 kërkesa për Leje Ndërtimore,
- 72 kërkesa për Kushte Ndërtimore,
- 9 kërkesa për Leje Rrërimi.

Këto kërkesa përfshijnë objekte të kategorisë I dhe II, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si në vijim:

- Objekte të Kategorisë I – objekte individuale banimi, anekse të objekteve, Depove, Shtalla, objekte ndihmëse dhe ndërhyrje të vogla ndërtimore;

Objekte të Kategorisë II – objekte kolektive banimi, objekte afarisie, objekte industriale dhe zhvillime me ndikim më të gjerë urbanistik.

Kërkesat për Leje Ndërtimore (81 kërkesa)

Prej numrit të përgjithshëm të kërkesave për leje ndërtimore:

- Në 63 kërkesa janë nxjerrë vendime për Leje Ndërtimore, prej të cilave:
- 29 vendime për Leje Ndërtimore i përkasin Kategorisë I,
- 34 vendime për Leje Ndërtimore i përkasin Kategorisë II.
- 2 kërkesa janë refuzuar me vendim,
- 1 kërkesë është hedhur poshtë,

15 kërkesa janë ende në procedurë, për shkak se aplikuesit nuk kanë kompletuar dokumentacionin dhe projektin teknik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi

Kërkesat për Leje Rrërimi (9 kërkesa)

- 7 kërkesa janë përfunduar me Vendim për Leje Rrërimi,
- 2 kërkesa janë hedhur poshtë me vendim.

Gjithashtu, e gjithë lista e Lejeve Ndërtimore, me të gjitha specifikat dhe të dhënat përkatëse, është e publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë, në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe informimit publik

Taksat e inkasuara për Leje Ndërtimore dhe Leje rrenimi përfshinë në vlerën: **1.169795,88€ Sistemi i Adresave-** Republika e Kosovës e cila është në tranzicion, gjithnjë është në hulumtim të mundësive më të mira për zbatimin e projekteve të rëndësishme të madhe për lehtësimin e jetesës së qytetarëve dhe për zhvillimin e bizneseve në tërësi kështu që Bashkësia Evropiane ka krijuar një qasje të veçantë financiare për krijimin e sistemit të adresave në Kosovë. Ky projekt u zbatua nëpërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe mirëmbahet në mënyrë sistematike nga zyra urbanistike e komunës

Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit uniform të adresave është një nga shërbimet më të rëndësishme që pushteti vendor dhe qendror i siguron qytetarëve të Kosovës. Sistemi unik, i saktë dhe i qëndrueshëm i adresave i bën qytetarët më të përgjegjshëm për zbatimin e ligjit, e përmirëson shërbimin ndaj qytetarëve në shërbimet publike e private por edhe në raste emergjencash të operojnë efektivisht.

Spektori për planifikim urban – gjatë kësaj periudhe një vjeçare është bërë sistematizimi i lendeve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, , zgjidhje dhe përgjigje të kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në teren-mbikqyrja e projekteve , monitorimi dhe aprovimi për Kushte

dhe leje Ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, Takimet me grupet punuese dhe UN-Habitat-in .

Gjatë kësaj periudhe sektori për planifikim ka kryer këto punë:

Ka bërë kordinim profesional dhe ligjor brenda drejtorisë.

Kordinimi lidhur me hartimin e PZHK.

Ka bërë kordinim me Drejtorin e Kadastrit dhe të tjera.

Kemi bërë detyra projektuse për hartimin e projekteve të ndryshme.

Kemi bërë skica për disa projekte ma specifike.

Kemi kryer punë sipas Vendimeve të Drejtorit dhe Kryetarit.

Takime me Kompanin Konsulente e cila është duke na mbështetur për hartimin e PZHK 2024-2032

Sa i përket Investimeve kapitale, jemi duke i realizuar punimet sipas projekteve të parapara për realizim

-Asfaltimi i rrugëve në qytet;

-Asfaltimi i rrugëve në fshatra;

- Rikonstruimi i Sheshit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit;

-Asfaltimi i rrugës Bekim Berisha Abeja;

Mbrojtje e mjedisit

Bazuar në Planin e punës e cila ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, ju njoftojmë se bazuar në investimet kapitale për këtë vit komuna ka realizuar projektet që ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit siç janë projekte për gjelbërim, pastrimi i rrugëve, mbikëqyrja dhe përkujdesja e parqeve në pjesë të ndryshme të qytetit ku janë të përfshira edhe sektorët nga Drejtoritë përkatëse siç është Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Po ashtu janë kryer edhe punë tjera të ndryshme që kanë qenë të nevojshme për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtës së Mjedisit si:

- Menaxhimi i kontratës për mbjelljen e drunjëve dekorativ
- Përgatitja e dokumenteve për Planin Zhvillimor Komunal nga sektori për Mbrojtjen e Mjedisit,

Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale kemi shqyrtuar kërkesa të palëve kemi lëshuar Leje Mjedisore Komunale .

Taksat e inkasuara për Leje Mjedisore Komunale - vlera: 138.828,14€

Përfundim

Drejtoria ballafaqohet me një numër mjaft të vogël të stafit e cila e po na sjell vështësi në zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësi të përkatësisht në sektorin e Urbanizmit.

DUMM gjatë punës në këtë vit ka qenë i ngarkuar me mjaftë punë të cilat besojmë që i kemi kryer me sukses, edhe për kunder numrit shumë të vogël të stafit që ka pas kjo drejtori.

Duhet të theksojmë se mbështetja që na është bërë nga Kryetari i Komunës por edhe nga Kuvendi i Komunës në planin dhe projektet e Drejtorisë sonë, vazhdon të jetë motiv shtesë për gjithë zyrtarët e DUMM që detyrat tona ti kryejmë me sukses.

Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Punët që janë kryer

1. Regjistrimi i pronave të patundshme
 2. Aktvendimet për korrigjimin e regjistrit sa i përket emrit dhe mbiemrit të pronarëve,
 3. Aktvendimet për regjistrimin e hipotekave,
 4. Aktvendimet për çregjistrimin e hipotekave,
 5. Lëshon vërtetime dhe certifikata të ndryshme,
 6. Copëtimin – ndarjen dhe bashkimin e ngastrave kadastrale,
 7. Incizimi i gjendjes faktike,
 8. Identifikimi – përkufizimi i patundshmërive,
 9. Ekspertizat Gjyqësore,
 10. Lëshon kopjet e planeve,
 11. Lëshon listat – certifikatat e patundshmërive (fleta poseduese),
 12. Zgjidhjen e kërkesave zyrtare të Institucioneve të ndryshme, Ndërmarrjeve, Organizatave Qeveritare dhe joqeveritare,
 13. Kontrollon dhe korrigjon operatin kadastral dhe hartat kadastrale,
 14. Kryen punët në teren nga veprimtaria e vet si dhe në rastet kur është e autorizuar me Ligj,
 15. Vendosi dhe mirëmban shenjat gjeodezike të ndarjeve të patundshmërive,
 16. Me kërkesën e AKK-së, ndërmerri veprime dhe aktivitete që kërkohen nga AKK-ja, dërgimi i shënimeve, informatave dhe dokumentacionit i cili kërkohet.
 17. Punët tjera nga kompetenca e vet të parapara me Ligj, Urdhëresa administrative dhe akte tjera nënligjore.
- Në bazë të organogramit të Kuvendit të Komunës për vitin 2025, për organizimin e administratës së komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë, është e organizuar në tre sektor: Sektori për Gjeodezi, Sektori për Kadastër dhe Sektori për Pronë.

Gjatë periudhës 01.01.2025-31.12.2025, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Nr. Rend.	LENDET E ARRITURA Janar- dhjetor 2024	Gjithsejtë
1.	KERKESAT E ARRITURA	9206
2.	AKTVENDIME PER BARTJE TE PRONES	2106
3.	AKTV. PER PERMIRRESIM TE EMRAVE NE RDPP	301
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	137
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	90
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA TE NDRYSHME	311
7.	NDARJE DHE BASHKIM TE PARCELAVE	558
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	61
9.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E BARRES TATIMORE	24
10.	KOPJE TE PLANIT	912
11.	LISTA POSEDUESE	4620
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	201
13.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E MASES SE SIGURISE	16
14.	LENDET NE PROCEDURE	61
15.	Kërkesa tjera(identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	206

Në periudhën Janar-dhjetor 2025 kemi pranuar 2045 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka marr 2045 aktvendime me të cilat janë miratuar ose refuzuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje për vitin 2026 kanë mbetur 61 kërkesa (lëndë).

Kemi pranuar nga ana e palëve – qytetarëve 301 kërkesa për korrigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar 295 kërkesa të tilla ndërsa 6 prej tyre janë refuzuar. Këto kërkesa në lidhje me korrigjimin e emrit apo të mbiemrit bëhen pa pagesë.

Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe prone në periudhën janar-dhjetor 2025 ka pranuar 137 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe 90 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik. Pas zhvillimit të procedurës kemi marr 137 aktvendime për regjistrimin e hipotekave dhe 90 aktvendime për çregjistrimin e hipotekave.

Për nevoja të përfituesve të ndihmës sociale janë lëshuar 985 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 380 certifikata pronësore. Pasi që përfituesit e ndihmës sociale janë të liruar nga pagesa për shërbime të tilla nga këto shërbime nuk janë inkasuar mjete financiare. Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar 4620 certifikata pronësore dhe 912 kopje të planit. Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar tri procedura të shpronësimit të pronës së paluajtshme për interes publik, ndërsa kemi zhvilluar tri procedura administrative lidhur me lirimin e pronës komunale në rrugët Bekim Berisha, Lumni Surdulli dhe rruga Drenica.. Gjithsejtë të hyrat buxhetore për vitin 2024 nga drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë 139,116.30 euro. Pranë kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

MENAXHIMI I PRONËS KOMUNALE

Sa i përket menaxhimit të pronës komunale është hartuar raport i veçantë që do të paraqitet në mbledhje të kuvendit.

PUNET E KRYERA PËR NEVOJA TË KOMUNËS

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevojat të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)

Për kundër punëve dhe detyrave të punës të kryera në këtë vit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ballafaqohet me një seri problemesh të natyrës objektive dhe subjektive si:

Mungesa e Elaborateve kadastrale, të cilat janë plaçkitur nga okupatori serb në vitin 1999,

Problemet e trashëguara të natyrës pasurore-juridike si uzurpimet, kontestet e bartura nga komasacioni etj.

Mungesa e stafit na ka sjellë problem në menaxhimin kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, lirimi i pronës komunale nga uzurpimet dhe në përgjithësi në menaxhimin e pronës komunale.

Kulturë Rini Sport

Sa i përket mbarëvajtjes së punëve në këtë periudhë kohore, jemi munduar që të bëjmë më së miri punën që është kërkuar nga ana jonë. Janë zhvilluar aktivitete të shumta nga kjo drejtori. Janë subvencionuar OJQ të ndryshme klube sportive, shoqata, janë organizuar dhe subvencionuar aktivitete kulturore, botim të librave, janë mbajtur edhe konferenca shkencore, tryeza të ndryshme etj. Për të gjitha këto janë dhënë mjete financiare nga subvencionet dhe transferet në shumë prej 100,672.00 €.

Në vazhdim paraqesim të dhëna mbi punën vjetore sipas sektorëve të DKRS-së:

QENDRA E KULTURËS "HASAN PRISHTINA"

Bazuar në Planin e Punës për vitin 2025, në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" punët kanë rrjedhë sipas planit, duke realizuar në tërësi planin e punës, por duke e plotësuar atë edhe me aktivitete të reja shtesë, të cilat ndonjëse nuk janë paraparë në planin e punës, kanë dalë si rezultat i ideve të reja të stafit të drejtorisë sonë, apo edhe qytetarëve që janë marrë me aktivitete kulturore, por edhe institucionet tjera me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë këtij viti.

Në aktivitetet e zakonshme që i organizojmë si drejtori, por edhe aktivitet tjera të organizuara qoftë nga Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Diasporës apo edhe sektorët e tjerë përbrenda DKRS-së ne kemi qenë të angazhuar në mbarëvajtjen e atyre organizimeve, qoftë në mbështetje teknike me mjete të zërimit apo edhe mjete tjera teknike.

Ndër aktivitetet kulturore që kemi organizuar apo që kemi marrë pjesë në organizim veçojmë:

Akademi Solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;

Organizimi i aktiviteteve për Epopenë e UÇK-së "Nata e zjarreve" me ushtarë të UÇK-së në fshatin Stroc;

Përrurimi i librit: "Përballja e arsimit në Vushtrri me dhunën gjatë viteve të okupimit 1990-2000 të autorëve Beqir Xhema e Jakup Krasniqi;

Përrurimi i librit "Behram Rrahmani – Trim i lirisë" të autores Remzije Zekolli.
 Përrurimi i librit "Malli i mërgimtarit" të autores Ferdane Pllana Zabërgja;
 Akademi Përkujtimore "Studimja '99", 2 maj 2025;
 Akademi Përkujtimore për nder të përkujtimit të masakrës së 22 Majit në Vushtri;
 Akademi Përkujtimore për Masakrën mbi Familjes Gërxhaliu, 31 maj 2025;
 Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të Ditës së Fëmijëve – 1 Qershor 2025;
 Përrurimi i librit me tri vëllime "Vushtrria dekdën e ndryshimeve historike 1990-1992" të autorit Gani Lahu;
 Përrurimi i librit, "Musa Hajrizi - Heroizëm i një luftëtari", të autorit Mentor Hajrizi
 Akademi Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë – 17 qershor 2025;
 Ceremonia e diplomimit të gjimnazistëve vushtrrias;
 Organizimi i Festivalit "Zëbyllyat e Vicianës";
 Akademisë Solemne për Ditën e Pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt 2025;
 Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë më 17 Qershor 2025.
 "Ditët e mërgimtarëve" – aktivitet me mërgimtarë në fshatin Skromë, 2 gusht 2025;
 Zbulimi i shtatores së dëshmorit të kombit Avni Saraçi në Vushtri, 21 gusht 2025;
 Dita e Dëshmorëve të Kombit të Komunës së Vushtrrisë;
 Zbulimi i Lapidarit të Dëshmorëve të Kombit të Batalionit të Parë të Brigadës 142 të ZOSH të UÇK-së në fshatin Gallavatin, 1 shtator 2025;

 Përrurimi i librit të "Probleme aktuale të drejtshkrimit të gjuhës shqipe" të autorit Ferki Perçuku;
 Akademi Solemne dhe film dokumentar në përkujtim të Dr. Safet Idrizit;
 Aktivitet përkujtimor për Dëshmorët Bektesh Haliti, Hamdi Hajrizi dhe Nezir Imer në Stroc, 6 nëntor 2025;
 Festivali Mbarëkombëtar i Poezisë "Takimet e Poeteshave Shqiptare", 21 -23 nëntor 2025
 Ekspozitë e OIQ "L'art Youth Gallery" e quajtur "Ndjenja" 21 nëntor 2025;
 Dita e Flamurit Kombëtar – 28 nëntor 2025

Mbështetja e të gjitha shkollave dhe kopshteve që janë drejtuar për organizimet e fund vitit shkollor, kryesisht festimi i përmbylljes së ciklit parashkollor, përmbylljes së klasës së parë apo Ditës së Abetares dhe klasat e pesta, organizimi i shfaqjeve të ndryshme të organizuara nga ana e shkollave si dhe mbështetja në përrurimin e librave të ndryshëm që por edhe të aktiviteteve tjera që janë organizuar nën patronazhin e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë. Janë organizuar akademi të ndryshme përkujtimore jo vetëm për dëshmorët por edhe për personalitete të ndryshme të arsimit, kulturës dhe të luftës së UÇK-së, kryesisht veteranë të luftës çlirimtare.
 Varësisht prej kërkesave është lejuar shfrytëzimi i sallës së Qendrës së Kulturës në bazë të rregullores komunale për tarifa, qoftë për Partitë politike apo edhe për rastë tjera.
 Drejtori i QK "Hasan Prishtina" ka qenë edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim të botimeve dhe publikimeve, ku janë mbështetur dhjetëra botime të reja të autorëve vushtrrias, por edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave të tjera për subvencionim, të cilat nuk kalojnë shumën mbi 500 euro, bazuar në rregulloren e MF për ndarjen e subvencioneve, si dhe në komisione tjera për vlerësim të projekteve të DKRS-së.

Njëkohësisht drejtor i QK "Hasan Prishtina" është edhe menaxher i Kontratës për shërbime të transportit të udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit si dhe menaxher i kontratës për shërbime konsulentë në fushën e kulturës.

BIBLIOTEKA "NAIM FRASHËRI"

Në fillim, ju njoftoj se deri nga 14 maji 2024 e deri më 7 janar 2026, kam qenë drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rinë e Sport. Me datën 8 janar 2026, jam rikthyer përsëri në vendin tim të punës: Udhëheqës i sektorit të bibliotekës "Naim Frashëri".

Prandaj, këtë raport që po ua përcjell, e kanë përgatitur stafi i bibliotekës, përkatësisht Sami Bislmi (përgjegjës i bibliotekës deri sa jam kthyer unë) dhe Florina Krasniqi, bibliotekiste.

Gjatë këtij viti biblioteka ka pranuar 492 tituj të ri dhe 4406 ekzemplarë.

Libra në sektorin për të rritur dhe shkencor janë 35.000 ndërsa në sektorin për fëmijë janë 12.000. Gjithsej 47.000 libra në gjithë bibliotekën.

Gjatë vitit 2025, librat më të kërkuara për lexim ishin:

-**Sektori për fëmijë:** "Lutjet e mbrëmjes" i Anton Pashkut, "Kalamajtë e pallatit tim" i Bedri Dedja, "Tregime të moçme shqiptare" i Mitrush Kurtelit, "Albumi" i Fan S. Nolit, "Verorja" i Rexhep Hoxhës, "Lulet e verës" i Naim Frashëri, "Shpella e piratëve" i Petro Markos, "Princi dhe i varfëri" i Mark Tuein, "Sarajet e bardha" i Vehbi Kikaj, "Trimi i mirë me shokë shumë" i Sylejman Pitarkës.

-**Sektori për të rritur:** "Hamleti" i Shekspirit, "Historia e Skenderbeut" i Marin Barleti, "Dr. Gjilpëra" i Faik Konicës, "Kështjella" i Ismail Kadare, "Kush e solli Doruntinën", i Ismail Kadare, "Pse?" i Sterjo Spasse, "Qyteti i fundit" i Petro Marko, "Koprraci" i Moliere, "Shqipëria ç'ishte, që është, çdo bëhet" i Sami Frashërit, "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxa.

- **Librat Shkencor më të kërkuar:** "E drejta romake" Bedri Bahtiri, "Komedi hyjnore" Dante Aligeri dhe "Historia e Skënderbeut" i Marin Barletit, "Viciani – Vushtrria I" i Izet Miftarit.

- Në sektorin për fëmijë, gjatë kësaj periudhe janë dhënë për lexim 4371 libra.
- Në sektorin e të rriturve, gjatë kësaj periudhe janë dhënë për lexim 2551 libra.
- Sallën e leximit e shfrytëzuan 1060 lexues.
- Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 260 lexues të ri, për fëmijë 203 lexues, për të rritur 59.

Gjatë periudhës 03 janar deri më 31 dhjetor 2025 janë përpunuar gjithsej 700 libra, janë inventarizuar 700 libra, janë signuar 1400 libra, janë vendos etiketa në 700 libra, janë vulos 2100 libra.

Aktivitetet:

Tryezë shkencore kombëtare me temë: "Udhërrëfyesit emblematicë të UÇK – 28 vjet nga rënia e Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut. Kjo Tryezë është mbajtur në bashkëpunim me Departamentin e Historisë në vigjilje të përvjetorit të 18 të Pavarësisë së Kosovës.

Stafi i bibliotekës ka qenë e angazhuar çdo herë në aktivitete kulturo-artistike që i organizon DKRS-ja.

Libra të dhuruara bibliotekës:

- 5 ekzemplarë të librit "Femra shqiptare - Roli dhe sakrificë për atdhe" e autore Ymrije Beqiri;
- 8 ekzemplarë të librit "Unë" të autorit Xheladin Dedja;
- 2 ekzemplarë të librit "Trimi i lirisë Behram Rrahmani" Monografi të autore Ramzije Zekolli;
- 3 ekzemplarë të librit "Malli i mërgimtarit" të autore Ferdane Pllana Zabërgja;
- 6 ekzemplarë të librave "Vushtrria në dekadën e ndryshimeve historike kronike ngjarjesh në periudhën 1990-1992"; Vëllimi i parë, i dytë dhe i tretë të autorit Gani Lahu;
- 2 ekzemplarë të librit "Pedagogjizimi, kjo polifoni edukative" të autoreve Aferdita Deva-Zuna, Valentina Nimona-Hoti;
- SHFMU-Lummadh, 15 libra për fëmijë, me tituj të ndryshëm.
- Agim Desku nga Peja dhuroi 27 libra me tituj të ndryshëm;
- Poeti nga Amerika z. Ramiz Mujaj i dhuroi bibliotekës 3 libra autor i të cilëve është vetë dhuruesi;
- Poeti Hamit Gurguri nga Suedia, 5 libra me tituj të ndryshëm autor i të cilëve është vetë dhuruesi;
- Drejtoresha e Institutit të Historisë 'Ali Hadri' znj. Teuta Shala Peli, 12 libra shkencor;
- Nxënësit e klasës së III/3, 14 libra me tituj të ndryshëm;
- Enver Sahiti 5 libra, Zymer Mehani, 33 libra me tituj të ndryshëm dhe Armend Xhoni 3 libra.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 3000 libra shkencor me tituj të ndryshëm;
- Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", 897 ekzemplarë prej të cilëve 78 tituj.
- Tre (3) ekzemplarë nga libri : "Jehudinjtë në Suren Elbekarah", autori Prof. Emin Behrami;
- Pesë (5) ekzemplarë nga libri : "Opinione dhe gacime", autori të cilave është vetë dhuruesi;
- Autorët Jakup Krasniqi dhe Beqir Xhema, 3 ekzemplarë të librit "Përballja e arsimit në Vushtri me dhunën gjatë viteve të okupimit 1990-2000;
- Drejtori Alban Tahiraj i dhuroi bibliotekës dy pjesë të fjalorit "Fjalori i sotëm i Gjuhës Shqipe A-ZH"
- Gjatë muajit shtator kemi pranuar 5 tituj të ri me gjithsej 13 ekzemplarë.
- Autori Jakup Krasniqi i dhuroi bibliotekës 2 ekzemplarë të librit "Bunjakët".
- Bedri Tahiri, "Flakadani i Lirisë-Mustafë Shyti", 5 ekzemplarë;
- Bedri Tahiri, "Xhemë Tërnafe" 5 ekzemplarë;
- Hazir Mehmeti, "Tehe Nate" 2 ekzemplarë;
- Hazir Mehmeti, "Aktivitete Letrare në Austri" 2 ekzemplarë;
- Emin Behrami, "Tefsiri-Komentimi i përshtatshëm i kuptimeve të Kuranit fisnik në gjuhën shqipe" 2 ekzemplarë.
- Mentor Hajrizi, "Musa Hajrizi" Heroizëm i një luftëtari.
- Mazlum Baraliu, 5 tituj me gjithsej 10 ekzemplarë.
- Avdi Rashica "Trungu Gjenezologjik i Rashiceve të fshatit Studime e Poshtme, Vushtri dhe vëllezërve tonë që jetojnë në Republikën e Turqisë".

Vizita bibliotekës

- Me datë 21.02.2025, bibliotekën e qytetit e vizituan fëmijët e IP "Foleja", dy grupe të parashkollorëve së bashku me edukatorët e tyre.
- Vizitë në bibliotekë, tri paralele të nxënësve të klasave të teta të SHMU/2 bashkë me arsimtarin e tyre;
- Gjashtë paralele të SHF "Mustafë Venhari" Vushtrri, klasat e treta;
- Një paralele e SHF "Naim Frashëri" Vushtrri;
- Poeti nga Suedia Hamit Gurguri
- Bibliotekën e qytetit e vizituan poet e artist nga vende të ndryshme të Kosovës por edhe nga diaspora, nga Amerika; Agim Desku poet, Ramiz Mujaj poet, Ramiz Qorraj, Sadri Ymeri dhe Qerkin Ibishi.
- IP "Foleja" dy grupe parashkollore, IP "Nur" kopsht privat, një grup dhe SHFMU Lummadh, katër paralele.
- Në maj bibliotekën e qytetit e vizituan katër paralele të klasave të katërta të SHF "Naim Frashëri" Vushtrri;
- 80 nxënës të klasës së tretë nga SHFMU "Andon Zako Çajupi" – Vushtrri.
- SHMU-2 me gjithsej 74 nxënës të përzgjedhur nga mësueset e tyre nga klasa e gjashtë dhe nga klasa e shtatë.
- Shkollën "Latif Berisha" nga fshati Dobërrluk. Gjithsej ishin 100 nxënës nga klasa e I-V-tën.

Aktivitetet tjera

- Përkurimi i librit "Femra shqiptare- Roli dhe sakrificat për atdhe" të autores Ymrije Beqiri;
- Përkurimi i librit "Trimi i lirisë Behram Rrahmani – Monografi i autores Remzije Zekolli;
- Është shënuar 23 Prilli - Dita Botërore e Librit për Fëmijë, me që rast ishte mbajtur debat me shkrimtarët Zymer Mehani, Enver Sahiti, Fatmir Çitaku, Sadriu Rexhepi, Teuta Kadriu dhe Ymrije Beqiri. Në këtë debat kanë qenë dhjetëra nxënës të SHFMU Lummadh, katër paralele dhe me parashkollorët e IP Folje, dy grupe, tema "Rëndësia e librit".
- Me datë 23 Prilli 2025 biblioteka e qytetit organizoi program për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Librit. Ishin mbajtur aktivitetet të ndryshëm kulturore
- Me datë 10.03.2025, Organizata Bashkëveprimi, Sharjah Charity Internacional ka dhuruar një aparat të ujit për sallën e leximit, donacion nga UAE, AID.

MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

- Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, Muzeu ka realizuar aktivitete të rregullta administrative dhe profesionale, përfshirë:
- Përgatitja e planit të aktiviteteve për vitin 2025.
- Hartimin dhe dorëzimin e raporteve javore dhe gjashtëmujorë për aktivitetet dhe punët e kryera;
- Përpilimi dhe dorëzimi i propozim-projekteve për funksionalizimin dhe plotësimin e nevojave të Muzeut të Vushtrrisë për vitin 2026, të cilat u janë përcjellë Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Në kushtet e punës hulumtuese në terren janë identifikuar dhjetëra e qindra eksponate të ndryshme, të cilat ishin kryesisht nga fusha e etnologjisë të punuara me motive gjeometrike dhe florale, por edhe nga fusha e arkeologjisë, historisë dhe folklorit.

- Gjatë kësaj periudhe, Muzeu i Vushtrrisë është pasuruar me mbi 250 eksponate nga materiale të ndryshme, të dhuruara nga familje të ndryshme të komunës së Vushtrrisë. Dhurimet më të mëdha u realizuan në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të themelimit të Muzeut të Vushtrrisë. Këto dhurime kanë një rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore dhe për zhvillimin e mëtejshëm të fondit muzeal.
- Sektori i fototekës në Muzeun e Vushtrrisë është pasuruar me 320 fotografi të vjetra familjare, të cilat dokumentojnë jetën dhe traditat e familjeve të qytetit dhe rrethit të Vushtrrisë. Fotografitë e mbledhura ishin të realizuara kryesisht në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, dhe përbëjnë një pasuri të çmuar vizuale dhe historike për fondin muzeal.
- Biblioteka e Muzeut të Vushtrrisë e cila posedon rreth 500 libra, kryesisht me përmbajtje shkencore nga fusha të ndryshme të trashëgimisë kulturore, historisë, etnologjisë dhe arkeologjisë, gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të studentëve dhe lexuesve të interesuar, duke u ofruar literaturë relevante dhe materiale ndihmëse për realizimin e detyrave studimore dhe punimeve shkencore.
- Në muze u inventarizuan gjithsejtë 153 eksponate nga kultura materiale:
 - 93 - nga fusha e etnologjisë;
 - 38 - nga fusha e arkeologjisë;
 - 22 - nga fusha e teknologjisë
- Stafi i sektorit të Muzeut ishte pjesë edhe e aktiviteteve të shumta kalendarike të organizuara në kuadër të DKRS-së.
- Gjatë vitit 2025, Muzeu i Vushtrrisë ka organizuar një sërë aktiviteteve me fokus në promovimin, edukimin dhe vetëdijesimin e gjeneratave të reja, përmes komunikimit muzeor dhe përfshirjes së tyre aktive në procesin e njohjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.
- Si çdo herë, stafi i muzeut i ka kushtuar rëndësi të veçantë nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, përmes organizimit të vizitave edukative dhe mësimore në Muzeun e Vushtrrisë, në monumentin "Mahmut Agë Gjinolli", si dhe në monumentet tjera të trashëgimisë kulturore në qytetin e Vushtrrisë.

Disa nga aktivitetet e realizuara përfshijnë:

- Ekspozita "Vushtrria e Vjetër"
- Dita Ndërkombëtare e Guidave Turistike
- Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit – Kosova 2025
- Dita Ndërkombëtare e Muzeve
- Trajnim për të rinjtë në fushën e fotografisë digjitale
- Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore
- Festa e Flamurit Kombëtar – 28 Nëntori

SEKTORI I SPORTIT

Më datë **25.07.2025** është organizua turneu në basketboll (Streetball), ku kanë marrë pjesë katër ekipe. Në komunën tonë janë të regjistruara (32 klube, shoqata).

Lista e sukseseve të arritura:

1. KLUBI HENBOLLIT "SAMADREXHA" (F) ka garuar në Superligë, dhe ka arritur të jetë në vendin e parë ku janë nënkampion vjeshtor, të drejtë përfaqësimi në arenën ndërkombëtare.
2. KLUBI FUTBOLLIT "VUSHTRRIA" ka humbur mundësin që të bëhet anëtar i superligës për këtë sezon dhe prapë ka mbet në Ligën së Parë të Futbollit.
3. KLUBI HENBOLLIT "VUSHTRRIA" (M) ka garuar në Supeligë dhe ka arritur që të ruaj këtë statut për sezonin 2024/2025.
4. KLUBI HENBOLLIT "VUSHTRRIA" (F) është tërhequr nga superliga dhe garat i ka vazhduar në ligen e parë.
5. KLUBI BASKETBOLLIT "VUSHTRRIA" (M) ka garuar në Ligën e Parë, dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë.
6. KLUBI BASKETBOLLIT "VUSHTRRIA BASKET" (F) ka garuar në Ligën e Parë dhe ka arritur që të ruaj këtë.
7. KLUBI VOLEJBOLLIT "ASVUSHTRRIA" (M) ka garuar në Superligë B, dhe ka arritur që të ruaj këtë statut, në edicionin garues 2024/2025
8. KLUBI VOLEJBOLLIT "AS VUSHTRRIA" (F) ka garua Liga e Parë, dhe ka arritur që të ruaj këtë statut, për sezonin 2024/2025.
9. KLUBI VOLEJBOLLIT "VUSHTRRIA" (F) ka garuar në Superligë, dhe ka ruajtur statutin në këtë ligë.

KLUBET E KATEGORIVE TË REJA:

1. KLUBI FUTBOLLIT " VUSHTRRIA " Kampion U 18 , Liga Regjionale.
 2. KLUBI FUTBOLLIT " VUSHTRRIA" Kampion U 17 , Liga Regjionale.
 3. KLUBI FUTBOLLIT "EL CLASICO " Fitues i Kupës U 17 , Liga Regjionale
 4. KLUBI I HENDBOLLIT FMERAT SAMADREXHA - Kampion me U18
 5. KLUBI FUTBOLLIT " FORCA " Vendi I Dytë (2) , Liga Regjionale.
- Klubi i Basketbollit Vushtria Basket - Kampion i kupës dhe fitues i titullit me U16

SEKTORI I RINISË

- Së bashku me Qendrën Rinore, OIQ-të, dhe grupet joformale u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2025.
- Në bashkëpunim me bordin e KVRL-së, u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2025, po ashtu u diskutua edhe për rristurimin i këtij këshilli që do të bëhet gjatë këtij viti.
- Janë njoftuar të gjitha OIQ-të rinore, KVRL-ja, Qendra Rinore si dhe grupet jo formale të të rinjve për thirrjen publike për mbështetje financiare nga Komuna, po ashtu janë njoftuar edhe për thirrjet nga MKRS-ja, njëherësh do tu ofrohet mbështetje profesionale dhe administrative, aq sa do të jetë e mundur në kapacitetet tona.
- Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OIQ- ve rinore gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dhe janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe IOM dhe OSCE.
- Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE, ku janë plotësuar disa pyetësor që janë dërguar nga ta edhe njëherë OSCE ka shpreh gatishmëri që të bashkëpunojë në aktivitete të ndryshme në fushat të cilat mund të na ndihmojë OSCE-ja.
- Është licencuar Qendra Rinore bazuar në Ligjin Nr. 08/L-264 për Rini si dhe Udhëzimin Administrativ (MKRS) Nr. 11/2024 për Qendrat Rinore, pas procedurave administrative është licencuar Organizata Rinore "Hareja".

- Organizata Rinore "Access" në bashkëpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.
- Takime pune me përfaqësuesit e Strategjia Rinore dhe KVRL-së ata kanë shprehur vullnet për të hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal, Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhshme.
- Takim me përfaqësuesin e OJQ "Kosova Serwas" me të u diskutua për projektet që parashihet të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje në fonde të donator të ndryshëm.
- Është në realizim e sipër projekti "Të rinjtë në vendimmarrje" ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë. Gjysma e parë e projektit është realizuar ndërsa ky projekt do të vazhdojë edhe me gjysmën tjetër, realizimi i këtij projekti do të ketë një ndikim të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore.

KVRL në bashkëpunim me organizatën "Domain for Kosovo" kanë mbajtur sesion informues për të rinjtë në shkollat e mesme, ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjve për themelimin dhe punën e KVRL-së si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

Trajnime për shkathësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore "Hareja" e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar

Qendra Rinore "Hareja" në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë dhe organizatën Gjermane DVV, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për 3 vite, ky memorandum parashihet Aftësimin Profesional për të rinj dhe të rritur në disa fusha, Gjuhë të huaja, TIK, Roboqepësi dhe kurse tjera çfarëdo që shprehin interes grupe të caktuara për të u trajnuar.

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik është institucion i cili pranon, evidencën, rregullon dhe publikon lëndën arkivore, mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat civil-juridik.

Arkivi kryen veprimtarinë në përputhje me ligjin dhe aktet e përgjithshme juridike. Ky institucion punët i kryen nëpërmjet këtyre shërbimeve:

- Shërbimi për mbrojtjen e lëndës arkivore brenda dhe jashtë arkivit
- Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale
- Evidentimi dhe rregullimi dhe klasifikimi i dokumenteve arkivore brenda arkivit
- Aktivitete tjera
- Punët e depos, mirëmbajtja, renditja si dhe mbikëqyrja e dokumentacionit
- Punët e udhëheqjes në arkiv
- Aftësimi profesional i punëtorëve

Arkivi Komunal

- Në periudhën Janar-dhjetor 2025 jemi konsultuar vazhdimisht me Drejtorinë komunale të cilat kanë dorëzuar material arkivor në vitin 2023-2025 për regjistrimin dhe finalizimin e dosjeve të cilat janë të përhershme.
- Materiali është dorëzuar në Arkiv për shikime emergjente për lirin e hapësirës në depon e materialit në Komunë për renovim të saj. Materiali i pranuar është në gjendje të mirë, por i pa sistemuar në mungesë të rafteve arkivore.
- Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pranuar material nga institucionet lokale, nga Drejtoria e Urbanizmit, projektet e viteve 2015-2019.

- Drejtoria e Administratës librat e regjistrit për vitet 2018-2024 totali i regjistrave 65 .
- Zyra e personelit ka dorëzuar materialin e rekrutimit të stafit për vitet 2015-2019.
- Institute për krimet e luftës në Kosovë ka kërkuar dorëzimin e materialit arkivor për dëmet e luftës në Komunën e Vushtrrisë. Është dorëzuar material për dëmet materiale të luftës për të gjitha fshatrat, në tërësi 60 kuti arkivore me dokumente dhe fotografi me datë 04.04.2025.
- Në periudhën janar –dhjetor nuk kemi sistemuar dokumentacion , sepse nuk kemi kushte të nevojshme në mungesë të rafteve dhe kutive arkivore, përveç se jemi duke I mirëmbajtur Brenda kushteve të cilat ekzistojnë në depon e Arkivit.
- Raftet e sistemit modular të cilat janë në depon e Arkivit të cilat gjenden të pashfrytëzuar duhet të gjendet forma dhe mundësi për shfrytëzimin e tyre.
- Shërbimi ndaj palëve është kryer sipas detyrës zyrtare, të gjitha kërkesat që parashtrihen përmes sistemit digjital janë shqyrtuar dhe përfunduar në bazë të dëshmive që i posedon Arkivi i Komunës. Gjatë kësaj periudhe janë parashtruar 53 kërkesa: të kryera 28; 25 të pakryera në mungesë të dëshmive të ndryshme: pronësore , përvojë të punës, verifikime të diplomave të ish-shkollës së policisë e cila ka funksionuar para vitit 1999.
- Bashkëpunimi për digjitalizim me komunën e VAXJO- Suedi po vazhdon sipas planit , gjatë vizitës së tyre në muajin prill 2025 kemi prezantuar Arkivin dhe institucionet tjera nga grupi punues. Si dhe vizita e dy zyrtarëve të Arkivit në Suedi në muajin shtator ka qenë efektive së bashku me ekipin e Komunës së Vushtrrisë në qytetin e Vaxjo -Suedi.
- Arkivi në bashkëpunim me grupin për digjitalizimin e arkivit apo shërbimeve komunale kemi hartuar dokumente në lidhje me shërbimet komunale ..
- Si njësi arkivore dhe si staf zyrtar kemi bashkëpunuar me DKRS dhe fushat tjera të Kuvendit komunal Vushtri.
- Angazhimi në komisione për vlerësim të ofertave të prokurimit, rekrutimit të zyrtarëve komunal si dhe angazhimi për menaxhimin e kontratave për projektet në kuadër të DKRS-së, ishin sfida pothuajse kryesore , pasi që shumë elemente të fushës së prokurimit janë jashtë fushës për të cilën jemi të emëruar.
- Gjatë kësaj periudhe kohore në muajin shkurt 2025 është plotësuar vendi i lirë i punës me një zyrtar arkivist, tani Arkivi është plotësuar me staf të mjaftueshëm (shefi i sektorit dhe tre arkivist).
 - Angazhimi i zyrtarëve të arkivit në komisione për subvencionimin e librave , klubeve dhe OJQ-ve.
 - Arkivi Historik i qytetit menaxhohet nga udhëheqësi dhe stafi i Arkivit në bashkëpunim me DKRS-Vushtri.
 - Në arkivin e qytetit gjatë kësaj periudhe kohore është bërë rekrutimi i një zyrtari-arkivisti i cili është pranuar si punëtor i rregullt dhe kryen shërbime në kuadër të arkivit.
 - Verifikimi i lëndëve pronësore bëhet në bashkëpunim me dokumentacionin përkatës të institucioneve si: Gjykata Themelore Vushtri, Policia e Kosovës, Kuvendi Komunal Vushtri me drejtorit përkatës , shkollat etj.
 - Kërkesat e palëve dorëzohen përmes sistemit elektronik në zyrën pritëse , pastaj zgjidhen në bazë të dëshmive që i posedon Arkivi komunal.
 - Arkivi komunal ka mungesë të hapësirës për punë për zyrtarët- arkivistët , pasi që kemi vetëm një zyre të vogël të punës. Të gjitha shërbimet kryhen por me vështirësi pasi që nuk kemi kushte të punës në mungesë të hapësirës.
 - Sa i përket depos ku është i vendosur materiali arkivor i plotëson kushtet dhe kriteret si objekt , por mungojnë raftet të cilat janë të domosdoshme për sistemimin e materialit arkivor.
 - Materiali i cili gjendet në depo është i ndarë sipas njësive organizative , por mungesa e rafteve e pamundëson sistemin dhe renditjen sipas kriterëve të paraparë me ligjin për arkivat dhe lëndën arkivore

TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Në muajin janar kemi filluar realizimin e shfaqjes "Burri Burrë" autor Kristo Floqi dhe kemi dhënë premierën e shfaqjes me 12 mars 2025.

Për nder të 1 vjetorit të vdekjes së Komandantit Gani Imeri organizuam akademi përkujtimore për Komandant Gani Imerin më 20 prill 2025.

Më 23 prill 2025 ishim bashkë organizator në Ditën Ndërkombëtare të Librit.

Kemi ndihmuar në organizimin e Festivalit "Zëbylbylat e Vicianës"

Aktivitet për nder të 1 Majit – Ditës së Punëtorëve

Ndihmuam në organizimin e Akademisë për nder të përkujtimit të Masakrës së Studimes më 2 maj 2025

Me 10 maj 2025 me rastin e përvjetorit të dëshmorit Hamdi Ferati, kemi ndihmuar në organizimin e këtij përvjetori,

Ndihmuam në organizimin e Akademisë për nder të përkujtimit të Masakrës së Vushtrisë më 22 maj 2025

Ndihmuam në organizimin e Akademisë për nder të përkujtimit të Masakrës së mbi Familjen Gerxhaliu, më 31 maj 2025

Për nder të ditës së Çlirimit 17 qershorit teatri u angazhua në këtë organizim

Me 3 dhe 4 shtator është mbajtur festivali i filmit "CASTLE FEST", festival që ka zgjuar kërshërinë e artdashësve vendor dhe ndërkombëtar.

Më 8 shtator deri me 12 shtator ishim në festivalin e teatrove në Suharekë.

SEKTORI PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Gjatë muajit janar më shumë kemi kryer disa çështje administrative si; komision për vlerësime të ofertave në prokurim, disa komisione të brendshme në DKRS, etj, duke qenë pjesë e Këshillit organizues për 17 Shkurtin Ditën e Pavarësisë; pjesë e komisioneve për vlerësimin e ofertave në prokurim në pjesën e dytë të muajit shkurt, si dhe duke bërë menaxhimin e kontratave, në tri projekte; "**Resaturimi dhe konservimi i ish Arkivit**", "**Rregullimi i memorialeve**" dhe "**Ndërtimi – rikonstruimi i fushave sportive**"

Menaxhimi në projektin e restaurimit dhe konservimit të ish Arkivit veç është në përfundim ku 95% të punëve kanë përfunduar dhe çdo gjë deri më tani ka shkuar sipas projektit edhe pse kanë dalë disa punë shtesë të cilat nuk i ka paraparë projektuesi.

Në projektin "**Rregullimi i memorialeve**" për disa fshatra në Komunën e Vushtrisë, është duke ecur mirë dhe mbi 50% të punëve janë përfunduar. Edhe në këtë projekt ka disa lëshime të cilat janë bërë nga projektuesi. Por bashkë me operatorin dhe mbikëqyrësin teknik në koordinim i kemi përmirësuar. Njëri nga memorialet veç ka përfunduar, ai në Gllavotin.

Në Vërnice dhe Pantinë janë në fazën përfundimtare.

Kurse 95 % e punëve kanë mbaruar në Beqic dhe Dubovc.

Ky projekt është 2 vjeçar.

Në projektin "**Ndërtimi – rikonstruimi i fushave sportive**" për disa shkolla në Komunën e Vushtrisë, projekt ky 3 vjeçar, punët janë duke ecur mirë dhe sipas specifikave të përpiluara dhe nevojave në teren. Deri më tani është duke u punuar në fushat; Samadrexhë, Shtitaricë, Pantinë dhe Novolan. Kuptohet që gjatë punimeve në teren haset në disa pengesa të vogla e që janë të tej kalueshme dhe pa e ndërprerë punën.

Sa i përket punëve si sektor i sapo formuar në fushën e trashëgimisë kulturore, ne s'jemi ndal së punuari në këtë drejtim duke u asistuar edhe në drejtorinë e urbanizmit projektet që kanë të bëjnë afër Urës Vjetër të Guri dhe të Kalaja. Kemi bashkëpunuar ngushtë me IAK-un, IKMM-n dhe QRTK- Mitrovicë për të tejkaluar disa probleme afër këtyre monumenteve.

Mbrojtje dhe Shpëtim

Gjatë vitit 2025 në DMSH ka pasur angazhime të rregullta por edhe raste emergjente veçanërisht me vërshime ku edhe kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar për angazhim në situata emergjente në terren për eliminimin e disa pikave kritike .
Kemi pasur takime me pjesëtarë të FSK-së, AME-së me Policinë e Kosovës - Stacioni në Vushtri, KFOR-in , Kryqin e Kuq në Vushtri, QOR 112. Në periudhën Kohore Janar-Qershor 2025 në Komunën e Vushtrisë karakterizohet me fatkeqësi të vogla natyrore dhe fatkeqësi tjera në krahasim me vitet paraprake.

Megjithëate edhe në këtë periudhë ka pasë fatkeqësi të cilat edhe kanë shkaktuar dëme të konsideruara materiale dhe fizike.

Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera , në bazë të kërkesave të qytetarëve kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë vlerësimin e dëmeve. të cilat paraqiten në këtë raport vjetor.

Ky raport paraqet dëmet e shkaktuara në sektorin e ekonomisë dhe bujqësisë në Komunën e Vushtrisë gjatë vitit 2025.
Të dhënat janë mbledhur në bazë të kërkesave zyrtare për kompensim të dëmeve të paraqitura nga qytetarët, si dhe nga vlerësimet e realizuara nga Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera.

Dëmet në Sektorin e Ekonomisë,

Gjatë vitit 2025, dëmet në sektorin e ekonomisë janë shkaktuar kryesisht nga zjarret (zjarre malore dhe fushore), ndërsa në një rast dëmi është shkaktuar nga vërshimet si pasojë e reshjeve të shiut dhe punimeve infrastrukturore.

Sipas deklarimeve të pronarëve të prekur, në shumicën e rasteve shkaktari i saktë i zjarrit nuk dihet, megjithëse në disa raste dyshohet për instalime elektrike.

Gjithsej vlera e dëmeve në sektorin e ekonomisë për vitin 2025 është: 50,954.00 €

Dëmet në Sektorin e Bujqësisë, në Komunën e Vushtrisë gjatë vitit 2025 janë shkaktuar kryesisht nga kushtet e pafavorshme meteorologjike, përfshirë erërat e forta të datave 13 dhe 14 mars 2025, uljen e temperaturave më 20.05.2025, si dhe nga zjarret fushore të paraqitura gjatë muajve verorë. Si pasojë e këtyre dukurive, janë dëmtuar sera bujqësore, pemishte me dredhëza, kultura bujqësore, blegtoria dhe bletaria.

Gjithsej vlera e dëmeve në sektorin e bujqësisë për vitin 2025 është: 19,945.31 €

Në vitin 2025, komunën e Vushtrisë e kanë prekur dëme të konsiderueshme nga zjarret dhe moti i pafavorshëm (erërat e forta) dhe ulja e temperaturave. Dëmet kanë prekur sektorin ekonomik dhe atë bujqësor, duke shkaktuar një humbje prej gjithsej **71,330.46 €**.

Rekomandohet rritja e masave parandaluese për zjarret, duke përfshirë fushata ndërgjegjësimi dhe përmirësim të infrastrukturës mbrojtëse për të minimizuar dëmet në të ardhmen.

Përmbledhje e përgjithshme,

Nr. Ren	Sektori	Shuma e dëmit
1	Gjithsej dëme në sektorin e ekonomisë në vitin 2025	50,954.00 €
2	Gjithsej dëme në sektorin e bujqësisë në vitin 2025	19,945.31 €
<i>Gjithsej dëme në Komunën e Vushtrrisë të shkaktuara nga zjarri dhe vërshimi në sektorin e ekonomisë dhe bujqësisë për vitin 2025</i>		70,899.31 €

Intervenimet me makineri për raste emergjente dhe Parandaluese

Gjatë kësaj periudhe , nga situata e krijuar në teren është paraqitë nevoja për intervenim me makineri të ndryshme meqë rast Kompaninë Kontraktuese N.N.P „HYSNIA“ kemi angazhuar në vende të ndryshme për intervenime emergjente dhe parandaluese ku nga periudha Janar-Qershor paraqitet në formë tabelore për punën dhe angazhimin e kompanisë në teren.

Vlera e përgjithëshme e shpenzimeve për intervenime emergjente dhe parandaluese për vitin 2025 ka qenë: **123.442.225** euro.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Ambjentit dhe Planifikimit Hapsinor, kemi Pastruar dhe Zgjeruar lumin e sllakovcit në gjatësi prej 13 km nga fsh. Maxhunaj deri në fsh. Ceceli.

Prioritetet e DMSH-së për situatat e krijuara:

- Ndihma dhe shpëtimi i njerëzve;
- Hapja e rrugëve dhe kanaleve nëpër vende ku ka mbeturina të ndryshme e që e kanë bllokuar derdhjen e ujit me qëllim të parandalimit të rrezikut.
- Debllokimi i lëshesave dhe kanalizimeve në raste të vërshimeve apo mbylljeve nga shkaktarë të ndryshëm.
- Evitimi i ujit prej shtëpive që kanë qenë të rrezikuara nga vërshimet;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për banorët të cilëve iu është ndotur uji i pijes;
- Vizita mjekësore për banorët e izoluar në rast nevojë;
- Hapja e rrugëve si pasojë e rrëshqitjes së dheut.

Si përfundim rekomandojmë:

Në mënyrë që të ruhet jeta e qytetarëve, infrastruktura rrugore, objektet e banimit, bizneset dhe kulturat bujqësore në të gjithë Komunën e Vushtrrisë, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtimka identifikuar vendet dhe pikat të cilat paraqesin rrezik e që ka nevojë që të intervenohet në evitim dhe parandalimin e rrezikut.

Lista e lumenjve dhe prockave të cilat duhet të trajtohen (të zgjerohen, prerja e shelgjeve, largimi i drunjve dhe mbeturinave, si dhe vendosja e urave dhe lëshesave ku është e nevojshme të intervenohet.

Siq dëhet Territori i komunës së Vushtrrisë ka një rrjet të dendur hidrografik

Sitnica është lumi më i rëndësishëm, i cili mbledh të gjitha rrjedhjet ujore të Komunës së Vushtrrisë. Nga ana e djathtë në lumin Sitnicë derdhen këta lumenjë: Llap, Lumkuqi, Tërstena, Podranqa dhe Gjyteza, Dumnica, lumi i Stanovcit ndërsa në anën e majtë merr vetëm disa përrenj dhe përroska periodike të cilat burimet i kanë në shpatiet lindore të maleve të Qyçavicës.

Vlerat karakteristike shumëvjeçare të rrjedhjeve ujore në lumin Sitnicë (st.Nedakovc) është 5.4 l/sek/km² ose 13.94 m³/sek (për nga sasia është lumi i katërt me rradhë në Kosovë). Sipërfaqja ujore në komunën e Vushtrrisë është rreth 700 ha ose 2% e sipërfaqës së përgjithshme të komunës, sip.përgjithshme sip.ujore

Nga vërshimet janë të rrezikuara rreth 600 ha tokë punuese të kategorisë I-IV dhe mbi 200 shtëpi banimi me rreth 1300 banor, ndërsa nga erozioni janë në rrezik të vazhdueshëm me tendencë rritje rreth 6500ha ose 18.0% të territorit të komunës.

Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë, Llap, Tërstenë dhe Lumë kuq, nga të cilat më të rrezikuarat shtrihen përgjatë lumit Sitnicë, e sidomos në grykëderdhje të lumit Llap ku rreth 260 ha dhe rreth 175 shtëpi janë të rrezikuara.

Periodha kohore e vërshimeve është më së tepërmi gjatë muajve Prill-Maj, atëherë kur regjimi pluviometrik është i përzier (shkrirje borë - reshje shiu), por edhe në muajin nëntor tradicionalisht ka pasë vërshime nga lumenjtë e Komunës së Vushtrrisë e veçanërisht nga lumi Sitnicë.

Vërshimet e tokave dhe pronave sipas shënimeve por edhe kujtimeve të të moshuarve daton që nga kohërat e lashta. Kjo dëshmon edhe me faktin se lumi Sitnica për shkak të sasisë së madhe ujore gjatë vërshimeve e ka ndryshuar edhe shtratin e lumit ku si dëshmi ende qëndron ura e vjetër e gurit.

Lumi Sitnica ka një sipërfaqe të madhe ujëmbledhëse atëherë rexhimi pluviometrik rritet po në atë periudhë kohore ku shtrati i lumit nuk mund të pranojë të plotat dhe si pasojë shkaktohen vërshimet.

Faktor tjetër është edhe faktori njeri që me veprimtaritë e veta ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë të vërshimeve:

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve),
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtrërit e lumenjve,
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë-rritura pran brigjeve të lumenjve etj
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

Në territorin e Komunës së Vushtrrisë nga vërshimet dhe erozioni është rreziku i humbjes së tokës bujqësore dhe dëme të mëdha në ekonominë familjare.

Më të rrezikuara janë tokat bujqësore dhe ekonominë familjare në: Vushtrri, Pestovë, Nadakovc, Dobërlukë, Shtruhërë, Prelluzhë, Gilavotin, Bivolak, Mihaliq etj.

Bashkangjitur me këtë dokument paraqiten edhe vendet me rrezik më të lartë të cilat ka nevojë për intervenim:

1. Lumi Tërstena nga fsh. Begaj deri në fsh. Karaqë.

2. Lumi Silnica (nga Fsh. Prelluzhë, Lumëmadh deri në Nadakove Mungojnë Argjinaturat) sikurse në disa pjesë argjinaturat janë të dëmtuara dhe kërkojnë nevojën e rehabilitimit të tyre).
3. Lumi i Dumnicës (nga Lumi Silnica deri në Dumnicë të epërme).
4. Lumi i Brezhnicës (nga Lumi Silnica e deri në përfundim të fshatit Stanovc I Epërm).
5. Lumi i Bajskës (nga Autostrada deri në fsh. Bajskë).
6. Lumi i Novolanit (nga Lumi Silnica deri në hyrje të fsh. Dubovc).
7. Lumi i Pantinës (Nga Fsh. Akashticë deri në Dalje të fshatit në drejtim të fsh. Pirq si dhe degëzimi nga lagja Arifaj deri në hyrje të fshatit Ashlan).
8. Lumi i Akashticës (Nga Hekurudhe deri në Silnicë dhe nga Shkolla fillore e Fshatit Akashticë deri në Balinc)
9. Lumi (prrocka) në Bivolak (nga lumi Silnica deri në Hyrje të fsh. Zhilivodë)
10. Kanalet kulluese përgjatë Argjinaturave të lumit Silnica.

Rreziqet tjera

Mbyllja e kanaleve Kulluese përgjatë rrugëve si:

1. Kanali Kullues përgjatë rrugës Pantinë – Ashlan .
2. Kanali Kullues përgjatë rrugës Smrekonicë – Pasomë.
3. Kanali dhe lëshesat e rrugicave në rr. Bastri e Ali Hyseni
4. Kanalet Kulluese përgjatë Hekurudhës dhe derdhja e tyre në Silnicë.
5. Kanali Kullues në fsh. Pestovë (nga Vipa Qipsi deri në Lumin Silnica).
6. Procka Nga Shkolla e fsh. Dubovc në drejtim të fsh. Beqiq dhe Galicë.

Urat:

Përveç pikave kritike të cilat janë identifikuar në rrjedhat e lumenjve dhe proçkave si shkaktar i vërshimeve në disa raste janë edhe Urat e ulta dhe të ngushta të cilat nuk kanë mundësi ta absorbojnë tërë sasinë e ujrave të akumuluar gjatë të reshurave atmosferike me intensitet më të lartë si :

1. Dy ura të cilat lidhin lumin e madh me Stanovcin e poshtëm
2. Urat në Fshatin Samadrexhë konkretisht në lagjen Bunjaku dhe Basholli.
3. Ura në fshatin Ropicë.
4. Dy ura në Pantinë në Lagjet; Ismajli dhe Binaku

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Planifikon që brenda periudhës dy vjeçare të trajton dhe eliminon të gjitha pengesat dhe shkaktarët e vërshimeve nga këto pika kritike të cekura më lartë por edhe problemet tjera eventuale të cilat shfaqen si pasojë e kushteve klimatike.

Problemet dhe vështirësitë:

- Mungesa e Stafit
- Kërkesat e mëdha dhe të njëpasnjëshme të qytetarëve për intervenim.
- Mosbindja e disa qytetarëve për të vepruar në terren konform planit për veprim emergjent.
- Mungesa e mjeteve adekuate për punë.
- Mungesa e veshmbathjes mbrojtëse dhe dalluese për zyrtarët e DMSH-së.

Njësia Profesionale e Zjarrfikjës dhe Shpëtimit

Njësia Profesionale e Zjarrfikjës dhe Shpëtimit në Vushtri në vitin 2025 ka hyrë me një gadishmëri sikurse edhe më parë me tërë personelin e saj duke i'u dalur përball punëve dhe detyrave gjithashtu edhe vështirësive të cilat iu kanë paraqitur. Prioritet ka qenë organizimi i Shërbimit Zjarrfikës dhe shpëtimit, mundësit taktike të veprimit në kushte dhe rrethana të vështira. Është bërë punë dhe përpjekje që intervenimet të kryhen sa më me sukses.

Nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me: AME, Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Shërbimin policor, qytetarët etj.

Veçanarisht vlen të përmendet shpejtësia, shkathtësia si dhe puna e pa lodhshme e punëtorëve zjarrfikës në intervenimet e bëra ku me anën e shkathtësisë dhe shpejtësisë është arritur që të bëhet shpëtimi i njerëzve dhe të mirave materiale.

2. Struktura dhe Kapacitetet

Gjatë vitit 2025, Njësia Zjarrfikëse ka funksionuar në përbërje prej 31 pjesarëve (komandanti i BZ, inspektori për parandalim nga zjarri dhe 29 zjarrfikës)

3. Aktivitetet Operative

Njësia Profesionale e Zjarrfikjës dhe Shpëtimit në Vushtri gjatë vitit 2025, ka realizuar një numër të konsiderueshëm intervenimesh, përfshirë: zjarre në objekte banimi, zjarre në hapësira të hapura dhe pyje, aksidente trafiku, ndihmë teknike dhe shpëtime, shërbime-furnizime me ujë. Shumica e rasteve janë menaxhuar me sukses, duke parandaluar dëme më të mëdha materiale dhe rrezik për jetën e qytetarëve.

Gjatë vitit 2025 NjPZSh ka pasur 1334 raste intervenimi–dalje, në të cilat intervenimi është bërë me preparate adekuate siç është uji dhe mjetet tjera për fikje si aparatet për fikjen fillestare të zjarrit.

Kanë marrë pjesë 2938-zjarrfikës dhe 1432 -automjete zjarrfikëse.

Kanë qenë gjithsej 1334 intervenime (1234-të prones private, 82 -të prones shoqërore dhe 18- lajme të rrejshme).

Prej tyre: 761 -zjarre, 71 - intervenime teknike, 480-shërbime, 3-aksidente rrugore, 1- vëzhgim terreni dhe 18- lajme të rrejshme.

Intervenime të cilat kanë qenë të shkaktuara kryesisht nga faktori njeri, pakujdesia, rryma, mungesa e ujit, etj.

Të lënduar: 6 persona- (qytetarë).

Të vdekur: S'ka.

Ujë i shpenzuar: 4957 m³/ujë.

Dëmet materiale përafërsisht 198,000.⁰⁰ euro.

Po ta bëjme një krahasim; Në vitin 2024, kemi pasur 847 - intervenime, prej të cilave: 531-zjarre, 63-intervenime teknike, 237- shërbime, 6-aksidente, 6- vërrshime dhe 4- lajme të rrejshme.

4. Aktivitetet Parandaluese dhe Edukuese

Njësia ka zhvilluar aktivitete parandaluese si:

Inspektime të objekteve publike dhe private.

Këshillime për masa kundër zjarrit.

Trajnime dhe demonstrime praktike në shkolla dhe institucione.

5. Trajnime dhe Zhvillim Profesional

Gjatë vitit 2025, stafi ka marrë pjesë në disa trajnime të organizuara nga AME, Trajnimin lidhur me ujrat sipërfaqësor e po ashtu edhe Trajnime profesionale të tre zjarrfikësve të ri. Ky bashkepunim pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit në vijim dhe në bazë të planit të paraparë do të jetë një numër solid që do marrë pjesë në trajnime.

6. Sfidat dhe Vështirësitë

Në kuader të sfidave është rëndësia e modernizimit të mjeteve operative dhe forcave zjarrfikëse pasi që në mungesë të mjeteve modern dhe personelit, infrastruktura zjarrfikëse mbetet e kufizuar.

Kemi nevojë për kapacitete teknike dhe rritje të numrit të zjarrfikësve në raport me numrin e popullsisë.

Rritja e numrit të rasteve gjatë sezonit veror ka paraqitur problem gjatë intervenimeve ku edhe kemi kërkuar ndihmën e DMSH për të marrë masa lidhur me pastrimin e terenit dhe hapjen e rrugëve në terrenet malore, ku për shkak të pyllëzimit të dendur dhe pjerrinave ka pasur bllokim të rrugëve dhe na është vështirësuar qarkullimi me automjete zjarrfikëse për të intervenuar.

Mungesa e pajisjeve moderne dhe të përshtatshme.

Automjete të amortizuara.

Rritja e numrit të rasteve, veqanarisht në terrenet fshorë-malore.

Këto janë disa vështirësi që kanë ndikuar në ngarkesën e punës, por nuk kanë penguar kryerjen e detyrave.

Njësia Profesionale e Zjarrfikës dhe Shpëtimit në Vushtri përveq punës dhe veprimtimit në rastet e intervenimeve, aktivitetin e saj e zhvillon në mënyrë të ndryshme duke filluar nga pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve, automjeteve dhe garazhave.

Në pastrimin e mjeteve parashihet pastrimi i zorrëve, fiskajave, lidhësve, shpërndarësve, thithësve, litarëve, aparatës për fikje me shkumë dhe pluhur.

Pastrimi i automjetit nënkupton pastrimin detal të automjetit si dhe verifikimin e aftësisë së tij për intervenim.

7. Konkluzione dhe Rekomandime

Njësia Zjarrfikëse gjatë vitit 2025 ka treguar përkushtim, profesionalizëm dhe gatishmëri të lartë. Për përmirësim të mëtejshëm rekomandohet:

Investim në pajisje dhe automjete të reja.

Trajnime të vazhdueshme profesionale.

Rritje e stafit operativ.

8. Përfundim

Njësia Zjarrfikëse ka përmbushur me sukses misionin e saj për mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit gjatë vitit 2025, duke mbetur një shtyllë e rëndësishme e sigurisë publike.

Në bazë të punës dhe aktiviteteve të përgjithshme të kryera gjatë vitit 2025 mund të konstatojmë se janë arritur të gjitha direktivat e e parashikuara si në aspektin e fikjes së zjarrit, aksioneve shpëtuese dhe çdo lloj tjetër (intervenime teknike) të kërkuar nga Njësia Zjarrfikëse gjithashtu edhe punën e kryer për parandalimin e zjarreve si dhe ngritjen e njohurive të qytetarëve në lëmin e mbrojtjes nga zjarri.

Gjendja e përgjithshme e sigurisë (mbrojtjes) –parandalimit nga zjarri në K.K. –Vushtrri.

Sa i përket gjendjes së përgjithshme të sigurisë mbrojtjes nga zjarri në rajonin e komunës së Vushtrrisë me rrethinë në krahësim me vitin e vitin e kaluar (2024), mund të thuhet se gjatë këtij viti (2025) ka pasur më pak raste e veçanërisht atyre të zjarreve (fushore- malore) zjarre të shkaktuara nga temperaturat dhe pakujdesia e faktorit njeri .

Gjendja e përgjithshme e mbrojtjes (parandalimit) nga zjarri në këtë qytet duke marrë parasysh (objektet vitale) edhe pompat- stacionet për furnizim të qytetareve me derivate dhe gas pothuaj se është e volitshme, pasi që keta i (kryejnë) eliminojnë masat kryesore të sigurisë nga zjarri dhe e marrin shumë serioz (situatën) dhe 70% prej tyre i kanë të evituara mangesitë në objekte.

Posedojnë:

- aparatet për fikjen fillestare të zjarrit,
- atestet e rrymës elektrike (çdo vit e ateston një here),
- punëtorët e aftësuar për t'i përdorur aparatet kundër zjarrit,
- shkallët për evakuim,
- hyrje –daljet emergjente, etj.

Gjendja në objekte publike është po thuajse e volitshme.

Gjendja në objekte banimi (ndërtesa të vjetra të ndërtuara para 50 e më tepër vitesh) nuk kanë hidranta, ujë të pijshëm, nuk ka rregull dhe askush nuk interesohet për mirëmbajtjen e tyre (mure të përlyta, nuk ka drita në koridore, rryma katastrof, etj), ku që nga viti 2011 është bërë zgjedhja e një personi përgjegjës për çështjet (problemet ose brengat) të cilat i preokupojnë banorët e atyre objekteve, gjegjësisht ai person është përgjegjës të perkujdeset për pastërti, qetësi, rregull dhe discipline të cilën do ta kërkojë nga qytetarët-banorët për secilin ndërtesë veq e veq.

Gjendja e rrugëve (komunikacioni publik) mjaft i ngarkuar, rregullimi i rrugëve, trotuareve, shesheve, etj.

Sherbimi i zjarrfikjes dhe shpëtimit së bashku me inspektorët e parandalimit nga zjarri momentalisht gjendet i vendosur në fshatin Studime (Martiraj) larg nga qendra e qytetit afro 4 km. Rruga e frekuentuar nga femijet dhe bagetite, ku automjetet zjarrfikese veshitë të kyqen në maxhistrallë me komunikacion të dendur.

Është punuar mjaft në ngritjen e vetëdijes qytetare duke i njoftuar qytetarët me rrezikun i cili mund t'iu kanoset nga pakujdesia apo mosdija e tyre. Në aspektin e parandalimit nga zjarri është arritur sukses pasi që numri i zjarreve në objekte ndërtimore tani është në rënie të dukshme.

Siç shifet nga të dhënat në këtë raport raport është paraqitë në mënyrë të detajuar puna dhe aktivitetet e kryetarit – ekzekutivit të komunës gjatë vitit 2025. Konsiderojmë se është arritur që në masë të kënaqshme të përmbushen objektivat e përcaktuara në planin tona të punës gjatë periudhës raportuese duke qenë çdoherë në shërbim të qytetarëve për një jetë dhe mirëqenie më të mirë dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës së tyre përmes projekteve të shumta që janë realizuar dhe do të realizohen.

Raporti mund të plotësohet me sugjerime dhe propozime me rastin e diskutimeve në mbledhje të kuvendit.

Ferit Idrizi


Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E VUSHTRRIË

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE /A:	26.02.2026
PËR:	Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal – Vushtrri
PËRMES:	Kryetari i Komunës z.Ferit Idrizi
NGA/:	Drejtoresha e DKA-së, Naile Bekteshi
TEMA:	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë, të vitit shkollor 2025/26

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.209/2022, Drejtoria Komunale e Arsimit paraqet këtë informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë, të vitit shkollor 2025/26. Drejtoria Komunale e Arsimit, objektivat e veta të planifikuara i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI-Prishtinë), me Sektorin e Inspektoratit në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit.

I. Për punën e Drejtorisë së Arsimit

Viti shkollor 2025/26 ka filluar më 1 shtator 2025, ndërsa gjysmëvjetori i parë ka përfunduar më 24 dhjetor 2025, bazuar në UA.01/2025.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka hapur platformën për aplikim për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore me datën: 15.08.2025. Aplikimi për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore ka qenë i hapur në Platformën E-Kosova deri në fund të muajit shtator. Të gjitha objektet e shkollave kanë ofruar kushte teknike për një fillim të mbarë. Drejtorja Komunale e Arsimit, objektivat e veta të planifikuara i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI-Prishtinë), me Sektorin e Inspektoratit në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit. Drejtorja Komunale e Arsimit, paraqet këtë informata për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë duke u bazuar në aktivitete dhe të arritura.

▪ Numri i nxënësve në nivele, për vitin shkollor 2025/26:

Niveli 0: 1082 nx.

Niveli 1: (1-5) 4570 nx.

Niveli 2: (6-9) 3820 nx.

Niveli 3: (10-12) 2174 nx.

Gjithsej, nxënës: 11646

▪ Numri i paraleleve:

Grupi 5-6 – Parafillor: 40

Fillor, klasa 1-5: 266

I mesëm i ulët: 206

I mesëm i lartë: 105

Gjithsej: 642 paralele

- **Personeli:**

Zyrtarë të DKA-së: 11-të

Drejtorë: 37

Zëvendës drejtorë: 8

Pedagog/e: 10

Psikolog/e: 10

Asistent/e: 12

Bibliotekistë: 9

Këshilltarë karriere: 2

Sekretar/e: 11

Punëtorë teknik: 140

Edukatorë: 86

Mësimdhënës klase: 266

Mësimdhënës lëndor, kl. 6-9: 372

Mësimdhënës lëndor, kl. 10-12: 174

Gjithsej mësimdhënës/e, edukatorë dhe mësimdhënës/e: 897

Numri total i punëtorëve: 1147.

- **Numri i institucioneve publike: 38 prej tyre**

Tri qerdhe

Katër shkolla fillore

Dy shkolla të mesme të ulëta

Njëzet e shtatë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta

Tri shkolla të mesme të larta.

- **Numri i institucioneve private:**

Pesë qerdhe private

Një shkollë e mesme e mjekësisë.

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/26, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë, me qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

II. Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrisë, që objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regional të Arsimit;
- Takime të rregullta me KFORIN sllloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsimit;
- Nga ekipi komunal për vlerësimin e nxënësve, janë vlerësuar tre nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe janë rivlerësuar po ashtu 11 nxënës;
- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e DKA-së: kontrata për furnizim me material për mirëmbajtje të objekteve, kontrata për furnizim me inventarë zyrtar-shkollor, kontrata për furnizim me letër, kontrata për furnizim me lëndë djegëse (dru) në shkollë, kontrata e transportit të nxënësve, kontrata për internet, kontrata për material zyrtar;
- Vizita të rregullta në qendrën arsimore të Komunitetit VORAE në Prelluzhë;
- Transporti i nxënësve është realizuar në tridhjetë e gjashtë vija udhëuese;
- Ligjërtata nga Policia e Kosovës (tri herë) me temat: rregullat të komunikacion, interneti dhe rreziqet për fëmijë, kujdesi nga mjetet piroteknike;
- SHFMU "Enver Hadri" – Smitekonjë, ka përfituar projektin për renovim nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës. Punëkryesi i projektit është kompania AL SOLUTIONS SHPK nga Gjilani. Punimet e renovimit përfshijnë: rregullimin e bodrumëve të shkollës, ndërrimin e kallëdasë, ndërrimin e plotë të radiatorëve, ndërrimin e dritareve të objektit shkollor, renovimin e katër banjove, rregullimin e një kabineti të lëndëve fizikë-kimi me të gjitha elementet e nevojshme, rregullimin e një salle multifunksionale për aktivitete të ndryshme, si dhe rregullimin e punëtorisë për shtëpiakun e shkollës;
- Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri, ka arritur disa marrëveshje me institucione tjera arsimore si: Unity Tech Hub (Shkollë e programimit), Cactus Education (Shkollë e programimit), ku si rezultat, përlitues do të jenë nxënësit e shkollës sonë, duke ndjekur kurse fala;
- SHML Bahri Haxha" – Vushtri, ka vazhduar projektin "mësimi në vendin e punës" dhe 170 nxënës të klasave XI dhe XII kanë kryer praktikën në vendin e punës. Ka vazhduar "Mësimi dual" për 22 nxënësit e profilin "Tregtarë me pakicë dhe shumicë", klasa e XII (ka pasë vështësi për shkak të mosgatishmërisë së bizneseve për t'i përmbushur kontratat me nxënës, ku parashihet edhe pagesa

mujorë). SHMP "Bahri Haxha", ka qenë përfutuese e ajë kabinetit me kompjuterë për firmën ushtrimore të ekonomisë nga MASHTI. Në këtë shkollë është instaluar edhe "Softueri i kontabilitetit" donacion nga Sh.p.k. „Rikoni" në firmën ushtrimore të Ekonomisë;

- SHMP "Bahri Haxha", ka qenë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin Cultiveting, ndër shkollat e para publike e përfshirë në këtë program, ku janë realizuar disa trajnime për mësimdhënës;
- SHMT "Lufti Musiqi" – Vushtri, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me CACTUESEDU, për zhvillimin profesional në fushën e teknologjisë;
- Shkolla SHMU-1 dhe SHMU-2, u shpërblyen nga MASHTI, lidhur me raportimin e rasteve të dhunës në shkollë;
- Takime të realizuara në Qendrën Burimore "Nënë Tereza" në Mitrovicë, për të përcjellë mbarrvajtjen e procesit mësimor të katërmbëdhjetë nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, që i kemi në qendër;
- Njëzetë nëntori, Dita Botërore e Fëmijëve, e shënuam me aktivitete të ndryshme, me nxënësit e tri shkollave të mesme të ulëta, duke përfshirë edhe SHFMU "Abdyl Frashëri" – Druar;
- Shënimi Ditës Ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara (tre dhjetor);
- Hapja e kopshteve publiko-private, me bazë në komunitet, në fshatin Stanoc i Epërm dhe Shtitaricë, përmes projektit CIPOF;
- Përfundimi i aneksit të SHF "Mustafë Venhari";
- Vlerësimi pedagogjik i shtatëmbëdhjetë FNV;
- Aktivitet – Vetëdijësimi për muajin usor, muaji rozë - kundër kancerit;
- Aktualisht janë në fazën finale procesi i harmonizimit të kontratave të punës për punëtorët e arsimit me legjislacionin në fuqi, ndonëse disa shkolla ende nuk i kanë harmonizuar ato.
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka vlerësuar kushtet higjieniko-sanitare në shkollat dhe ka dërguar raport për secilën shkollë: Gjimnazi "Eqrem Çabej", qëndron mirë në aspektin e klasave, mureve, ndriçimit, oborrit dhe menaxhimit të mbeturinave. Mesatarisht në inventar, karrika, banka, dërrasa dhe nyjet sanitare. Dobët për mungesën e ambulancës shkollore dhe stafit shëndetësor. SHMU-2: qëndron mirë në aspektin e klasave, mureve, ndriçimit, oborrit dhe menaxhimit të mbeturinave. Mesatarisht në inventar, karrika, banka, dërrasa dhe nyjet sanitare. Dobët për mungesën e ambulancës shkollore dhe stafit shëndetësor. IP: Foleja : Gjendja higjieniko-sanitare e shkollës vlerësohet si e Mirë. Aspektet mesatare: inventari shkollor, nyjet sanitare.

III. Garat e ditorisë dhe garat sportive

- SHFMU "Abdyl Frashëri" – Druar, vendi i dytë në Kosovë për instilacione në FKE, nga nxënësjja Qëndresa Ismaili;
- SHMT "Lutfi Musiqi" – Vushtrri, nxënësit kanë zënë vendin e dytë në projektin për promovimin e vlerave humane, në kuadër të Kryqit të Kuq;
- Garat komunale në lëndën e matematikës, për klasat e 7-ta: vendin e parë SHMU 1, Vendi i dytë SHMU 2, vendi i tretë SHFMU "Abdyl Frashëri" – Druar. Për klasat e 8-ta: vendi i parë SHMU 2, vendi i dytë SHMU 1, vendi i tretë SHMU 2. Për klasat e 9-ta: Vendi i parë, vendi i dytë dhe vendi i tretë SHMU 2. Për klasat e 11-ta, 12-ta, Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri. - Redon Hujizi, nxënësi i gjimnazit "Eqrem Çabej" do t'a përfaqësoi Vushtrinë dhe Kosovën në garat e matematikës, në garat botërore në Shanghai – Kinë;
- Garat e fizikës, në nivelin komunal: për klasat e 7-ta, vendin e parë SHFMU "Emin Duraku" – Novolan, vendin e dytë SHMU 1, vendin e tretë SHMU 2. Për klasat e 8-ta, vendin e parë SHFMU "Emin Duraku" – Novolan, vendin e dytë SHMU 2 – Vushtri, Vendet e treta SHFMU "Pestova" dhe SHFMU "Martiart". Ndërsa gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri, tri vendet e para për kalsat e 10-ta, dhe për kalsat e 12-ta. Ndërsa në nivel republike, Gjimnazi vendin e parë për kalsat e 10-ta dhe SHMU 2 vendin e katër për klasat 9-ta;
- HENDBOLL: Shkollat e Mesme të Ulëta;
- FEMRAT: Vendi i Parë, SHFMU "Lumni Surdull" – Samadrexhë. Vendi i Dytë, SHMU 2 – Vushtri;
- MESHKUJT: Vendi i Parë, SHMU 2 – Vushtri. Vendi i Dytë, SHFMU „Lumni Surdull“ – Samadrexhë;
Shkollat e Mesme të Larta;
- FEMRAT: Vendi i Parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri;
- MESHKUJT: Vendi i parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri;
- PING PONG: Shkollat e Mesme të Ulëta
- FEMRAT: Vendi i Parë, Shkolla e Mesme e Ulët "2" Vushtri. Vendi i Dytë, Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Liria" – Strofc;
- MESHKUJT: Vendi i Parë, Shkolla e Mesme e Ulët "2" Vushtri. Vendi i Dytë, Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Bahri Kuqi" – Shtitaricë;

- Shkollat e Mesme të Larta: Vendi i parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri (femrat). Vendi i parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri (meshkujt);
- SHAH: Shkollat e Mesme të Ulëta: Vendi i Parë, Shkolla e Mesme e Ulët "2" - Vushtri. Vendi i Dytë, Shkolla e Mesme e Ulët "1" - Vushtri;
- Shkollat e Mesme të Larta: Vendi i parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri;
- FUTSALL: (klasat 6 dhe 7) Shkollat e Mesme të Ulëta;
- FEMRAT: Vendi i parë, Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Rahri Kuqi" - Shtitaricë. Vendi i dytë, Shkolla e mesme e ulët "2" - Vushtri;
- MESHKUJT: Vendi i parë, Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Andon Z. Çajupi" - Vushtri. Vendi i dytë, Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Nazmi Zhegrova" - Stanofc;

- HENDBOLL: Shkollat e Mesme të Ulëta
- FEMRAT: Vendi i parë, SHFMU "Lumni Surdullli" - Samadrexhë;
- MESHKUJT: Vendi i dytë, SHMU "2" - Vushtri;

- Shkollat e Mesme të Larta:

- FEMRAT: Vendi i parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri;
- MESHKUJT: Vendi i dytë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri;
- PING PONG: Shkollat e Mesme të Ulëta
- FEMRAT: Vendi i dytë, Shkolla e Mesme e Ulët "2" Vushtri
- MESHKUJT: Vendi i Parë : Shkolla e Mesme e Ulët "2" - Vushtri;
- Shkollat e Mesme të Larta:
- FEMRAT: Vendi i dytë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri;
- MESHKUJT: Vendi i parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri;
- SHAH: Shkollat e Mesme të Ulëta: Vendi i parë, Shkolla e Mesme e Ulët "2" - Vushtri;
- Shkollat e Mesme të Larta:
- Vendi i dytë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtri;

REZULTATET E ARRITURA NË NIVEL REPUBLIKE

- **HENDBOLL:** Shkollat e Mesme të Ulëta, (FEMRAT);
- **Pjesëmarrës:** SHFMU "Lumni Surdullit" – Samadrexhë;
- **Shkollat e Mesme të Larta;**
- **FEMRAT:** Vendi i parë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri;
- **PING PONG:** Shkollat e Mesme të Ulëta;
- **MESHKUJT:** Pjesëmarrës, Shkolla e Mesme e Ulët "2" – Vushtri;
- **SHAH:** Shkollat e Mesme të Ulëta, Pjesëmarrës, Shkolla e Mesme e Ulët "2" – Vushtri;

IV Investimet kapitale:

- **SHMP "Bahri Haxha" - Vushtri,** janë pajisur me SMART-TV të gjitha klasat e mësimi dhe kabinetet (planifikim me buxhetin e shkollës). Janë pajisur me laptop personal të gjithë mësuesit (planifikim me buxhetin e shkollës), janë pajisur me pajisje bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale, kabinetet e kimisë, teknologjisë ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- Janë pajisur shkollat me 56-të smart-board: SHMU 1, 15-të copë. SHFMU "A. Z. Çajupi" – Vushtri, me 13-të copë. SHF "Mustafë Venhari" me 16-të copë. Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri, me 12-të copë.

V. Donacionet

- SHFMU "Abdyl Frashëri" – Druar, ka përfituar 20 çanta për nxënës nga shoqata "Bereqeti" si dhe nga "Gorenje" (TV, dy printerë dhe laptopë);
- SHFMU "Adem Voca" – Pasonë, ka përfituar një donacion të vlefshëm prej pesë klimave-kondicionereve, nga Fondacioni "GNTC-Gorenje" me seli në Prishtinë.
- SHF "Ali Kelmendi" – Vushtri, ka përfituar inventar shkollor (banka, karrige, dollapa), perde për klasë, ngjyrosje dhe përmirësime të ambienteve mësimore, donacion nga Mobilia "Duli" (Emin Hyseni), Kompania "Jani" (Egzon Ferizi) dhe kompania "Gorenje" për donacionin e gjashtë klimave.
- Gjinnazi "Eqrem Çabej" – Vushtri, - Marrveshje bashkëpunimi me Universitetin AAB, ku si rezultat, ky institucion e ka ndihmuar shkollën tonë me banka e karrika për një kabinet me vlerë prej një mijë e shtatëqind (1700) Euro;
- SHFMU "Mustafë Shyti" – Oshlan, ka siguruar dhjetë klima nga kompania "GENTC GROUP";
- SHF "Naim Frashëri" – Vushtri, në klasën e V/3, dhuroi një TV (prindi) Muhamet Zariqi;
- SHFMU - Nadakofe, gjashtë klima nga "GNTC Group". montimin e të cilave dhe blatjen e elementeve përcjellëse i kanë paguar dy anëtarë të komunitetit të fshatit. Një set pajisje kuzhine për parafillorë nga shoqata "Bereqeti", një dollap për libra nga prindërit e klasës së dytë;
- SHFMU "Emin Duraku" – Novolan, - Donacionet: Visar Vatovci i dhuroi shkollës disa materiale bazike të nevojshme për mbarrëvajtjen e procesit mësimor;
- SHMU 1 – Vushtri, mori donacion një printer nga Shtëpia Botuese "Hamilton House".

VI. Suksessi i gjysmëvjektorit të parë, 2025/26

	Suksesii i gjysmëvjektorit të parë, viti shkollor 2025/26, klasa 1-5, krahasuar me periudhën e njëjtë					
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2025	66.75%	19.45%	9.97%	3.13%	0.62%	0.09%
2024	66.69%	19.42%	11.42%	2.68%	0.73%	0.43%
Krahasueshmëria	1.06%	0.03%	-1.45%	0.45%	-0.11%	-0.34%

Shkëlqyeshëm: ka ngritje të suksesit për 1.06%


Shumë mirë: ka ngritje të suksesit për 0.03%

Mirë: ka rënie të suksesit për 1.45 %

Mjaftueshëm: ka rënie të suksesit për 0.11%

Të pamjaftueshëm: ka ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.34%

Suksesii i gjysmëvjektorit të parë, viti shkollor 2025/2026, klasa 1-5



Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2025/26, klasa 6-9, krahasuar me periudhën e njëjtë						
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të pavoruar
2025	24.35%	22.18%	16.71%	2.41%	34.03%	0.32%
2024	24.32%	20.98%	18.40%	3%	33.09%	0.18%
Krahasueshmëria	0.03%	1.20%	-1.69%	-0.59%	0.94%	0.14%

Shkëlqyeshëm: ka ngritje të suksesit për 0.03%


Shumë mirë: ka ngritje të suksesit për 1.20%

Mirë: ka rënie të suksesit për 1.69 %

Mjaftueshëm: ka rënie të suksesit për 0.59%

Të pamjaftueshëm: ka ngritje për 0.94%

Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2025/2026, klasa 6-9



Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2025/26, klasa 10-12, krahasuar me periudhën e njëjtë						
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2025	7.77%	16.99%	15.72%	10.59%	48.52%	0.41
2024	8.05%	14.11%	12.28%	16.28%	49.12%	0
Krahasueshmëria	-0.28%	2.88%	3.44%	-5.69%	-0.60%	41.00%

Shkëlqyeshëm: ka rënie të suksesit për 0.28%


Shumë mirë: ka ngritje të suksesit për 2.88%

Mirë: ka ngritje të suksesit për 3.44%

Mjaftueshëm: ka rënie të suksesit për 5.69%

Të pamjaftueshëm: ka rënie për 0.60%

Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2025/2026, klasa 10-12



VII. Numri i mungesave të gjysmëvejtorit të parë, të vitit shkollor 2025/26

Klasa	Numri i nxënësve	Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Të arsyeshme në raport me nx.	Të paarsyeshme në raport me nx.
Klasa 1	847	6200	276	7	0
Klasa 2	919	7081	338	8	0
Klasa 3	922	8021	1089	9	1
Klasa 4	936	9580	927	10	1
Klasa 5	920	7797	1461	8	2
Klasa 6	905	10376	1047	11	1
Klasa 7	966	12988	4114	13	4
Klasa 8	1008	15591	4572	15	5
Klasa 9	891	11360	4937	13	6
Klasa 10	772	7944	5901	10	8
Klasa 11	700	10402	7386	15	11
Klasa 12	729	13042	6931	18	10
Gj.	10515	120382	38979	11	4



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË / OPŠTINA VUČITRN / MUNICIPALITY OF VUSHTRRI



Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrië

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e
Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1.	Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve në kategorinë ekonomike	Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" neni 18, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë. Në 167 pagesa në vlerë prej 774,368€ kemi identifikuar se komuna përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate si në vijim: Përmes vendimeve gjyqësore përmbartimore ishin ekzekutuar shpenzime në vlerë 658,353€ për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta. Nga kjo vlerë, 547,313€ ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale, 50,131€ nga mallrat dhe shërbimet	Rekomandimi B1 Kryetari duhet forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjet adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.	Duke u Bazuar në Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" neni 18, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë. Mirpo Komuna e Jonë mbi 90% ka	Organizata buxhetore 644	2026	

		si dhe 60,909€ nga kategoria e subvencioneve; Po ashtu përmes vendimeve gjyqësore, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin paguar 75,000€ për ndërtimin e shtratit të lumit, shpenzime që për nga natyra i takojnë investimeve kapitale, si dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 41,015€ € për asfaltime të rrugëve, shpenzime që për nga natyra i takojnë po ashtu investimeve kapitale.		kryer obligimet permbarimore që dalin nga kontrata kolektive dhe me rastin e planifikimit buxhetor ne do ndermarrim hapat e nevojshum per realizimin e obligimeve permbarimore. E Pazbatuar			
2.	Çështja B2 - Nënvlërësim i regjistrit të pasurive kapitale dhe jo kapitale	Rregullorja MF Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, paragrafi 3, përcakton që: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria". Pasuritë e blera gjatë vitit 2024 dhe investimet në vijim nuk ishin regjistruar në regjistrat përkatës të pasurisë jo financiare, duke e nënvlerësuar vlerën e pasurisë në raportin vjetor financiar për 651,807€. Në vijim, janë prezantuar detajet: Investime në vijim të paguara gjatë vitit 2024 për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe fushave sportive, në vlerë 607,516€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e	Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë kontrole efektive dhe komunikim mes drejtorive ashtu që pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.	E Realizuar	Finan cat	Dhjet or20 25- Janar /202 6	

		pasurive kapitale të SIMFK-së si pasuri në vijim; si dhe • Pasuri jokapitale të teknologjisë informative dhe pajisje të tjera, të blera gjatë vitit 2024 në vlerë 44,291€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.					
3.	B3 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente	Rregullorja e MF Nr.01/20217, për raportim vjetor financiar, Neni 6, parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare", ndërsa neni 18 përcakton që organizatat buxhetore në harmoni me LMFPF-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente. Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin financiar vjetor ishin mbivlerësuar për 129,431€, për shkak se komuna kishte prezantuar në regjistrin e detyrimeve kontigjente katër pretendimet për kompensime të pagave, për të cilat kishin përfunduar procedurat gjyqësore dhe ishin marrë vendimet përfundimtare nga gjykata. Këto shpenzime do të duhej të përfshiheshin si obligime në regjistrin e obligimeve të papaguara.	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë në PVF.	E realizuar		Zyra Ligjore	

4.	Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF	Rregullores Nr. D1/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, nenit 6, parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10 paragrafi 1 përcakton se: "Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: pika 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës". Në tetë (8)* raste, komuna ka bërë prezantim jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF, me ç'rast regjistri i llogarive të arkëtueshme në raportin vjetor financiar ishte nënvlerësuar për 34,376€. Detajet e këtyre gabimeve janë si në vijim: - Në katër (4) raste tek taksa për lejet ndërtimore kishte nënvlerësim për 60,364€, pasi që komuna nuk ka shpalosur kështet e papaguara për lejet ndërtimore; - Po ashtu, në katër (4) raste tjera tek dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, ishin mbivlerësuar llogaritë arkëtueshme për 9,165€, si rezultat i mos azhurnimit të regjistrit;	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF.	Pjesërisht e zbatuar	Planif ikimi Urba n dhe Kada stri			
----	--	---	--	-----------------------------	--	--	--	--

		Në dy (2) raste me vlerë 16,823€ tek tatimi në pronë për parcela kishte mbivlerësim, komuna kishte ngarkuar me tatim në pronë tokat në pronësi publike, duke mbivlerësuar regjistrin e llogarive të arkëtueshme për këtë shumë.					
5.	Çështja B5 - Vonesë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), nenit 39.1 parasheh që: "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Në shtatë (7)¹⁹ raste, në vlerë prej 81,978€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor. Vonesat ishin nga 5 ditë deri në 95 ditë pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh. Kjo kishte ndodhur kryesisht si rezultat i mungesës së mjeteve financiare për shkak të pagesave të pa planifikuara përmes vendimeve gjyqësore	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhet brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.	Duke u bazuar në planin buxhetor për vitin fiskal rastet pembarimore ndryshojnë planin e veprimit të mungesës së mjeteve financiare dhe realizimin e tyre. E zbatuar	Finan cat	I vazh dus hum	
6.	Çështja A2 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve	Ligji Nr. 08-L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2024, neni 16, pika 11, përcakton që: "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në	Duke u bazuar në planin e rrjedhës së paras shumica e projekteve kapitale realizimin e	Planif ikimi Urba n	2026	

	kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal	prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal" Në dy (2) ¹ pagesa të projekteve kapitale në vlerë prej 68,756€, ishin marrë fondet nga projekte tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Këto ndryshime në shumat e ndara buxhetore ishin bërë me vendim të Kryetarit të Komunës pa marrë aprovimet e Kuvendit Komunal për ridestitim të fondeve.	ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.	pagesave e kanë mujin nëntor-dhjetor të vitit fiskal E zbatuar			
7.	Çështja B6 - Dobësi në procedurat e prokurimit publik	Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, neni 28, pika 2, përcakton që: autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Në procedurën e prokurimit "Blerje furnizim dhe montimi i kalldas me qiler në QMF-1" në vlerë 62,062€, komuna me rastin e përcaktimit të specifikave në dosjen e tenderit, tek pjesa B, pozicioni 1, ishin përdorur marka tregtare apo emra të prodhuesit MECO për ventilatorët-konvektorëve, pa përdorur edhe termin të ngjashëm, duke përdorur kriterë favorizuese	Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive tek njësitë kërkuese dhe zyrën e prokurimit me qëllim që gjatë hartimit të specifikave teknike të mos përdoren kriterë favorizues për të siguruar që procedurat e prokurimit zhvillohen në pajtim me ligjin.	Drejtorja e Prokurimit bazuar në Ligjin e prokurimit publik nr. 04/L-042, neni 28, pika 2, përcakton që: autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.	Prokurimi	2025 - 2026	

		të cilat kishin eliminuar konkurrencën.		E zbatuar			
8.	Çështja C1 - Mos inspektimi i 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë	Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 15, parasheh se: "Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës". Komuna gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur të bëjë inspektimin apo verifikimin e së paku 20% të pronave të regjistruara brenda territorit të Komunës, mirëpo brenda vitit kishte bërë inspektimin e vetëm 9.5% të pronave të përgjithshme	Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktivitetëve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Pajtohemi me rekomandim mirpo ne kemi inicuar menjëher një kërkesë përtender dhe po sa ta zgjedhim autoritetin kontraktues do e realizojmë rekomandimin e dhënë. Pjesërisht e zbatuar	Finan cat	2026	
9.	Çështja B7 - Mos pagesa e rregullt e qirasë nga shfrytëzimi i pronave publike	Kontrata e qirasë, pika 7.1 specifikon se, nëse qiramarrësi dështon të paguajë obligimet e papaguara, apo dështon në zbatimin kushteve të kontratës, atëherë qiradhënësi e njofton qiramarrësin për mos përmbushjen, dhe nëse qiramarrësi nuk e përmirëson dështimin brenda 15 ditëve, atëherë kontrata qirasë automatikisht do të konsiderohet se ka përfunduar. Gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme për shfrytëzimin e pronave publike të Komunës, kemi identifikuar mangësi në menaxhimin e kontratave me qiramarrësit si në vijim: Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00127-0,	Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë që janë vendosur kontrole efektive për monitorimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim. Gjithashtu, për qiramarrësit të cilët nuk përmbushin kushtet e kontratës të marrë veprimet e nevojshme ligjore për mbledhjen të qirasë së pa arkëtuar nga komuna dhe të shqyrtoj mundësinë e ndërprerjes së kontratës nëse kemi të bëjmë me një shfrytëzues të	Drejtoria gjegjëse ka marrur hapat e veprimit lidhur me obligimet e papaguara, dhe me kohë sipas kushteve të kontratave të qiradhenjes do ndermirren hapat ligjor sipas marrveshjes. Pjesërisht e zbatuar	Drejt oria e Kada strit	Dhjet or- 2025 - 2026	

	për aktivitete afariste 90m2, e nënshkruar në 02.02.2017 me afat të shfrytëzimit për shtatë (7) vite dhe me qira mujore 1,000€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës, qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 30,000€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00209-0, për aktivitete bujqësore 23.45ha e cila gjendet në fshatin Gracë, e nënshkruar në 02.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira vjetore 7,070€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 5,411€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00492-0, për aktivitete bujqësore 11.97ha e cila gjendet në fshatin Balincë, e nënshkruar në 01.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira vjetore 898€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 4,118€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00492-0, për aktivitete bujqësore 8.85ha e cila gjendet në zonën kadastrale në Dobërlukë, e nënshkruar në 31.10.2016 me	pandërgjegjshëm në respektimin e kontratës.				
--	---	--	--	--	--	--

		afat të shfrytëzimit për 10 vite dhe me qira vjetore 974€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 2,016€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokën për afarizëm e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00653-0, për aktivitete afariste 13m2 e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 01.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 5 vite dhe me qira mujore 132€. Si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,860€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afarist i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-2254/49, për aktivitete afariste 16m2 e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 03.02.2016 me afat të shfrytëzimit për 5 vite dhe me qira mujore 32€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,504€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-412-1, për aktivitete afariste 3.24ha e cila gjendet në fshatin Lum Madh, e nënshkruar në 15.03.2016 me afat të shfrytëzimit për 3 vite dhe me qira vjetore 583€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh				
--	--	---	--	--	--	--

		ndaj komunës 1,458€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-1108/19, për aktivitete afariste 8.61m² e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 04.12.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira mujore 34€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,284€; - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00001-1, për aktivitete afariste 25.2m² e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 04.12.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira mujore 73€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 369€.					
10.	Çështja B8 - Mangësi në monitorimin e raportimeve nga përfituesi i subvencionit	Marrëveshja e mirëkuptimit për financim të përbashkët në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe KBI Vushtrri, nën 2 pika 2.2 përcakton që, KBI obligohet që t'i dërgoj komunës së Vushtrrisë raport mujor në fillim të çdo muaji lidhur me progresin e marrëveshjes. Po ashtu, me marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide, nën 2 pika 2.1 ndër tjera specifikon se e njëjta do të dëshmoj faturat të shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara.	Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë që të bëhet monitorimi dhe të sigurohen raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përfituesit që nuk kanë raportuar për mjetet e shfrytëzuara të përjashtohen nga e drejta e	Ne kemi ndermarur hapat e veprimit dhe kemi njoftuar KBI Vushtrri të sjell raportet mujore sipas marrëveshjes së dakorduar. Pjesërishtë e zbatuar	Drejtoria e Administratës	Janar - Dhjetor 2025	

		Gjatë testimit të monitorimit të subvencioneve kemi identifikuar këto mangësi: - Në një mostër të subvencionimit për financim të përbashkët ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe KBI Vushtrri, me vlerë 10,000€ përfituesi nuk kishte ofruar raportet mujore të ecurisë së projektit ashtu siç parashihej me dispozitat e marrëveshjes në mes të Komunës dhe përfituesit. - Po ashtu në një mostër tjetër nga marrëveshja për financim të përbashkët në vlerë 75,368€ në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide, përfituesi nuk kishte ofruar raportet me fatura ashtu siç parashihej me dispozita të marrëveshjes. Pas përfundimit të auditimit, komuna na ka ofruar raportet me faturat përkatëse.	përfitimit të subvencioneve në të ardhmen				
11.	Çështja B9 - Dobësi në procesin e dhënies së subvencioneve për përfituesit individual	Rregullorja KKV nr.03/2023, për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare për persona fizik dhe juridik, neni 5, parasheh ndër të tjera ndihmë momentale për shërim për personat fizikë. Po ashtu, rregullorja e njëjtë, neni 6, pika 3, përcakton kriteret që duhet t'i plotësojë personi fizik përfitues, ndër të tjera: rekomandimin nga komisioni i ekspertëve i drejtorisë përkatëse bashkë me raportet mjekësore dhe diagnozën e personit dhe dëshminë mbi gjendjen e rëndë sociale të personit fizik, të verifikuar nga komisioni i	Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi dhe miratimi i kërkesave për subvencionim të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore dhe brenda fushëveprimit ligjor të komunës. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrja në procesin e vlerësimit të kërkesave për	Duke u bazuar në Rregulloren KKV nr.03/2023, do veprojmë suaza të Rregullores dhe rastet e tilla të mos përsëriten. Pjesërisht e zbatuar	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Kulturës	2025	

		drejtorisë përkatëse. Gjatë testimit të procedurave^{1a} të subvencionimit kemi identifikuar këto mangësi: - Në katër (4) raste në vlerë 18,000€, të subvencionimit për shërim të personave fizik me sëmundje të ndryshme, me vendim të Kuvendit Komunal, përfituesit nuk i kishin plotësuar kriteret e parapara me rregullore, pasi që dosjeve u mungonte rekomandimi nga komisioni i eksperteve të drejtorisë përkatëse dhe dëshmia e gjendjes së rëndë sociale. Për më tepër, në dy raste në vlerë 10,000€, subvencionimi ishte bërë për trajtim jashtë vendit, jo në përputhje me rregulloren e brendshme e cila parasheh vetëm ndihmë momentale për shërim. Trajtimi i pacienteve jashtë vendit është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë përmes Fondit për Sigurime Shëndetësore, bazuar në Ligjin nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor, përkatësisht Udhëzimin administrativ (MSH) nr. 03/2023 për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike. - Në një rast të subvencionimit në vlerë 3,000€ për ndihmë momentale për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, përfituesit i mungonte dëshmia e gjendjes së rëndë sociale.	të parandaluar miratimin e ndihmave në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ose për qëllime që tejkalojnë kompetencat e komunës				
--	--	--	---	--	--	--	--

12.	Çështja A3 - Mospërdorim i modulit në E-prokurim për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontraktuesve	Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që: "Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve". Më tutje, sipas nenit 70.24: "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modul për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik". Në dy (2) kontrata në vlerë 2,844,197€, menaxherët e kontratave nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modul përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.	E zbatuar			
13.	Çështja B10 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale	Rregullorja 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23, "Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar	Rekomandimi B10 Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar,	Duke u bazuar në LPP dhe Rregullorja 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23, "Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori	Drejtoria e Prokurimit	2025 - 2026	

	afatet kohore të realizimit të kontratave". Kontrata, nenit 1.3 përkatësisht 1.5 përcakton që: përfundimi i të gjitha punëve do të duhej të kryheshin brenda viti 2024. Ne kemi vërejtur se në kontratat e listuara më poshtë, kishte vonesa në realizimin përtej afatit të përcaktuar të përfundimit të punimeve: - Kontrata "Ndërtimi i rrugës Bekim Berisha Abeja dhe rrugës Vëllezërit Feka" në vlerë 778,251€, e lidhur më 25.08.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024 kontrata ishte realizuar vetëm 67%; - Kontrata "Ndërtimi i rrugës Lumni Surdulli" në vlerë 685,260€, e lidhur më 25.08.2023 e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 79%; - Kontrata "Ndërtimi i rrugës Avni Saraçi dhe rrugën Vicianë" në vlerë 250,019€, e lidhur më 25.08.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 75%; - Kontrata "Ndërtimi i kanalizimit Lot	përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.	ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. E zbatuar			
--	--	--	---	--	--	--

		3" në vlerë 579,485€ e lidhur më 17.07.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 88%.					
14.	Çështja A4 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim	përcakton që: "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi". Në tetë (8) mostra në vlerë 657,981€, pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2020, për të cilat nuk është bërë ende pranimi teknik, figurojnë në regjistër si investime në vijim, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, ne nuk kemi mundur të kalkulojmë vlerën e gabimit të zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit të pasurisë në PFV.	Rekomandimi A4 Kryetari duhet të fortojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.	Drejtoria e Financave qdo herë ka pasur parasysh procesin e investimit të pasurisë mirpo shumica e projekteve realizohen në fund të vitit fiskal dhe do kërkoj zgjatjen e afatit në sistem për finalizimin e tyre E zbatuar	Drejtoria e financave	Dhjetor 2025 - Janar 2026	
15.	Çështja B11 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme	Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 27 përcakton që: "Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas	Rekomandimi B11 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa	Pjesërisht e zbatuar	Drejtoria e shërbimeve publike	2025 - 2026	

		ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori". Po ashtu, Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrisë, neni 7, pika 3, përcakton se "Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave, për çdo muaj të vitit ose me këste. Më tutje, Vendimet përkatëse të nxjerra nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, përcaktojnë afatet e pagesave të kësteve për leje ndërtimore. Llogaritë e arkëtueshme, në krahasim me vitin 2023, kanë shënuar rritje për 15.45%, apo 998,282€. Rritja kishte ndodhur te tatimi në pronë 33% dhe taksa për grumbullimin e mbeturinave 17%. Në 19 raste të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 275,451€, në nëntë (9) raste të lejeve ndërtimore në vlerë 349,473€ dhe në 13 raste të taksës për grumbullimin e mbeturinave në vlerë 3,902€ komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbaruesit për mbledhjen e këtij borxhi, edhe pse ishte tejkaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe afati në shkresat për rikujtimin e borxhit.	përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori". Po ashtu, Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrisë, neni 7, pika 3, përcakton se "Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave, për çdo muaj të vitit ose me këste. Më tutje, Vendimet përkatëse të nxjerra nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, përcaktojnë afatet e pagesave të kësteve për leje ndërtimore.					
--	--	---	--	--	--	--	--	--

Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve.

- Së bashku me Kryesuesen e Kuvendit të Komunës do të harmonizojmë agjendën e takimit për shqyrtimin e Raportit të Auditimit në mbledhjen e radhës së Kuvendit (gjatë muajit Korrik);
- Deri në fund të muajit janar 2026, do të diskutoj në Kuvendin e Komunës për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2024 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transereve; dhe
- Po ashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Vushtrri,

Data 02.03.2026

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës

NUMER I KRYETARIT - KRYETARISHTI
KOMUNA E VUSHTRRISE
No. / Ser. 9350126
- 17 -
Data / Shprehje 04.03.2026
VUSHTRRI - VUSHTRIAN



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Data/Date:Datum	04.03.2026
Për/To: Za	Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal
Përmes :	Kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi
Nga:	znj. Hyrije Uka – Hoxha H. Uka Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
Lënda/Subject/:Subjekat	Informatë lidhur me shërbimet e ofruara për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Të nderuar/a,

Bashkangjitur gjeni informatën lidhur me shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme për periudhën **janar – dhjetor 2025**.

Me respekt,



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Informatë lidhur me shërbimet e ofruara për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Drejtoria për Administratë është një nga drejtoritë kyçe të Komunës së Vushtrrisë dhe përfaqëson një shtyllë të rëndësishme të funksionimit institucional. Detyra e saj kryesore është të sigurojë funksionimin e rregullt, efikas dhe transparent të shërbimeve administrative për qytetarët, bizneset dhe institucionet komunale, duke garantuar që çdo proces të zhvillohet në përputhje me legjislacionin dhe standardet e qeverisjes së mirë.

Në kuadër të kompetencave të saj, Drejtoria ofron shërbime të përgjithshme administrative dhe shërbime direkte për qytetarët; menaxhon sistemet e teknologjisë informative, logjistikën dhe furnizimet; si dhe ofron mbështetje të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale në ushtrimin e funksioneve të tyre ligjore. Një rol i rëndësishëm i kësaj drejtorie është edhe promovimi i të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse në nivel institucional.

Drejtoria e Administratës synon të ofrojë shërbime moderne, të qasshme dhe të standardizuara, duke avancuar digjitalizimin e proceseve, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimin e komunikimit me qytetarët. Përkushtimi i saj është orientuar drejt krijimit të një administrate efikase, të besueshme dhe transparente.

Një ndër shtyllat kryesore të punës së Drejtorisë është administrimi efikas i dokumentacionit zyrtar në komunë, duke përfshirë pranimin, regjistrimin, përpunimin, ruajtjen, arkivimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, si dhe zbatimin e standardeve të transparencës dhe menaxhimit të informacionit. Në këtë kuadër, Drejtoria bashkëpunon ngushtë me të gjitha drejtoritë komunale, duke garantuar koordinim institucional, qartësi procedurale dhe ofrim cilësor të shërbimeve.

Për realizimin e funksioneve të saj, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori për Gjendje Civile
2. Qendra për Shërbim me Qytetarë
3. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore
4. Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative
5. Sektori për Logjistikë dhe Furnizim

Objektivat strategjike të Drejtorisë për vitin 2025

Objektivat e përgjithshme strategjike të Drejtorisë së Administratës për vitin 2025 kanë qenë:

1. Ofrimi i shërbimeve administrative kualitative, të qasshme dhe të bazuara në procedura administrative të arsyeshme, duke përdorur metodat e e-qeverisjes dhe duke i orientuar shërbimet ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve.

2. Arkivimi elektronik dhe digjitalizimi i arkivit komunal, si pjesë e procesit të modernizimit të administratës dhe përmirësimit të menaxhimit të dokumentacionit zyrtar.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria ka avancuar në mënyrë të konsiderueshme proceset administrative dhe digjitalizimin e shërbimeve, përmes realizimit të disa aktiviteteve të rëndësishme, përfshirë:

- Zyrtarizimin dhe përdorimin e mbështjellësve të lëndëve (për herë të parë në vitin 2025)
- Arkivimin elektronik dhe përdorimin e sistemit SMAED (për herë të parë në vitin 2025)
- Implementimin dhe zbatimin e udhëzuesve dhe rregullave të brendshme të hartuara nga institucionet e komunës (për herë të parë në vitin 2025)
- Administrimin elektronik të dokumenteve, duke përdorur sistemin elektronik, INTRANET dhe sistemin SMAED (për herë të parë në vitin 2025)
- Implementimin e politikave për backup dhe ruajtje të sigurt të dokumenteve

Bashkëpunimi ndërkombëtar – Projekti “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal”
Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Administratës ka zhvilluar dy takime pune me delegacionin e Komunës së Växjö-s (Suedia), në kuadër të projektit të përbashkët “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal”. Ky projekt do të zgjasë tre (3) vite dhe synon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy komunave për avancimin dhe standardizimin e procedurave të arkivimit dhe digjitalizimit të dokumentacionit.

Pas tri (3) takimeve të realizuara (një në Komunën e Vushtrrisë dhe dy në Komunën e Växjö-s), janë marrë përvoja të vlefshme dhe disa prej tyre janë integruar në akte administrative dhe procedura të reja, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të dokumentacionit zyrtar në nivel komunal.

Gjatë kësaj periudhe, janë shqyrtuar dhe është dhënë përgjigje për të gjitha kërkesat e palëve brenda afateve të përcaktuara ligjore, si dhe janë lëshuar vendime dhe autorizime të shumta, në përputhje me procedurat administrative dhe kërkesat e ligjit.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit dhe qasjes më të mirë ndaj qytetarëve, gjatë muajve të verës është ofruar shërbim i veçantë për bashkëatdhetarët. Për këtë qëllim janë caktuar tre (3) sportele të veçanta për shërbimin e mërgimtarëve, me synim ofrimin e shërbimit më të shpejtë dhe më efikas për bashkëatdhetarët e komunës.

Po ashtu, me vendim të Kryetarit të Komunës, Zyra e Gjendjes Civile ka filluar të punojë edhe të shtunave, në orarin 10:00 – 14:00, si dhe gjatë kohës së pushimit, me qëllim të përmirësimit të aksesit dhe lehtësisë të shërbimit për qytetarët, në veçanti për bashkëatdhetarët që frekuentojnë shërbimet në periudhën e verës.

Aktivitetet kryesore të realizuara në kuadër të funksioneve të Drejtorisë (2025)

Gjatë periudhës së raportuar janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Vendosja e mbishkrimeve në objektin e komunës (në hyrje për palë dhe në hyrjen zyrtare)
- Vendosja e tabelës së shpalljeve

- Renovimi dhe funksionalizimi i tualeteve
- Libërlidhja e akteve dhe dokumenteve të ndryshme
- Libërlidhja e protokollit të komunës për vitin 2024

Si dhe procedurat e rregullta për furnizime, përfshirë:

- Furnizim me inventar për Drejtorinë e Administratës
- Furnizim me klima për zyrat e reja
- Furnizim me karburant për gjenerator
- Furnizim me dokumente bllanko për Gjendjen Civile
- Furnizim me material zyrtar
- Furnizim me ujë
- Mirëmbajtja e pajisjeve të skanimit dhe printimit
- Mirëmbajtja e ashensorit
- Rregullimi i ngrohjes qendrore
- Servisimi i aparateve kundër zjarrit
- Dezinfektimi dhe deratizimi i objektit të komunës

Përfundim i pjesës hyrëse

Nëpërmjet angazhimit të stafit dhe koordinimit institucional, të gjitha objektivat strategjike të Drejtorisë së Administratës janë realizuar në mënyrë të suksesshme, pavarësisht sfidave buxhetore që janë hasur gjatë vitit 2025. Me përkushtim dhe menaxhim të kujdesshëm, Drejtoria ka arritur të sigurojë shërbime cilësore, të qasshme dhe të standardizuara për qytetarët dhe institucionet, duke ruajtur në të njëjtën kohë transparencën dhe efikasitetin në funksionimin e administratës komunale. Në vijim të këtij raporti, paraqiten raportet e detajuara për secilin sektor, me aktivitete, rezultate, sfida dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

Sektori i Gjendjes Civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 ka ofruar të gjitha shërbimet që janë në kompetencë dhe që kryhen në këtë zyrë, trendi i ngritjes së efikasitetit dhe ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit, profesionalizmin dhe punën që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesin e digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendes civile dhe harmonizimin e procedurave në ofrimin e Shërbimeve, lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile.

Në bazë të të dhënave, numri i lindjeve të banorëve rezidentë me vendbanim në Komunën e Vushtrisë, por që kanë lindur jashtë territorit të Komunës së Vushtrisë në vitin 2025 është 890 lindje.

Ka vazhduar bashkëpunimi me Agjencinë Kadastrale e Kosovës lidhur me ndërlidhjen dhe përditësimin e adresave të të gjithë qytetarëve në regjistrat përkatës, me qëllim të saktësimit dhe harmonizimit të të dhënave të vendbanimit.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të tjera: 45365

100% 100% 100%

1.	Anulim i regjistrimit të lindjes	28
2.	Anulim i vendimit nga DA dhe shfuqizim i vendimit	02
3.	Korrigjim i të dhënave personale në RL	69
4.	Korrigjim i të dhënave personale në RM	04
5.	Korrigjim i të dhënave personale në RV	03
6.	Korrigjim i të dhënave të arkivuara në RL	27
7.	Dëshmi të vdekjes	565
8.	Lajmërimi të adresës së vendbanimit dhe në Ekosova	44278
9.	Korrigjim i të dhënave të arkivuara në RV	01
10.	Ndrrim i emerit personal	77
11.	Refuzim-per ndrrimin e emrit personal	01
12.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë)	218
13.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	16
14.	Regjistrim i mevonshëm i lindjes	07
15.	Regjistrim i mevonshëm i vdekjes	69
Gjithsej regjistrime të bëra		45365

Numri i dokumenteve të lëshuara: 67283

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	28764
2.	Certifikata të lindjes	13445
3.	Certifikata të martesës	5770
4.	Certifikata të vdekjes	2182
5.	Certifikata të Statusit martesor	1080
6.	Certifikata të shtetësisë	2032
7.	Certifikata familjare	4448
8.	Certifikata të vendbanimit	5823
9.	Vërtetim nga arkivi	3739
Gjithsej		67283

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile; 1895

1.	Regjistrime të lindjes	335
2.	Martesa	577
3.	Regjistrime të vdekjes	373
4.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	352
5.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	108

6.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	41
7.	Shkurorëzime	109
Gjithsejtë regjistrime të bëra		1895

Shërbimet online nga eKosova: 25495

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	11130
2.	Certifikata të lindjes	10703
3.	Certifikata të martesës	3209
4.	Certifikata të vdekjes	453
Totali		25495

Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Qendra për Shërbim të Qytetarëve (QSHQ) në kuadër të Drejtorisë së Administratës të Përgjithshme, gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025, ka ofruar shërbime të vazhdueshme dhe efikase për qytetarët, duke garantuar informim korrekt, trajtim administrativ profesional dhe menaxhim të rregullt të dokumentacionit zyrtar.

Qendra për Shërbim të Qytetarëve (QSHQ), ka asistuar qytetarët në:

- Ofrimin e informatave lidhur me procedurat administrative;
- Ndihmën në përpilimin e kërkesave;
- Regjistrimin dhe protokollimin e kërkesave;
- Përcjelljen dhe shpërndarjen e lëndëve në drejtoritë përkatëse;
- Arkivimin fizik dhe elektronik të dokumenteve.

Përveç detyrave të rregullta, zyrtarët e QSHQ-së kanë qenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme, sipas vendimeve dhe kërkesave të eprorëve.

2. Fushëveprimi dhe Përgjegjësitë

QSHQ ushtron këto kompetenca:

- Ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët në kuadër të kompetencave vetanake dhe të deleguara;
- Zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet komunale;
- Protokollimin dhe regjistrimin e të gjitha dokumenteve hyrëse dhe dalëse;
- Gjenerimin e numrit unik të protokollit përmes sistemit elektronik;
- Evidentimin, klasifikimin dhe ruajtjen e dokumenteve fizike dhe elektronike;
- Arkivimin sipas standardeve ligjore dhe arkivore;
- Ofrimin e shërbimeve postare për organet komunale;
- Skanimin dhe digjitalizimin e dokumenteve;
- Monitorimin e afateve të trajtimit të kërkesave.

3. Objektivi Strategjike(Objektivi i Përgjithshëm):

Të sigurohet administrimi, menaxhimi dhe arkivimi efikas, ligjor dhe i digjitalizuar i dokumenteve komunale, me qëllim rritjen e transparencës, sigurisë së informacionit dhe cilësisë së shërbimeve.

Objektivat Specifike

3.1 Përmirësimi i administrimit të dokumenteve

- Regjistrimi i saktë dhe në kohë i dokumenteve;
- Klasifikimi sipas llojit dhe rëndësisë;
- Qarkullimi i kontrolluar ndërmjet drejtorive;
- Monitorimi i afateve dhe respektimi i procedurave.

3.2 Digjitalizimi dhe arkivimi elektronik

- Digjitalizimi i arkivit fizik;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e arkivit elektronik;
- Përdorimi i sistemeve elektronike (INTRANET dhe SMAED);
- Reduktimi i përdorimit të dokumenteve fizike;
- Sigurimi i qasjes së kontrolluar në dokumente.

3.3 Siguria dhe ligjshmëria

- Zbatimi i legjislacionit në fuqi;
- Respektimi i afateve të ruajtjes së dokumenteve;
- Mbrojtja e të dhënave personale;
- Bashkëpunimi me institucionet relevante.

4. Realizimet Kryesore gjatë Vitit 2025

- Libërlidhja e protokollit për vitin 2024;
- Përdorimi i mbështjellësve të lëndëve (për herë të parë);
- Implementimi i sistemit SMAED dhe arkivimit elektronik;
- Zbatimi i rregullave të brendshme administrative;
- Implementimi i politikave për backup dhe ruajtje të sigurt të dokumenteve;
- Digjitalizimi i 560 lëndëve gjatë periudhës raportuese.

5. Treguesit Kryesorë të Përformancës për Vitin 2025

Gjatë vitit 2025 janë pranuar dhe procesuar:

65,402 kërkesa administrative

Drejtoritë me numrin më të madh të kërkesave kanë qenë:

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme – 43,765
- Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër – 9,222
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – 2,598
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa – 2,007

Këto shifra dëshmojnë për një volum të lartë pune dhe përgjegjësi të konsiderueshme të Qendrës për Shërbim të Qytetarëve.

Tabela e më poshtme përshkruan numrin e kërkesave të parashtruara sipas drejtorive komunale.

Nr.	Pershkrimi	Nr. Kërkesave
1	Kuvendi Komunal	150
2	Kryetari i Komunës	990
3	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	444
4	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	43765
5	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	725
6	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2007
7	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2598
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	992
9	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	390
10	Drejtoria për Arsimit	750
11	Drejtoria për Shërbime Publike	772
12	Zyra Lokale e Komuniteteve	3
13	Drejtoria për Inspeksion	903
14	Drejtoria e Prokurimit	18
15	Zyra Ligjore	6

16	Njësia e Auditimit të Brendshëm	5
18	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	9222
20	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	1453
21	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	209
		65402

6. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Në kuadër të projektit “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal” (2024–2026), është realizuar bashkëpunim me komunën Växjö, të shtetit të Suedisë.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar dy takime pune me delegacionin suedez, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe avancimin e standardeve të arkivimit digjital.

7. Digjitalizimi dhe Modernizimi

Gjatë vitit 2025 janë realizuar për herë të parë:

- Implementimi i sistemit elektronik SMAED;
- Arkivimi elektronik i dokumenteve;
- Përdorimi zyrtar i mbështjellësve të lëndëve;
- Implementimi i akteve të brendshme të hartuara nga Komuna, që rregullojnë funksionimin e një administratës transparente dhe digjitale,
- Libërlidhja e protokollit për vitin 2024;
- Skanimit i të gjitha kërkesave/parashtresave dhe bashkëngjitja në sistemin elektronik(INTRANET),
- Implementimi i politikave për backup dhe ruajtje të sigurt të të dhënave.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me Växjö, Suedia, janë zhvilluar edhe dy takime pune në kuadër të projektit trevjeçar për digjitalizimin e arkivit komunal.

8. Qendra e Thirrjeve

Qendra e Thirrjeve, është themeluar në vitin 2018 nga Komuna e Vushtrrisë, gjatë vitit 2025 ka regjistruar:

- 1,311 telefonata
- Mesatarisht 5 thirrje në ditë pune
- 810 qytetarë të informuar drejtpërdrejt
- 156 kërkesa të procesuara pa pasur nevojë për prezencë fizike

Kjo dëshmon rritjen e shërbimeve në distancë dhe lehtësimin e barrës administrative për qytetarët.

Përmbledhja e thirrjeve të pranura sipas drejtorive:

Zyra e Kryetarit	54
Drejtorja e Administratës së përgjithshme	135
Drejtorja për Urbanizëm	38
Drejtorja për Shërbime Publike	98
Drejtorja e Inspektoriatit	97
Drejtorja për Kadastër	16
Drejtorja për Arsim	45
Drejtorja për shëndetësi	50
Drejtorja për kulturë, rinë dhe sport	12
Drejtorja për bujqësi	39
Drejtorja për prokurim	6
Drejtorja për buxhet dhe financa	216
Zyra për kthim dhe komunitet	1
Komuna nuk është kompetente	74
Zyra Ligjore	0
Zyra për informim	0
Qendra e zjarrfikësve	146
Sekretaria e Kuvendit Komunal	4
Personeli	75
Drejtorja për mbrojtje dhe shpëtim	112
Qendra për pajisje me dokumente të identifikimit	83
Totali	1311

Përfundim

Viti 2025 ka qenë vit i konsolidimit administrativ dhe i fillimit të transformimit digjital të Qendrës për Shërbim të Qytetarëve.

Pavarësisht sfidave, Qendra ka arritur të menaxhojë me profesionalizëm një numër të madh kërkesash dhe të vendosë themelet e një administrate moderne, efikase dhe transparente.

Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Bazuar në planin vjetor të Sektorit për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, paraqitet kjo informatë për realizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e objektivave të planifikuara për vitin 2025.

1. Fushëveprimi i sektorit

Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative është përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të teknologjisë informative të administratës komunale, përfshirë:

- Administrimin e serverëve dhe rrjetit LAN;
- Implementimin e politikave të sigurisë së TI-së;
- Mirëmbajtjen dhe administrimin e ueb-faqes zyrtare të komunës dhe bazave të të dhënave;
- Instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe softuerëve;
- Mbështetjen teknike për stafin;
- Ofrimin e shërbimeve të përkthimit dhe lekturës;
- Administrimin e depos dhe mirëmbajtjen teknike të objektit komunal.

2. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete kryesore:

- 36 veprime në administrimin e sistemeve të TI;
- 24 instalime dhe përditësime të sistemeve operative;
- 301 instalime, konfigurime dhe zgjidhje të problemeve softuerike;
- 328 raste të mbështetjes për shfrytëzimin e resurseve të TI;
- 200 ndërhyrje për zgjidhje të problemeve teknike;
- 17 postime dhe mirëmbajtje të ueb-faqes zyrtare;
- 9 krijime të llogarive elektronike zyrtare;
- 76 shërbime përkthimi (shqip-serbisht dhe anasjelltas);
- 35 lekturime dhe konsultime gjuhësore;
- 226 veprime në administrimin e depos;
- 345 ndërhyrje për mirëmbajtje dhe riparime të objektit komunal.

Këto të dhëna dëshmojnë për një angazhim të vazhdueshëm dhe intensiv të sektorit në mbështetje të funksionimit normal të administratës komunale.

3. Përmbushja e objektivave të planit të punës

Plani i punës për vitin 2025 ka paraparë tri objektiva kryesorë:

Objektivi I: Administrimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë

Ky objektiv është përmbushur plotësisht përmes mirëmbajtjes së vazhdueshme të infrastrukturës së TI-së, garantimit të funksionalitetit të sistemeve, administrimit të rrjetit dhe serverëve, si dhe ofrimit të mbështetjes teknike për stafin.

Objektivi 2: Ofrimi i shërbimeve të përkthimit

Janë realizuar 76 shërbime përkthimi, duke siguruar komunikim të rregullt dygjuhësor në dokumente dhe takime zyrtare.

Objektivi 3: Ofrimi i shërbimeve të lekturës

Janë realizuar 35 lekturime dhe konsultime gjuhësore, duke kontribuar në cilësinë dhe standardizimin e dokumentacionit zyrtar.

Të gjitha objektivat janë arritur brenda afateve të planifikuara dhe pa kosto financiare shtesë.

5. Përfundim

Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative ka realizuar me sukses planin e punës për vitin 2025, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të sistemeve të teknologjisë informative në administratën komunale.

Pavarësisht sfidave financiare, sektori ka dëshmuar përkushtim, profesionalizëm dhe përgjegjësi të lartë në përmbushjen e detyrave të tij, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve komunale.

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, zyrtarja për barazi gjinore, dhe kundër diskriminim, zyrtarja për të drejta të njeriut dhe mbrojtje të fëmijëve, gjatë vitit 2025, kanë realizuar planin programin e punës duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin Kundër Diskriminim, Ligjin për Mbrojtje të Fëmijëve, e gjithashtu duke iu përmbajtur listës së ditëve ndërkombëtare që i kemi në kalendarin e Sektorit.

Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore me aktivitetet dhe angazhimin e tyre gjatë këtij viti kanë pasur qëllim kryesor promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, promovimin e të drejtave të fëmijëve, promovimin e të drejtave dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara, grave vetushqyese.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 SDNJBGJ; ZBGJ; ZDNJ dhe ZMF, për realizimin e qëllimeve të lartshënuara kanë mbajtur, aktivitete të ndryshme si shënimi i datave të rëndësishme për të drejtat e njeriut, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara; kemi organizuar tryeza të diskutimit, kemi qenë pjesëmarrës në disa tryeza të organizuar nga institucionet dhe organizatat tjera qoftë në cilësinë si penalistë qoftë si pjesëmarrës të tyre, kemi pasur takime të ndryshme me OJQ vendore dhe ndërkombëtare; kemi pasur vizita në shkollat e komunës dhe institucione të

ndryshme, kemi qenë pjesëmarrës në trajnime dhe punëtori të ndryshme të organizuara nga institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kemi qenë pjesëmarrëse në konferencën Zyrtarja për barazi gjinore, sipas detyrës zyrtare ka marr pjesë në mbledhjet e kuvendit komunal, të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje, komisionit komunal për riatdhesim, zyrtarja për të drejta të fëmijëve është pjesë e Ekipit Komunal për mbrojtjen e Fëmijës, komisionit për parandalimin e braktisjes së shkollës, janë pjesë e disa komisioneve të caktuara nga kryetari i komunës, drejtoresha e administratës, drejtorja e prokurimit etj. Gjithashtu në kuadër të komisionit për shqyrtimin e ankesave nga dëmet prej vërshimeve ose zjarrit kemi shqyrtuar 25 ankesa. Zyrtarja për Barazi gjinore edhe këtë vit ka raportuar për performanën e komunës nga fusha e çështjeve gjinore.

Shkurtesat:

SDNJBZ- Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinoree

ABGJ- Agjencia për Barazi Gjinore

APK- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

KKSB- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

MIKDDHF- Mekanizmi Komunal Kundër Dhunës në Familje

ZBGJ- Zyrtar/e për Barazi Gjinore

ZDNJ- Zyrtari për Drejta të Njeriut

ZMF- Zyrtari për Mbrojtje të Fëmijës

MAPL- Ministria e Administratës të Pushtetit Lokal

ZKQM- Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë

KKKR- Komisioni Komunal për Kthim dhe Riatdhesim

QKRMT- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës

KZBGJ- Kolegjiumi i Zyrtareve për Barazi Gjinore

ZLKKR- Zyra Lokale për Komunitete Kthim dhe Riatdhesim

ZKKR- Zyrtari Komunal për Kthim dhe Riatdhesim

MBLEDHJE (Pjesëmarrje në trupa dhe komisione)

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur dhe janë ndjekur rregullisht këto mbledhje:

- Mbledhjet e **KKKR** (Komiteti Komunal për Komunitete dhe Riatdhesim) – me shqyrtim të rasteve të riatdhesimit dhe çështjeve të komuniteteve.
- Mbledhjet e **KKSB**.
- Mbledhja e **MKDDHF**.

- Mbledhjet e **KZBGJ** (Kolegiumi për Barazi Gjinore).
- Mbledhjet e rregullta me **ABGJ** (Agjencia për Barazi Gjinore).
- Dëgjimet buxhetore.
- Konsultime publike për Rregulloren për Transparencë dhe Planin Zhvillimor Komunal.
- Mbledhje dhe takime pune me drejtoreshën e administratës lidhur me koordinimin e aktiviteteve vjetore.

2. TRAJNIME DHE PUNËTORI

Gjatë vitit janë ndjekur dhe organizuar trajnime në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe fuqizimit institucional:

- Trajnimi nga **BIRN** mbi strategjinë për parandalimin e terrorizmit.
- Punëtoritë e organizuara nga **ABGJ** për Planet e Veprimit të ZBGJ.
- Seminar nga **QKRMT** (Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës) për adresimin e stigmës.
- Trajnime nga **ZKQM** për raportim dhe parandalim të diskriminimit.
- Punëtori nga **HELVETAS & DEMOS** për integrimin gjinor.
- Trajnime nga **Asociacioni i Komunave të Kosovës**.
- Trajnim nga **MAPL** për kohezion shoqëror dhe të drejtat e pakicave.
- Trajnime nga **OSBE** për leadership transformues.
- Trajnime nga **UNDP** (menaxhimi i ciklit të projektit dhe demokracia lokale).
- Trajnim nga **Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)** për hartimin e dokumenteve strategjike.
- Trajnime për nxënës të shkollave të mesme në bashkëpunim me organizatën **SIT**.
- Trajnim për marketing online për gratë fermerë.
- Trajnime për parandalimin e gjuhës së urrejtjes.

3. ORGANIZIME DHE AKTIVITETE VETËDIJËSUESE

Shënime të Ditëve Ndërkombëtare:

- 8 Marsi – Dita Ndërkombëtare e Gruas
- 21 Marsi – Dita Botërore e Sindromës Down
- 2 Prilli – Dita e Autizmit

- 8 Prilli – Dita Ndërkombëtare e Romëve
- 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
- 23 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Shërbyesve Civil
- 30 Gushti – Dita për Personat e Zhdukur me Dhunë
- 15 Shtatori – Dita Ndërkombëtare e Demokracisë
- Tetori Rozë – Fushata kundër kancerit të gjirit
- 11 Tetori – Dita Ndërkombëtare e Vajzave
- 16 Tetori – Dita e Mundësive të Barabarta
- 10 Dhjetori – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut
- 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjimore

Fushata dhe aktivitetet:

- Fushatë kundër dhunës në shkolla.
- Ligjërata kundër trafikimit me qenie njerëzore.
- Ligjërata kundër dhunës në familje (në bashkëpunim me Policinë e Kosovës).
- Organizimi i tryezës: “Realizimi i të drejtave të njeriut pas Pavarësisë së Kosovës”.
- Organizim i diskutimeve me nxënës për demokracinë dhe rolin e Këshillit të Nxënësve.
- Aktivitet për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Projekt për pikturimin e repartit të pediatrikë.
- Fushata për barazi gjimore dhe fuqizim të vajzave.
- Shpërndarja e 274 serrave (174 për gra) si praktikë suksesi për fuqizimin ekonomik të grave.

4. TAKIME DHE BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE

Gjatë vitit janë realizuar takime dhe bashkëpunime me:

- Drejtorinë e Administratës.
- Drejtorinë e Arsimit.
- Policinë e Kosovës.
- Përfaqësues të komuniteteve rom, ashkali dhe komuniteteve tjera.
- OJQ-të: “Martirët e Lirisë”, “Drita Jonë”, “ATO”, “ORDA”.

- Handikos.
- Kryqin e Kuq të Kosovës – dega Vushtrri.
- Caritas Zvicern.
- Delegacion nga Suedia.
- Ambasadën Amerikane.
- KFOR-in sloven.
- Organizata ndërkombëtare si OSBE dhe UNDP.

5. RAPORTIME, PYETËSORË DHE DOKUMENTE ZYRTARE

Gjatë vitit janë përgatitur dhe dorëzuar:

- Plan i Punës 2025 dhe raporti vjetor 2024.
- Raporti 6-mujor dhe raporti vjetor i punës.
- Plotësim i pyetësorëve për:
 - ABGJ
 - MAPL
 - ZKQM
 - OSBE
 - Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit
 - Integritet Evropian
- Korniza kundër diskriminimit.
- Të dhëna për performancën komunale (me bazë gjinore).
- Kontribute për subvencionimin e grave fermere.

6. VIZITA NË TERREN DHE PUNË ME PALË

- Vizita në 15 shkolla fillore dhe të mesme.
- Vizita në komunitetin rom dhe familje të riatdhesuara.
- Takime me gra fermere.
- Vizita në QPS.

- Vizita në repartin e gjinekologjisë dhe pediatrië.
- Punë me palë viktime të dhunës në familje.
- Takime me palë të kthyer nga mërgimi.

PËRFUNDIM

Përmes aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2025, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjimoree ka kontribuar në fuqizimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Komunën e Vushtrisë. Aktivitetet e realizuara kanë ndikuar në rritjen e ndërgjegjësisimit publik, përfshirjen e grupeve të ndjeshme dhe avancimin e barazisë dhe gjithëpërfshirjes në nivel lokal.

- Mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- Fuqizimin e grave dhe komuniteteve
- Parandalimin e diskriminimit dhe dhunës
- Rritjen e transparencës dhe performancës komunale

Përfundim

Vlen të theksohet se gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, Drejtoria për Administratë ka dëshmuar përkushtim të lartë institucional në ofrimin e shërbimeve administrative efikase, transparente dhe të qasshme për qytetarët e Komunës së Vushtrisë. Krahas përmbushjes së obligimeve ligjore, janë ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të digjitalizimit të proceseve, përmirësimit të infrastrukturës, rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe forcimit të bashkëpunimeve me akterë vendorë e ndërkombëtarë.

Bashkëpunimi me Komunën e Vaxjës nga Suedia për digjitalizimin e arkivit, hartimi i akteve administrative, ridizajnimi i qendrave të shërbimit dhe avancimi i sistemit të teknologjisë informative janë vetëm disa nga iniciativat e rëndësishme që kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Pavarësisht sfidave buxhetore dhe të menaxhimit të burimeve, Drejtoria ka arritur të realizojë të gjitha objektivat strategjike të përcaktuara për këtë periudhë, duke siguruar vazhdimësi në ofrimin e shërbimeve dhe në proceset e brendshme administrative. Kjo dëshmon se me planifikim të kujdesshëm, koordinim institucional dhe angazhim profesional, janë arritur rezultate konkrete dhe të matshme.

Unë, si Drejtoreshë e Administratës, jam thellësisht mirënjohëse dhe falënderuese ndaj stafit tim për punën, përkushtimin dhe profesionalizmin që kanë treguar në çdo detyrë të kryer gjatë kësaj periudhe. Ky raport është dëshmi e qartë e përpjekjeve të përbashkëta për ndërtimin e një administrate moderne dhe në shërbim të qytetarit.

Në përfundim, garantojmë se Drejtoria për Administratë do të vazhdojë të ofrojë shërbime efikase dhe efektive për të gjithë qytetarët, duke ruajtur standardet e transparencës, përgjegjësisë dhe përkushtimit institucional.

Me respekt,

Hyrie Uka Hoxha

Drejtore e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme



03.03.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Datë: 13.03.2026

Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe Hartues: kryesuesja e kuvendit znj. Melihate Basholli-Latifi

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 38 të Statutit të Komunës, bazuar në propozimet e komuniteteve joshumicë në Komunën e Vushtrrisë, po ashtu duke ju përgjigjur kërkesë MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit Nr.020-98/9 datë 04.03.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më _____ 2026, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT LIDHUR ME THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit me Nr.5100/26 i datës 29.01.2026 lidhur me themelimin e Komiteti për Komunitete, si në vijim:

1.1. Ndryshohet pika 1.2, e vendimit Nr.5100/26 ashtu që në vend të z. Mentor Hasani, anëtarë i kuvendit nga radhët e subjektit politikë (PDK), emërohet z. Stefan Markovic nga subjekti politik Lista serbe, si dhe pika 1.8 në vend të z. Adem Hoti, nga komuniteti ashkali emërohet z. Bekim Çuni, nga i njëjti komunitet.

2. Pjesët tjera të vendimit bazë Nr.5100/26 i datës 29.01.2026 lidhur me themelimin e Komiteti për Komunitete, mbesin të pandryshuara.

3. Ky vendimi hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, si dhe Statutin e Komunës, Komiteti për Komunitete përbëhet nga anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe së paku një përfaqësues të secilit komunitet joshumicë që jetojnë në komunë.

Përzgjedhjet në komunitetet joshumicë për t'u propozuar në përbërjen e Komitetit për Komunitete janë bërë nga pjesëtarë të komuniteteve të tyre.

Duke ju përgjigjur kërkesë së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit Nr.020-98/9 datë 04.03.2026, e cila ka konstatuar:

Se vendimi për themelimin e Komiteti për Komunitete nuk përbën shumicën e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në komunë ashtu siç përcaktohet me nenin 53 paragrafi 53.1 të Ligjit Nr.03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale: *Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.*

Po ashtu Komitetit për Komunitete duhet të reflektojë barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi (Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 6, paragrafi 8).

Kryesuesja e kuvendit, duke marrë për bazë obligimet që burojnë nga ligji, duke respektuar afate ligjore, për rishqyrtimin dhe harmonizimin e këtij vendim me legjislacionin në fuqi, bazuar në të cekurat më sipër, i propozon Kuvendit të Komunës që ta miratojë këtë propozim - vendim si në dispozitiv, duke respektuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara me dispozitat ligjore të përmendura në arsyetimin e këtij vendimi.

Vushtrri 13.03.2026

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr.48/26 13.03.2026

DATE/DATE/DATE:	13 mars 2026
PËR/ZA/TO:	Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	znj. Melihate Basholli-Latifi Kryesuese e Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për rishqyrtimin të vendimit

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Duke ju referuar shkresës Nr.020-98/9 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit-vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë vendimi me numër të protokollit Nr.5100/26 i datës 29.01.2026 për themelimin e Komitetit për Komunitete, të cilën e kemi pranuar më datën 04.03.2026, e cila ka kërkuar që ky vendim të harmonizohet me dispozita e legjislacionin në fuqi.

Kryesuesja e kuvendit duke marrë dhe përmbushur këto obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju dërgon për rishqyrtim dhe harmonizim vendimin e cekur si më lartë.

Andaj bazuar në cekurat më lartë obligohet Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që të ndër marrë veprimet e nevojshme të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë përcjellëse ju dërgojmë vendimin dhe shkresat përcjellëse.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRIN	
Nr./Br.	5100/26
Nr./Bq./Bil.	-2-
Data:/Datum:	03.02.2026
VUSHTPRI - VUČITRIN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrin – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 12/26 03/02/2026

Bazuar në nenin 12 në lidhje me nenin 53 paragrafi 53.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përshërshme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 38 të Statutit të Komunës, bazuar në propozimet e komuniteteve joshumicë në Komunën e Vushtrrisë, duke marrë për bazë kërkesën e MAPL-së me Nr.020-702/3 e datës 26.01.2026, për rishqyrtim të vendimit nr.65277/25 i datës 30.12.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **29 janar 2026**, merr këtë:

V E N D I M **PËR THEMELIM TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Komunitete, i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- 1.1 Behar Duraku, anëtar i Kuvendit të Komunës;
- 1.2 Mentor Hasani, anëtar i Kuvendit të Komunës;
- 1.3 Gresa Muli, anëtare e Kuvendit të Komunës;
- 1.4 Fakete Dushi, anëtare e Kuvendit të Komunës;
- 1.5 Diellza Pllana, anëtare e Kuvendit të Komunës;
- 1.6 Miljan Bojković, përfaqësues i komunitetit serb;
- 1.7 Fahrije Burgazi, përfaqësuese e komunitetit rom;
- 1.8 Adem Hoti, përfaqësues i komunitetit ashkali;
- 1.9 Berat Maloku, përfaqësues i komunitetit turk.

2. Komiteti për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përshërshme dhe Komiteteve tjera Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera si dhe rregulloren e punës.

3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të komunës, përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet në mbledhjen e parë të komitetit, me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjedhet nga radhët e komuniteteve joshumicë.


6. Anëtarët e Komitetit për Komunitete, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e Komitetit për Komunitete si dhe Zyra për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

8. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunitetit Vuahutrisë Melihale Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunitetit Vuahutrisë
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunitet
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunitetit dhe Akteve të Kryetarit Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunitetit
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari i hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim

Data:
13.02.2026
VI-023-98

Indentuar Kryetar,
Indentuar Kryesuese.

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 06/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin nr. 5100/26, për themelimin të komitetit për komunitete.
I miratuar me datë: 29.01.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 04.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Vendimi nr. 5100/26, për themelimin e komitetit për komunitete, i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, e mbajtur me datë 29.01.2026.

MAPL konstaton se vendimi nr. 5100/26, për themelimin e komitetit për komunitete, nuk përbën shumicën e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në Komunë, ashtu siç përcaktohet me nenin 53 paragrafi 53.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale : Komiteti për komunitete përfaqëson në radhët e veta shumicën e tijeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

Po ashtu, është në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë që përcakton : Komiteti për komunitete përbëhet nga së paku një përfaqësues i komuniteteve jo shumicë që jetojnë në komunë. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit për komunitete, i cili komitet duhet të reflektoj barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj, bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Vushtrisë duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosoves
Republika Kosovo



Komunal Vushtri
Opština Vučitrn

Zyra Komonale Komuniteteve dhe Kthim
Opštinska kancelarija za zajednice i povratak

Date/a: Datum:	18.12.2025
Per: Za :	Predsednik opštine Vučitrn, g. din Ferit Idrizi
Nga: Od:	Rukovodilac Opštinske kancelarije za zajednice i povratak Branislav Vuksanović
Tema:	Predlog za imenovanje članova iz manjinskih zajednica u opštinskom odboru da zajednice i u Opštinskom odboru za bezbednost zajednica.

Poštovani,

Opštinskoj kancelariji za zajednice i povratak obratili ste se zahtevom broj 62667/25 od dana 12.12.2025 godine da vam se obezbedi imena prestavnika nevećinskih zajednica koji će da zastupa interese svojih zajednica u Opštinskom odboru za zajednice i u Opštinskom odboru za bezbednost zajednica.

Rukovodilac opštinske kancelarije za zajednice i povratak je obavio razgovore sa nevećinskim zajednicama i dati su sledeći predlozi:

1. Odbor za zajednice:

Ispred Srbske zajednice – Miljan Bojković, br. LK. 1170259803

Ispred Romske zajednice – Aziz Emini, br. LK. 1501351730

Ispred Aškalijske zajednice – Bekim Çuni, br. LK 1172181968

Ispred Turske zajednice – Erdal Kera, br. LK.1231998671

Ispred Bošnjacke zajednice – Zana Krasnic, br. LK 1232000542

2. Odbor za bezbednost zajednica:

Ispred Srbske zajednice – Božidar Artonović, br. LK. 1244799414

Ispred Romske zajednice – Seljatin Emini, br. LK. 1501352116

Ispred Aškalijske zajednice – Adem Hoti br. LK. 1004614719

Ispred Turske zajednice – Semra Gjushinca Llapashtica br. LK. 1172735513

Opštinska kancelarija za zajednice i povratak predlaže da Skupština opštine, na osnovu gore navedenog predloga, donese zaključak o imenovanju ovih lica u Opštinskom odboru za zajednice i Opštinskom odboru za bezbednost zajednica.

U nadi da smo ispunili vaša očekivanja, srdačno vas pozdravljamo.



Formulari per kerkese apo anekese

Drejtoreti/Njesia
Kuvendi i Komunës

Data 09/03/2026

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Bekim Çuni

Numri personal

Adresa e vendbanimit

Vushtrri

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-104/02-0009871/26

Afati i zgjedhjes

08/04/2026

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese per te qene pjesetar i komitetit per komunitete 2025-2029

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Bekim Çuni vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

*Ju lutemi të kërkontë nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura


(Nënshkrimi)

Pranuar nga: florjana.krasniqi

Ne gytetart e Komunes së Vushtrrisë Pjestart të Komunitetit Ashkali shprehim mbështetjen tonë që në Komitetin për Komunitete gjatë mandatit 2025-2029 të Përfogësohmi nga z. Bekim Çuni.

Nr.	Emri.	Mbiemri.	Nr. Personal.	Nënshkrimet.
1.	Emine	Shabani		
2.	Sinan	Shabani		- 
3.	Florie	Shabani		- 
4.	Elmedina	Shabani		- 
5.	Rejhan	Shabani		- 
6.	Anita	Shabani		- 
7.	Ardullah	Shabani		- 
8.	Hilmi	Pllarci		- 
9.	Fjora Rushiti	Pllarci		- 
10.	Afërdita	Çuni		- 
11.	Mehmet	Çuni		- 
12.	Alor	Pllarci		- 
13.	Zylfije	Pllarci		- 
14.	Bekim	Krasnigj		- 
15.	Xhemile	Krasnigj		- 
16.	Hana	Krasnigj		- 
17.	Valdet	Zymeri		-
18.	Xhevrije	Zymeri		-
19.	Leorina	Zymeri		-
20.	Selvet	Rrustemi		-

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr. Personal.	Nënshkrimet.
21.	sami	Duka.		SAMI
22.	Valbone	Duka		VA
23.	Marigona	Duka.		Marigona D
24.	Hergjirane	Duka		Nergjiran
25.	Shukri	Duka		SHUKRI
26.	Egzon	Duka		Egzon
27.	Gj'ejlan	Duka		Gj. D
28.	Bajamshake	Duka		B. Duka
29.	Mehreme	Duka		MEHREME
30.	Ramaden	Duka		Ramadan
31.	Fehmi	Durmishi		Fehmi
32.	Menderez	Duka		Duk
33.	Dashuri'e	Duka		D. D
34.	Suzana	Duka		S. D
35.	Naser	Shabani		- Shabani
36.	igballe	Shabani		- I. Sh
37.	Gzim	Shabani		G. Sh
38.	Gëzime	Shabani		G. Sh
39.	Ahmet	Shabani		Ahmet
40.	Bohrije	Shabani		Bohrije
41.	Sheremet	Krasnigj		SHKrasnigj
42.	Qamile	Krasnigj		QK W
43.	Meriton	Krasnigj		Meriton

Bekim Çuni
Rr. Ali Pash Tepelena 14. IZ.

Vushtrri 

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRË

Nr. / Br. 10648/26

Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data: / Datum: 13.03.2026

VUSHTERI - VUÇITRË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr.47/26 13.03.2026

DATE/DATE/DATE:	13 mars 2026
PËR/ZA/TO:	Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	znj. Mehmete Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për rishqyrtimin të vendimit

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Duke ju referuar shkresës Nr.020-98/7 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit-vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë vendimi me numër të protokollit Nr.5103/25, i datës 29.03.2026, për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026, të cilën e kemi pranuar më datën 04.03.2026, e cila ka kërkuar që ky vendim të harmonizohet me dispozita e legjislacionin në fuqi.

Kryesuesja e kuvendit duke marrë dhe përmbushur këto obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju dërgon për rishqyrtim dhe harmonizim vendimin e cekur si më lartë.

Andaj bazuar në cekurat më lartë obligohet Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë përcjellëse ju dërgojmë vendimin dhe shkresat përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

I nderuar Kryetar,
F nderuar Kryesuese,

Vendimin nr. 5103/26, për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Vendimi nr. 5103/26, për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026, i miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026.

MAPL, konstaton në bazë të raportit të monitorimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, evidentohet që vendimi nr. 5103/26, për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026, është miratuar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara ligjore të legjislacionit në fuqi, sepse në rendin e ditës i dërguar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me datë 15.01.2026 në MAPL, për mbajtjen e mbledhjes me datë 29.01.2026, vendimi në fjalë nuk ka qenë në rendin e ditës po ashtu nuk është votuar si pikë e re shtesë për rendin e ditës gjatë zhvillimit të mbledhjes, si rrjedhojë është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, konkretisht nenin 47 që përcakton: *47.1 Rendi i ditës për takimin e kuvendit të komunës caktohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës. 47.2 Anëtarë i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.*

Andaj, bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRIN

Nr. / Br. 5103/26

Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data: / Datum: 03. 02. 2026

VUSHTERI - VUÇITRIN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrin – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 13/26 03/02/2026

Bazuar në nenin 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 pika 1 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për Caktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 12 paragrafi 2 shkronja “d” si dhe nenit 13 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, duke marrë për bazë kërkesën e MAPL-së me Nr.020-702/2 e datës 15.01.2026, për rishqyrtim të vendimit nr.65231i datës 30.12.2025, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **29 janar 2026** merr këtë:

V E N D I M

Për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026

1. Me këtë vendim aprovet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026.
2. Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.
3. Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrisë në të ardhmen planifikon të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së komunës.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.


Melihate Basholli-Latifi
Kryesuese e Kuvendi



Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Propozim -Vendim

Propozues, Kryetari i Komunës

Hartues, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë

Në bazë të nenit 13 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 6 pika 1 të Rregullores Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 13 pika 1.4 dhe nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më _____ mori këtë :

V E N D I M

Për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026

1. Me këtë vendim aprovet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026.
2. Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.
3. Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrrisë në të ardhmen planifikon të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së komunës.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026.
